



**MATERIALE SEKRETE PËR VEPRIMTARINË AGJENTURORE SERBE
(UDB-së) NË ZVICËR...**

Para një kohe gazeta "Infopress" fillimisht ka botuar dosjen sekrete të agjentit të UDB-së "Hilton" për të vazhduar më pastaj me botimin e dosjes së agjentit tjetër të UDB-së "KOBRA". Në të vërtetë, dosja "KOBRA" mund të thuhet se është vazhdim i dosjes "Hilton", sepse "gjahtarët e krimit" janë pothuajse të njëjtit personazhe, e madje ai kryesori ka patur lidhje edhe me Hiltonin. Në vazhdim këtë material sekret - agjenturor e botojmë edhe për lexuesit e faqes pashtriku.org. Me këtë rast e falënderojmë burimin e dosjes i cili pati mirëkuptim ndaj lexuesve tanë dhe e plotësoi dëshirën e tyre. Të drejtat për publikimin (në çfarëdo forme) të këtij materiali janë të rezervuara.

Sekretariati krahinor për punë të brendshme
Shërbimi i sigurimit shtetëror
Drejtorati-Gjakovë
Punto. op. Sejfullah Sahatçiu
Më 3.02.1984

Sektori II
65007784

Raport nga biseda informative

I

Burimi: N.N. nga fsh. Novosellë e Ultë - KK Gjakovë.

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të punëtorëve tanë në Zvicër nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.

Biseda është zhvilluar më dt. 30. dhe 31.01.1984 prej orës 10-14:00 në lokalet e DSHSSH-Gjakovë.

Me iniciativën e punëtorët operativ.

Shpenzime nuk ka pasur.

Më 03.02.1984.

II

Biseda është zhvilluar meqë më parë bashkëpunëtori "Hilton" me kontakt me të është informuar nga ai që pjesëmarrjen e tij në demonstrata dhe për këtë arsye është frikuar që të vijë në vendlindje, mirëpo "Hilton" pas bisedës me ne ka rënë prapë në kontakt me të dhe e ka ftuar që të vijë, me kusht që "M.P." në bisedë me ne të jetë i sigurtë dhe të tregojë për veprimtarinë e vet armiqësore dhe të të tjerëve.

Rrëfimi pas ardhjes nga Zvicra

III

Bashkëbiseduesi përveç tjerash thotë: "Në punë në Zvicër kam shkuar në vitin 1977 dhe pa e ndërprerë punën vazhdimisht kam jetuar në qytetin Bern. Pas ngjarjeve kundërrevolucionare në Kosovë, edhe në Zvicër kanë filluar disa lëvizje dhe biseda në mesin e punëtorëve tanë e që këto biseda ishin kryekëput që edhe ne në një formë apo tjetër të japim kontributin tonë që Kosova të "fitojë statusin e republikës". Pas ngjarjeve në Kosovë më 1981, ka pasur dezinformime të ndryshme si nëpërmjet mjeteve të informimit ashtu edhe përmes bisedave të ndryshme në mesin e punëtorëve të kombësisë shqiptare. Pikërisht në këtë kohë edhe propaganda nga Shqipëria, me libra, revista dhe gazeta të ndryshme është paraqitur me një intensitet të jashtëzakonshëm, kështu që shumica e punëtorëve kanë marrë vlerë dhe huazuar materiale të tilla me çmim tepër të volitshëm. Në një veprimtari armiqësore munden edhe shumë punëtorë tjerë të bien nën influencë, pasi që punëtorët e kombësisë shqiptare të vetmin "dëfrim" në gjuhën shqipe e gjejnë në leximin e këtyre materialeve helmuese. Nëpër shumë qytete të Zvicrës, e sidomos në Bern gjer më tani nuk kam pasur rastin të shoh ndonjë gazetë-libër apo revistë të botuar nga Kosova në gjuhën shqipe. Edhe sikurse të kishte botime të tilla, çmimi i tyre kishte me qenë tepër i lartë në krahasim me botimet e Shqipërisë. Një fat të tillë të keq kam pasur edhe unë pas leximit të librave si: "Vetadministrimi jugosllav", veprën e Enver Hoxhës "Imperializmi", "Mbi ngjarjet në Kosovë", "Shota dhe Azem Galica", "Hasan Prishtina", "Përmbledhje dokumentesh dhe veprat e Ismajl Qemalit", "Agimi nga Gjakova" autor i këtij libri ishte një gjakovar i cili tani jeton në Shqipëri, me siguri bëhet fjalë për Agim Gjakovën, i njohur shërbimit vr. E pun. op., "Shpërnguljet e Shqiptarëve", "Jakup Ferri", i cili ka luftuar për Plavë e Guci, kam pasur rastin të lexoj edhe shumë gazeta me prejardhje nga Shqipëria si psh. "Shqipëria e Re", "Ylli", "Zëri i Kosovës", "Zëri i Popullit". Të gjitha këto libra dhe gazeta mund të gjinden nëpër biblioteka të ndryshme si dhe nëpërmjet librarive të cilat kontraktajnë librat me RPSSH. Kur është fjala për "Zëri i Kosovës" menjëherë dua të cek se jam i bindur thellë se kjo gazetë shtypet në Shqipëri. Kur e them këtë kam për bazë se botimi i një gazete të tillë kërkon jashtëzakonisht mjete të mëdha financiare e që është e pamundur

që një shumë e tillë të sigurohet nga ndonjë organizatë e cila vepron në Perëndim, e kur dihet se në Shqipëri botime dhe shtypi tërësisht është tepër i lirë. Kuptohet se gjërat të cilat shtypen përmes njerëzve të tyre e gjërat i paraqesin ashtu të pavërteta me qëllim që të mbjellin urrejtje ndaj sistemit të Jugosllavisë.

Rrëfimi për demonstratat në Zvicër

Në mars apo prill të vitit 1981, në qytetin Bern janë organizuar demonstrata. Këto demonstrata janë organizuar nga qytetarët e Zvicrës kundër armatimit bërthamor, mirëpo një grup i punëtorëve të kombësisë shqiptare demonstratat e tilla i ka shfrytëzuar për ekspozimet e veta. Ky ishte potez i menduar mirë pasi për këto demonstrata shqiptarët nuk kanë kërkuar lejen nga policia. Unë kam marrë pjesë në to e më tepër nga kureshtja. Demonstruesit me vete kanë bartur parullat "Kosova Republikë", "Rroftë Adem Demaçi" si dhe fotografinë e Enver Hoxhës. Në këto demonstrata kanë marrë pjesë edhe punëtorët e kombësisë shqiptare nga Belgjika, RF Gjermani etj. Demonstratave iu ka paraprirë një person i veshur me rroba kombëtare i cili në duar ka bartë edhe flamurin kombëtar shqiptar. Tubimi është bërë prej stacionit të trenit nëpër rrugën Bundesgase e gjer tek Bundeschance (Kuvendi i Komunës). Në këto demonstrata askënd nuk e kam njohur. Në vitin 1982, më 27 apo më 28 shkurt, prapë janë organizuar demonstrata në qytetin Bern ku edhe në këto kam qenë pjesëmarrës. Për organizimin e tyre jam informuar në kafenenë "Kristofel", ku zakonisht më parë gati të gjithë shqiptarët takoheshin dhe bisedonin për shumë çështje. Kjo kafene një kohë e gjatë ka qenë çerdhe për derisa pas një konflikti në mes të Tomë Sinës, emigrant nga RPSSH dhe Reshad N. nga rrethi i Suharekës, i pari e ka plagosur Reshadin me revole për arsye të panjohura për mua, dhe prej këtij rasti më nuk takohem në këtë kafene, çka në hyrje shkruan se ndalohet hyrja e jugosllavëve. Në këtë rast, në këtë kafene janë shpërndarë thirrjet për pjesëmarrje në demonstrata dhe kështu në to kemi qenë afër 700 veta të tubuar para Ambasadës sonë në Bern. Demonstratës i ka paraprirë Rrustem Mahmutaj, nga rrethi i Pejës (nga fsh. Lubenic KK Pejë - vr. e pun. op.) dhe Zijah Shemsiu nga rrethi i Gjilanit.

Në këto demonstrata janë bartur parullat "Kosova Republikë", pastaj fotografitë e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, pastaj është brohoritur "Kosova Republikë", "Enver Hoxha, Enver Hoxha...", "Shqipëri, të duam më shumë se dje e më pak se nesër".

Veprimet e Zijah Shemsiut

Gjatë vitit 1982, disa herë kam qenë në kafe-restorant me emrin "Sterna"

në vendin e quajtur Zolikofen, përndryshe 5 km jashtë Bernit. Në një rast, Zijah Shemsiu ka qenë organizator që në këtë restorant të tregohen filma me prejardhje nga RPSSH. Kështu Zijah së bashku me një bashkëvendës të vetin me këtë rast kanë treguar filmat "Shpallja e pavarësisë së RPSSH", "Xhirimi i koncertit të Shqipërisë nëpër Gjermaninë Perëndimore", "Kongresi i VIII i PPSH-fjalimi i Enver Hoxhës", "Shota dhe Azem Galica" etj. Pasi që u shfaqën filmat, Zijah Shemsiu mbajti një fjalim të shkurtër ku në mes tjerash tha: "Është mirë që të angazhohemi dhe të japim kontributin tonë në bashkimin e tokave shqiptare, t'i mbrojmë tokat shqiptare të gjyshërve dhe katragjyshërve...". Pas shfaqjes së filmave, Zijah ka bërë shitjen e disa gazetave me origjinë nga Shqipëria si: "Shqipëria e Re", "Ylli", "Zëri i popullit" apo "Zëri i Kosovës". Të interesuarit kanë blerë mjaft këso gazetash e me paratë e fituara Zijah Shemsiu nuk e di se çka ka bërë apo kujt ia ka dorëzuar.

Ndjekja e Avdi Lekut, njohës i gjashtë gjuhëve të huaja...

Me Avdi Lekun nga Gjakova, njihem qëmoti, kuptohet me te jam njoftuar pasi që i njëjti ka ardhur në Zvicër për të zënë punë. Në fillim kam pasur bindje të mirë për të dhe për këtë arsye edhe nja 2-3 raste ia kam siguruar garancinë për punë. Me të kam qenë vazhdimisht. Para 2 vitesh kam qenë zhirant për blerjen e veturës së tij e pasi që Avdiu nuk i pagoi paratë, më është dashur që vlerën prej 6 500 frangash zvicerane ta bëja unë. Prej këtij momenti marrëdhëniet me Avdiun janë ftohur edhe pse vazhdimisht premtan se huan do ta kthejë. Avdiu është njeri tepër inteligjent, mirëpo tek shumica e punëtorëve e ka humbur autoritetin vetëm e vetëm nga borxhet dhe malverzimet që i bënë. Në veprimtari armiqësore ka dëshirë që vetëm ai të përmendet si njeri i madh, si njeri i cili i pari vjen gjer te lajmet e ndryshme, gazetatat, librat dhe materialet tjera. Në kohën e fundit, disa shokë të tij kanë filluar t'i largohen e sidomos pas dënimit të një të afërmi të Avdiut nga komuna e Deçanit, për çka thuhet se bashkëpunon me ju. Avdiu është i armatosur me një revole të cilën vazhdimisht e mban me vete. Tani punon si kamerier, është njohës tepër i mirë i 6 gjuhëve. Më parë ka jetuar në Surzë e tani para nja një muaji jeton në Lucern. Edhe pse Avdiu qysh në fillim ka qenë i indoktrinuar, në të kanë ndikuar edhe diplomatët nga RPSSH të akredituar në Vjenë-Austri. E di se Avdiu shpeshherë ka qenë në kontakt me përfaqësuesit diplomatikë të Shqipërisë dhe se ata disa herë e kanë vizituar atë në Zvicër. Me siguri nga ata është furnizuar me libra dhe materiale tjera propagandistike si dhe me siguri ka marrë edhe instruksione të ndryshme lidhur me veprimtarinë armiqësore. Në banesën e tij, përveç librave tjera kam parë edhe "Titistët". Në vitin 1982, Avdiu ka marrë pjesë në demonstratat e organizuara anti-jugosllave,

demonstrata këto të cilat janë mbajtur në shenjë të njëvjetorit të vdekjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, në qytetin Shtutgart. Në shoqëri Avdiu sillet me Rustem Mahmutajn, Ahmet Lekun, kushëririn e vet, si dhe flitet se ka qenë i pandarë me vëllezërit Gërvalla.

Ndjekja e Hajdar e Adem Sadrisë

Në nëntor të vitit 1983, në një sallë të restorantit "Kazino" në Lucern, është mbajtur një manifestim me rastin e 75-vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës. Këtu fjalën kryesore e kanë pasur vëllezërit Hajdar dhe Adem N. nga Ponosheci (Hajdar dhe Adem Sadrija nga Ponosheci, vr. e pun. op.) të cilët kanë qenë edhe organizatorë. Në një program të "pasur" janë paraqitur së pari me disa vjersha me përmbajtje nacionaliste, pastaj me këngë kushtuar PPSH dhe Enver Hoxhës. Nga ky manifestim iu është dërguar një telegram Enver Hoxhës me të cilin thuhet: "... Edhe pse jemi të mërguar jashtë atdheut, ndjejmë kënaqësinë për 75-vjetorin. Rrofsh sa malet". Telegrami ka qenë i nënshkruar nga "Lëvizja për formimin e Republikës së Shqiptarëve në Jugosllavi". Telegramin e ka lexuar Hajdari. Në këtë tubim ishin afër 800 veta dhe të vetmin person, përveç Hajdarit dhe Ademit, kam njohur edhe Hajdar Mahmutajn, i cili edhe e ka sjellë transparentin "75 vjetori i Enver Hoxhës".

Në qytetin Bern jetojnë dy emigrantë nga RPSSH, Tomë dhe Avgustin Tinaj, të lindur diku nga apo rrethi i Shkodrës. Sikurse Toma që është në moshë afro 55 vjeçar ashtu edhe Avgustini i cili ka përafërsisht afër 40 vjet, nuk merren me veprimtari armiqësore. Edhe pse me ta jam në kontakt të vazhdueshëm ende nuk kam pasur rastin që të dëgjoj ndonjë paraqitje armiqësore.

Sikurse njëri ashtu edhe tjetri, nga karakteri janë "çelik i cili nuk lakohet, por vetëm thyhet" do të thotë se me ta nuk mund të bashkëpunosh në fushëveprimin armiqësor pasi as në demonstrata nuk flitet se kanë marrë pjesë. Toma para se të shkojë në Zvicër, sipas fjalëve, kishte jetuar në Jugosllavi diku në Mal të Zi, ndërsa Avgustini thotë se nga Shqipëria është arratisur para 10 vitesh nëpërmjet të Italisë. Qe të dytë, axhë e nip, merren me shitblerjen e armëve, nga i cili profesion kanë profite të mëdha. Toma pasi e njih mirë gjuhën shqipe e serbokroate përdorët dhe është i njohur si përkthyes në mes të palëve dhe organeve shtetërore. Toma kohë pas kohe vjen në Jugosllavi, por mua nuk më është e njohur se në çfarë vendi vendoset. Sikurse Toma ashtu edhe Avgustini kanë shtetësinë zvicerane.

Në vitin 1983 diku në muajin tetor, atëherë kur ansambli nga Kosova "Kosovarja këndon", ishte në Cyrih, ka ardhur deri te prishja e rendit gjatë kohës së mbajtjes së koncertit. Në mesin e tyre, ndër më agresivët ka qenë Rustem Mahmutaj, i cili e ka kapur flamurin dhe ia ka filluar

tollovisë. Rustemi punon afër Bernit në vendin e quajtur Ostermundigen, 7km larg Bernit. Unë nuk kam qenë prezent në këtë koncert, por për rastin e Rustemit flitet në mesin e punëtorëve”.

Raportimi për personat...

Rustem Mahmutaj, nga fsh. Lubeniç, KK Pejë, për të kemi shkruar edhe më parë nga burimet tjera të shërbimit.

Zijah Shemsiu, nga Gjilani, tani në burgun hetues për veprimtari armiqësore.

Avdi Leka nga Gjakova, për veprimtarinë e tij armiqësore ky drejtorat mban lëndën në PO.

Hajdar Sadrija, nga fsh. Ponoshec KK Gjakovë, tani me vendbanim në Zvicër, i martuar me shtetasen zvicerane, ka dy fëmijë. Për të ky drejtorat mban lëndën në PO.

-Adem Sadrija, nga fsh. Ponoshec KK Gjakovë, interesant për nga aspekti i shërbimit mbahet si lëndë nga PO.

-Tom Tinaj, afër 55 vjeçar, lindur nga rrethi apo Shkodra RPSSH, një kohë ka jetuar si emigrant në Jugosllavi, tani jeton në Zvicër ku ka marrë edhe shtetësinë zvicerane.

-Avgustin Tinaj, afër 40 vjeçar, i lindur nga apo rrethi i Shkodrës RPSSH, tani jeton në Zvicër dhe ka shtetësinë zvicerane, përmendet edhe në raportin e bashkëpunëtorit "Hilton" të dt. 1.11.1983.

Detyra konkrete ndaj "Kobrës"

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëbiseduesi më parë ka qenë në kontakt me bashkëpunëtorin tonë "Hilton", të cilit i ka treguar sipërfaqësisht mbi disa kontakte dhe tubime mbajtur në tetor 1983. me që N.N. është penduar thellë për këtë pjesëmarrje, ndaj bashkëpunëtorit "Hilton" ka shprehur gatishmëri që nëse shërbimi nuk ndërmerr masa ndaj tij, ai do të vijë në atdhe dhe në bisedë me ne do t'i paraqesë të gjitha gjërat që i din mbi veprimtarinë armiqësore të tij dhe të të tjerëve si dhe do të na ndihmojë në të ardhmen. Pas një konsultimi, bashkëpunëtorit "Hilton" iu është thënë që N.N të vijë në vend me kusht që të jetë i sigurtë në bisedë me ne. Mendoj se N.N deri diku ka qenë i sigurtë, mirëpo mund të dijë edhe gjëra tjera dhe persona të cilët merren me veprimtari armiqësore. Pasi që njihet mirë me Avdi Lekun dhe Rustem Mahmutin, para se të shkojë në Zvicër do të jepen detyrë konkrete. Në të ardhmen, N.N do të shfrytëzohet si bashkëpunëtor me pseudonim "KOBRA" e angazhimi i tij bëhet përmes materialit komprometues. Për bashkëpunim edhe ky ka shprehur gatishmëri, por me kusht që bashkëpunimi të jetë tepër konspirativ pasi për këto punë, sipas fjalëve të tij, të shkon koka. Në

bisedat që do të pasojnë, do të mundohemi që përmes fotografive të demonstratave antijugosllave të organizuara në Zvicër të bëjë mundësisht identifikimin e pjesëmarrësve. Me fragmente të posaçme nga ky raport do të njoftohen DSHSSH Pejë dhe Gjilan.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:
2xSKPB SHSSH
2xKëtij drejtorati

Punëtori operativ:
Sejfullah Sahatçiu

Detyra konkrete ndaj "Kobrës" dhe nënshkrimi i pseudonimit

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëbiseduesi më parë ka qenë në kontakt me bashkëpunëtorin tonë "Hilton", të cilit i ka treguar sipërfaqësisht mbi disa kontakte dhe tubime mbajtur në tetor 1983, meqë N.N. është penduar thellë për këtë pjesëmarrje, ndaj bashkëpunëtori "Hilton" ka shprehur gatishmëri që nëse shërbimi nuk ndërmerret masa ndaj tij, ai do të vijë në atdhe dhe në bisedë me ne do t'i paraqesë të gjitha gjërat që i din mbi veprimtarinë armiqësore të tij dhe të të tjerëve si dhe do të na ndihmojë në të ardhmen. Pas një konsultimi, bashkëpunëtorit "Hilton" i është thënë që N.N. të vijë në vend me kusht që të jetë i sigurtë në bisedë me ne. Mendoj se N.N. deri diku ka qenë i sigurtë, mirëpo mund të dijë edhe gjëra të tjera dhe persona të cilët merren me veprimtari armiqësore. Pasi që njihet mirë me Avdi Lekun dhe Rustem Mahmutin, para se të shkojë në Zvicër do të jepen detyra konkrete. Në të ardhmen, N.N. do të shfrytëzohet si bashkëpunëtor me pseudonim "Kobra" e angazhimi i tij bëhet përmes materialit komprometues. Për bashkëpunim edhe ky ka shprehur gatishmëri, por me kusht që bashkëpunimi të jetë tepër konspirativ pasi për këto punë, sipas fjalëve të tij, të shkon koka. Në bisedat që do të pasojnë, do të mundohemi që përmes fotografive të demonstratave antijugosllave të organizuara në Zvicër të bëjë mundësisht identifikimin e pjesëmarrësve. Me fragmente të posaçme nga ky raport do të njoftohen DSHSSH Pejë dhe Gjilan.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

Punëtori operativ:

2xSKPB SHSSH
2xKëtij drejtorati

Sejfullah Sahatçiu

Vendimi për pseudonim

Sekretariati krahinor për punë të brendshme
Shërbimi i sigurimit shtetëror
Drejtorati-Gjakovë
Punt. op. Sejfullah Sahatçiu Sektori II
Më 07.02.1984.

Propozim

Për angazhimin e bashkëpunëtorit në bazë të nenit 46 të Rregullores mbi punën e SHSSH.

N.N. nga fsh. Novosellë e Ultë, KK Gjakovë, nga baba N. dhe nëna N., shtetas i RSFJ, shqiptar, tani përkohësisht i punësuar në Zvicër - Bern, me vendbanim në fsh. Novosellë e Ultë KK Gjakovë. (Redaksia nuk e prezanton emrin e mbiemrin as të Kobrës e as të prindërve të tij, meqenëse personi është gjallë, dhe synimi ynë nuk është t'i tregojmë emrat e njerëzve që kanë bashkëpunuar me UDB-në, por të tregojmë punën dhe metodologjinë e veprimit të UDB-së - vër. e red.)

Arsyet

Pasi që ekziston interesi operativ i Shërbimit rreth mbrojtjes kontraintformative të punëtorëve tanë të punësuar jashtë vendit tonë, si dhe përcjelljen e veprimtarisë armiqësore të grupeve dhe personave, e me që edhe vetë N. ka qenë pjesëmarrës i demonstratave antijugosllave të organizuara në Bern - Zvicër, në vitin 1981, përmes bashkëpunëtorit "Hilton" (shkëputje e red.). Gjatë bisedës N. ka dhënë disa gjëra interesante e njëherësh ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim. Angazhimi është bërë në bazë të materialit komprometues. N. gjendet në punë në qytetin Bern dhe si i tillë ka mundësi objektive që të na ndihmojë. Andaj kërkoj nga ju të lejohet angazhimi i tij si bashkëpunëtor. Në të ardhmen N. do ta ketë pseudonimin "Kobra".

Gjakovë
7.02.1984

Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu

Leje

Në bazë të nenit 48 të Rregullores mbi punën e SHSSH, jam i pëlqimit dhe lejoj propozimin e dhënë për këtë bashkëpunëtor.

Gjakovë:
7.02.1984

Kryeshefi
Fehmi Macula

Kobra ofron të dhëna shumë kualitative për UDB-në

Sekretariati krahinor i punëve të brendshme
Shërbimi i sigurimit shtetëror
Gjakovë

Përshkrim i të dhënave të marra nga bashkëpunëtori "Kobra"

Bashkëpunëtori "Kobra" është tërhequr për bashkëpunim në fillim të vitit 1984 në bazë të materialit komprometues / pjesëmarrës i demonstratave antijugosllave në vitin 1984 në Bern-Zvicër e organizuar nga "LPRSHJ"/. Pasi që gjendet me punë të përkohshme në Zvicër i njëjti është angazhuar në përcjelljen e veprimtarisë armiqësore nga pozita e nacionalizmit dhe irredentizmit të emigracionit ekstrem shqiptar, organizimet e tyre, individëve të rrallë të punëtorëve tanë si dhe aktivitetit të SHIK-ut dhe pikave të tyre.

Nga dita e angazhimit bashkëpunëtori "Kobra" ka ofruar të dhëna kualitative të cilat kanë sjellë thellim të njohurive për aktivitetin dhe veprimtarinë e emigracionit armiqësor shqiptar, organizimeve të tyre kundër RSFJ-së.

Raport i datës 03.02.1984

"...Pas ngjarjeve kundërrevolucionare në Kosovë edhe në Zvicër në mesin e shqiptarëve është biseduar për gjetjen e mënyrave për të ndihmuar marrjen e statusit Kosova Republikë. Në këtë kohë ka pasur edhe shumë dezinformime në rrugë përmes mjeteve të informimit me një ndikim ka dhënë RPSSH duke shpërndarë në mesin e shqiptarëve materiale të ndryshme propagandistike si: libra, broshura, gazeta etj., me çmime të volitshme. Kështu shqiptarët lexojnë këtë literaturë sepse kjo ishte e vetmja që e kishin. Gjatë leximit të kësaj literature ata u indoktrinuan në veprimtari armiqësore kundër RSFJ-së ... në mars dhe prill të 1981 u organizuan demonstrata kundër armatimit bërthamor, por po atë ditë një grup i vogël shqiptarësh e shfrytëzoi këtë duke i dhënë karakter antijugosllav. Në këto demonstrata demonstruesit shqiptarë bartnin parulla dhe fotografi të Enver Hoxhës dhe në këto demonstrata kam marrë edhe unë pjesë nga kureshtja ... më 27 ose 28 shkurt 1982 u organizuan prapë demonstrata antijugosllave në Bern. Për organizimin e tyre kam dëgjuar në kafeterinë "Kristofe" në të cilën u shpërndanë edhe thirrjet ku në këtë kafeteri kryesisht rrinë shqiptarët. Në këto demonstrata ka udhëhequr Rustem Mahmuti nga fshati Lubeniq i Pejës

dhe Zijah Shemsiu i rrethit të Gjilanit ... gjatë 1982 kam qenë në kafe restorantin Sterna në Zolikofen është vendbanim 5 km nga Berni ku Zijah Shemsiu nga Berni organizonte shikimin e filmave me përmbajtje armiqësore nga Shqipëria. Pas shikimit të filmave Zijahu iu ka drejtuar të pranishmëve duke iu thënë se do të ishte mirë që të organizohemi për të dhënë kontribut për bashkimin e trojeve shqiptare, sepse kështu do t'i mbrojmë tokat e të parëve tanë. Në fund Zijahu të pranishmëve u shpërndante gazeta të ardhura nga Shqipëria... Avdi Leku të shumica e shqiptarëve e ka humbur besimin kështu që tash shumë dyshojnë se ai bashkëpunon me shërbimin. Posedon në një sasi të materialeve propagandistike armiqësore me origjinë nga Shqipëria... edhe pse më herët ai ka qenë i indoktrinuar në të kanë pasur dhe kanë ndikim përfaqësuesit e ambasadës shqiptare në Vjenë. Ai është me ata në kontakt të vazhdueshëm dhe e vizitojnë edhe këtu në Zvicër me siguri ai nga ata është i instruktuar dhe pajisur me material propagandistik. Avdiu është pjesëmarrës i demonstratave antijugosllave të mbajtura më 1982 në Shtutgart, në përvjetorin e vrasjes së Kadri Zekës dhe vëllezërve Bardhosh dhe Jusuf Gërvalla me të cilët, siç po thonë, ka qenë në kontakt të përhershëm. Avdiu është në kontakt të përhershëm me Rustem Mahmutajn dhe kushëririn e vet Ahmet Lekaj ... në nëntor të 1983 në sallën e restorantit "Kazino" në Lucern u mbajt tubimi për nder të 75-vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës. Në këtë tubim kryesorët ishin vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadria nga fshati Bonoshec - KK Gjakovë, të cilët kanë qenë edhe organizatorë të këtij tubimi. Kanë marrë pjesë rreth 800 njerëz. Ka pasur program me këngë me përmbajtje armiqësore e në fund Hajdar Sadriu ka lexuar telegramin drejtuar Enver Hoxhës të cilën e kanë firmosur LPRSHJ. Pjesëmarrës në këtë tubim kanë qenë edhe Rustem Mahmutaj ... në Bern jetojnë emigrantët shqiptarë Agustin dhe Tomë Timi të cilët merren me tregtinë e armëve. Toma është përkthyes pranë organeve zvicerane dhe që të dy kanë nënshtetësi zvicerane ... rreth muajit tetor 1981 gjatë mbajtjes së koncertit "Kosovarja Këndon" nga Kosova në Cyrih ka ardhur deri te prishja e rendit ku më aktiv i ka qenë Rustem Mahmutaj..."

Hajdar dhe Adem Sadria si dhe Zijah Shemsiu qenë në Shqipëri

Raport i datës 07.02.1984

"...Kam mësuar se Hajdar dhe Adem Sadria nga Ponosheci si dhe Zijah Shemsiu nga rrethi i Gjilanit, kanë qenë në vizitë në Shqipëri, deri sa jam i sigurt se Avdi Leku nuk ka qenë, sepse ai kur ka ardhur këtu e ka dorëzuar pasaportën në policinë zvicerane për ta fituar azilin politik dhe tash nuk ka asnjë lloj pasaporte.

Raport i datës 24.02.1984

"...Sipas marrëveshjes me ju, më datë 23.02.1984 e kam vizituar Isa Lekun në shtëpinë e tij. Atë ditë Isa më ka thënë se e ka ndërmend që bashkë me gruan e Avdiut të udhëtojnë për në Zvicër. Mua më ka thënë që ta porosis Avdiun që të bartë revole me vete përherë sepse në çdo hap i kanoset rreziku. Në fund Isa ka thënë "... në Zvicër do të kërkoj ndihmë nga punëtorët tanë me qëllim që me ato para ta angazhoj një avokat për t'ia rregulluar Avdiut azilin politik ..."

Kathrin Asal, grua 40 vjeçe, e ndihmon "LPRSHJ"

Raport i datës 19.04.1984

"...jam i informuar se Kathrin Asal, grua 40 vjeçe, e cila e ndihmon "LPRSHJ", dhe se e njëjta së bashku me Kadri Istogun disa herë ka qenë në Kosovë..."

Raport i datës 30.04.1984

"...më 01. 05. 1984 janë thirrur njerëzit për pjesëmarrje në demonstratat antijugosllave në Bern e si vendtakim është caktuar stacioni i trenit. Pritet pjesëmarrje masive në këtë demonstratë..."

Raport i datës 10.05.1984

"... në demonstratat antijugosllave në Bern në të cilat kam marrë pjesë edhe unë, ka pasur pak pjesëmarrës shqiptarë të cilët kanë bartur flamurin nacional shqiptar dhe dy parulla. Me këtë rast janë shpërndarë trakte në gjuhën shqipe dhe gjermane..."

Hasan Mala është shumë aktiv...

Raport i datës 06.06.1984

"...Hasan Mala, i cili tash është në burg, është pjesëmarrës i të gjitha demonstratave antijugosllave që mbahen në vendet e Evropës perëndimore.. Është aktiv në veprimtarinë armiqësore, ka qenë shok i pandarë i Zijah Shemsiut dhe merret me shpërndarjen e pamfleteve me përmbajtje armiqësore" ... për Taip Zekën, vëllain e Kadri Zekës, po flitet se është pjesëmarrës i të gjitha demonstratave ... më herët kam informuar gabim për Kathrin Asal ... e cila edhe sot në librarinë e saj në Biel shet libra ... dihet se organizatorët e formimit të klubit "Tefik Çanga" në Bern kanë qenë Zijah Shemsiu dhe shokët e tij, ndër të cilët Hysen Fetahu nga fshati Gajre KK Tetovë. Zijahu ka qenë shok i mirë edhe me vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadriu ... pas burgosjes së Zija Shemsiut aktiviteti i këtij klubi ka rënë dhe ai tash nuk funksionon ... para dy muajve Rustem Mahmutaj nga fshati Lubeniq KK Pejë, ka kontaktuar me

shedin e restorantit "Zokli Kofen", i cili ia ka lëshuar sallën. Më 14.04.1984 në këtë sallë është takuar grupi i punëtorëve tanë të cilin Rrustemi që më parë e ka informuar se do të vijnë edhe disa shokë nga "Lëvizja" për ta themeluar klubin në Bern. Në këtë takim kanë qenë vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadria, Sali Basha dhe dy studentë nga Berni. Fjalën e kanë mbajtur Sali Basha dhe një student nga Prishtina, të cilët e kanë theksuar nevojën e organizimit më të mirë, thellimin e aktivitetit të klubit përmes emetimit të filmave, shpërndarjes së gazetës "Zëri i Kosovës" etj... është marrë vendimi që salla të parapaguhet për dy muaj, që të shiten 200 numra të "Zërit të Kosovës" ndërsa në emër të "Lëvizjes" është premtuar furnizimi me filma. Në fund Rrustemi i shpërndau thirrjet për 22.04.1984 dhe 29.04.1984 për takimet e radhës në këtë sallë. Në këto data kanë marrë pjesë rreth 30 veta dhe janë emetuar filma të ndryshëm nga RPSSH, janë recituar vjersha, janë shpërndarë pamflete për organizimin e demonstratave për festat e majit... Sali Basha ka qenë shok i pandarë i Zijah Shemsiut, dhe është njëri nga aktivistët më të shquar në Bazel...

"Dasma do të jetë e madhe"

Raport i datës 13.07.1984
...më 14.07.1984 në orën 9:00 do të fillojë dasma në Bahnhof e vazhdon deri tek ambasada në Bern ... dasma do të jetë e madhe..." (mendohet në demonstratat antijugosllave).

Raport i datës 07.08.1984
"...më 14.07.1984 nga ana e "LPRSHJ" u organizuan demonstrata të mëdha antijugosllave në Bern, në të cilat kam marrë pjesë edhe unë... përveç punëtorëve nga Zvicra, morën pjesë edhe punëtorët tanë nga RF e Gjermanisë dhe Belgjika gjithsej 1 500-2 000 veta. Në këto demonstrata janë bartur fotografitë e Kadri Zekës, Bardhodh dhe Jusuf Gërvallës, Adem Demaçit e të tjerëve si dhe janë bartur parulla me përmbajtje armiqësore. Demonstruesit iu shpërndanin qytetarëve zviceranë pamflete me përmbajtje antijugosllave...demonstratat i drejtonin Xhafer Shatri dhe vëllai i Rexhep Malës i ashtuquajtur "Mixha", ndërsa me ta shkonin Rrustem Mahmutaj, Sali Basha, vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadria, disa studentë nga Kosova, vëllai i Ibrahim Kelmendit, gra, fëmijë si dhe një student nga Nikaragua-Karlos Magorga... Masa e demonstruesve është ndalur afër ambasadës sonë dhe aty ka folur Xhafer Shatri i cili duke folur për ngjarjet në Kosovë e ka sulmuar sistemin tonë politik...

Ndjekja e veprimtarëve të LRSNJ-së

...në mbarim të demonstratave, demonstruesit rreth orës 13:30 kanë shkuar në hotelin "Daren Zughnugase - 9" dhe këtu janë bashkuar në një restorant në katin e dytë. Më vonë kam mësuar se në këtë restorant janë shpërndarë rreth 200 copë të "Zërit të Kosovës".

Raport i datës 09.08.1984:

"...Para disa muajsh në Zvicër ka ardhur Isa Leku me gruan e Avdiut dhe vajzën e saj të vogël. Në këtë rast Isai i ka thënë djalit të vet Avdiut që t'i thotë Rrustem Mahmutajt nga fshati Lubeniç KK Pejë, e i cili është anëtar aktiv i 'LPRSHJ', se në takimin e parë do ta vrasë sepse i ka hapë fjalët se Isa dhe Avdiu e kanë tradhtuar Tahir Gecin ... Avdiu këtë porosi ia ka dërguar Rrustem Mahmutajt, me ç'rast ai duke e treguar revolen ka thënë se është i gatshëm përherë që të ballafaqohet me te ... Bindja ime është se Isa është më i zjarrtë se Avdiu, dhe jam i bindur se Avdiu punon me instruksionet e Isës ... Për Avdiun dhe Rrustemin nuk kanë bindje të mirë as ata të 'Lëvizjes'... Hajdar Sadria për ata ka thënë se 'njerëzit si Avdiu dhe Rrustemi nuk na duhen sepse e humbin autoritetin e 'Lëvizjes', ata nuk zgjedhin metoda as mjete kundër Jugosllavisë ... e nesër kur Kosova ta fitojë statusin e republikës unë do të mund të kthehem atje, sepse për këtë po punoj. Ata nuk do të mund të kthehen sepse do t'i përzënë për veprimet e këqija..."

Raport i datës 13.08.1984:

"...pas sulmit fizik të Rrustem Mahmutajt kundër Haxhi Berishës nga Deçani të cilin e kanë akuzuar si spiun të ambasadës së RSFJ, dukshëm ka rënë aktiviteti i klubit 'Tefik Çanga' në Bern...
...Haxhiu ka qenë shumë aktiv në 'Lëvizje' dhe në punën e klubit ku janë të shquar Rrustem Mahmutaj, Sali Basha, Adem dhe Hajdar Sadria si dhe dy studentë nga Kosova. Në këtë klub, i cili ka qenë në kuadër të 'Lëvizjes', Rrustem Mahmutaj ka organizuar shfaqjen e filmave nga Shqipëria, dhe janë organizuar takime ku është folur për Kosovën dhe ku është shpërndarë 'Zëri i Kosovës' ..."

Raport i datës 17.08.1984:

"... në banesën e Augustin Tinajt, emigrant nga Shqipëria, i cili merret me kontrabandë armësh, i kam parë disa numra të gazetës 'Zëri i Kosovës'. Augustini është shpesh në shoqëri me anëtarët e 'Lëvizjes'..."

"Rrustem Mahmutaj është njeri i aksionit"

Raport i datës 20.08.1984:

"...Rrustem Mahmutaj është njeri i aksionit, dhe si i tillë shfrytëzohet nga 'Lëvizja'. Është shumë i vrazhdë me njerëzit që kanë qëndrim lojal ndaj Jugosllavisë ... Në banesën e tij në të gjitha muret i ka vendosur

fotografitë e Bardhosh e Jusuf Gërvallës dhe të vrrarëve dhe të gjykuarve të tjerë para dhe pas demonstratave në Kosovë...”

Raport i datës 22.08.1984:

“...nga LPRSHJ kam marrë thirrje dhe janë shpërndarë shumë të tjera, në të cilat informohet se më 25. 08.1984 në Sangall, duke filluar nga ora 18:00, do të mbahet takimi komemorativ me rastin e vdekjes së Rexhep Malës e Nuhi Berishës. Ky takim do të mbahet në ndonjë hotel ku do të marrin pjesë shumë punëtorë tanë...”

Konfliktet mes Xhafer Shatrit, Sabri Novosellës e Xhafer Durmishit

Raport i datës 05.09.1984:

“...në kontaktin që e kam pasur me Idriz Halilin, të cilin e quajnë Idriz Seferi, në mes të tjerash më ka thënë: ‘si organizator i demonstratave të organizuara në vendet e perëndimit, kam kërkuar azil politik ... vëllai im është i burgosur politik dhe ndodhet në burg ... për të njëjtat arsye është gjykuar edhe nëna ime për të cilën ka shkruar edhe ‘Zëri i Kosovës’ ... Unë kam qenë anëtar i grupit të Uruç Bresalcit nga Gjilani i cili do të gjykohej, Zija Shemsiut i cili është dënuar me 13 vjet burg, Hysen Jashar Fetahut nga fsh. Gajre KK Tetovë, si dhe i disa shokëve të tjerë të cilët ti nuk i njeh ...Vëllai im i cili është në vuajtje të dënimit si dhe një shok i imi i afërt, anëtar i grupit, më kanë njoftuar se Xhafer Shatri ka ardhur me detyra të UDB-së, dhe atij nuk duhet t’i besohet. Ai po përpiqet që t’i bëjë fajtorë Sabri Novosellën dhe Xhafer Durmishin dhe disa shokë të tyre se ata po mbajnë lidhje me UDB-në jugosllave ... Për Hysen Fetahun flitet se është spiun i UDB-së sepse edhe pse ka qenë anëtar i grupit armiqësor ilegal ka shkuar në Jugosllavi dhe nuk është dënuar ... ansambli i këngëve dhe valleve ‘Migjeni’ nga Shqipëria do të qëndrojë në ST. Galen më 21.09.1984, më 22.09.1984 në Bern, pastaj në Cyrih, Sangall, Gjenevë, Lozanë e vende tjera...”

Raport i datës 20.09.1984:

“...afër kantonit Bern, në vendin Egivil, punojnë vëllezërit Ramadan dhe Zeqë Ramadani nga fsh. Firaj KK Ferizaj ... Ramadani e quan veten enverist të madh, shpërndan fotografi të E. Hoxhës, dhe është në kontakt të vazhdueshëm me Rrustem Mahmutajn nga fsh. Lubeniq, KK Pejë, i cili është i njohur për veprimtari armiqësore kundër Jugosllavisë...”

Raportim për pjesëmarrësit në koncert

Raport i datës 03.10.1984:

“...më 22.09.1984 në Beren në koncertin e ansamblit të këngëve dhe valleve nga Shqipëria, të organizuar në sallën “Theater in nacional”, kanë

qenë rreth 900-1 000 njerëz. Gjatë koncertit janë hedhur parulla antijugosllave dhe ka pasur fotografi të E. Hoxhës. Në koncert ka marrë pjesë edhe Idriz Bardhi, ambasador i Shqipërisë në Vjenë, me disa të tjerë ... Ansamblin e ka drejtuar Ymer Gjoci, i cili ka patur kontakt me 'LPRSHJ' dhe degët e saj, si me Hasan Malën - 'Mixha', Rustem Mahmutajn, Adem dhe Hajdar Sadrin, Idriz Halilaj i quajtur 'Idriz Seferi' etj., ... në këtë koncert ka qenë edhe Pashk Ndrec Uka nga fsh. Bec, KK Gjakovë, i cili është pjesëmarrës i demonstratave antijugosllave në Zvicër dhe jashtë saj ... Po ashtu ka qenë edhe Riza Halilaj (Shabani) nga Gjakova, për të cilin kam dëgjuar se është pjesëmarrës i shumë demonstratave antijugosllave si atyre në Bern, pastaj tubimeve në Lucern me rastin e 70-vjetorit të lindjes së E. Hoxhës, e po ashtu ka qenë edhe në Cyrih ku është çjerrë flamuri jugosllav dhe është prishur rendi..."

Raport i datës 11.10.1984:

"...Të dielën, më 30.09.1984, Ansambli i këngëve dhe valleve nga Shqipëria ka mbajtur koncert në Vintentur ku kanë marrë pjesë rreth 600 njerëz të nacionalitetit shqiptar. Gjatë koncertit janë hedhur parulla e pastaj nga njerëz për mua të panjohur janë shpërndarë libra dhe materiale tjera si libri i Adem Demaçit, Jusuf Gërvallës ... Në mesin e atyre që shisnin e kam njohur Sali Bashën derisa të gjithë koncertin e ka xhiruar një njeri i 'Lëvizjes'...

bashkorganizator të këtyre koncerteve janë vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadria dhe e kanë shoqëruar këtë Ansambël nëpër të gjithë Zvicrën...

Rrustem Mahmutaj nuk ka marrë pjesë në këto koncerte sepse ka qenë i ngarkuar në shpërndarjen e një numri të madh të gazetës 'Zëri i Kosovës'...

në këtë koncert ka qenë edhe Beati - anëtar i 'Partisë marksiste -leniniste të Zvicrës' e cila në Biel e ka bibliotekën në të cilën shitet 'Zëri i Kosovës'..."

Raport i datës 13.11.1984:

"...në demonstratat antijugosllave të vitit 1983 në Zvicër ka marrë pjesë edhe Rrustem Mahmutaj nga fsh. Lubeniq, KK Pejë, si dhe Brahim Elezi nga Jabllanica e Vogël, KK Pejë ... Kam arritur që t'i marr tri fotografi nga Rrustem Mahmutaj ku duket pjesëmarrja aktive e tij në ato demonstrata i veshur me veshjen popullore shqiptare dhe me flamurin shqiptar, e po ashtu duket edhe Brahim Elezi me duar të ngritura..."

Gruaja e Kadri Zekës mban fjalim

Raport i datës 21.11.1984:

"... më 24.11.1984 viti, me fillim në orën 18:00, në Cyrih do të organizohet demonstratë antijugosllave (organizator është LPRSHJ).

Raport i datës 07.12.1984:

"... më 17.12.1984 viti, Beat Schafer (e njohur si pronare e librarisë në Biel) e ka hapur librarinë tjetër në rrugën 'Neuengasse 43' Vo Verdt-Passage në Bern së bashku me një student nga Prishtina i cili është pjesëmarrës i demonstratave në Prishtinë dhe Bern. Në këtë librori ka libra të ndryshëm me përmbajtje antijugosllave të ardhura në Shqipëri..."

Raport i datës 20 12.1984:

"... më 24.10.1984 në një sallë të madhe (nuk dihet se ku) është mbajtur një tubim me rastin e Festës së Flamurit. Kjo sallë ka qenë e mbushur me fotografi të Enver Hoxhës, Kadri Zekës, Bardh e Jusuf Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës e të tjerë. Kanë marrë pjesë rreth 1 000 njerëz nga Zvicra, Gjermania, Franca dhe vendet e tjera. Tubimin e ka hapur gruaja e Kadri Zekës, ndërsa të pranishmit i ka përshëndetur Hajdar Sadria nga Ponosheci, KK Gjakovë ...

Rrustem Mahmutaj nga Lubeniqi, KK Pejë, ka recituar vjersha kushtuar Bardhosh dhe Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës e të tjerëve. Djali i Dervish Shaqës, Shpendi, ka kënduar këngë të përmbledhjes "Këngët e Lirisë"... Në këtë tubim kanë marrë pjesë Hasan Mala - Mixha, Hysen Tërpeza, Sadri Mulaj nga Kalijani, KK Pejë, Kadri Abdullahu, Sali Basha, Rizah Ali Shabani nga Dobra, KK Gjakovë e të tjerë...

... Në dalje disa njerëz kanë shitur materiale propagandistike antijugosllave me prejardhje nga Shqipëria, të cilat i ka sjellë Hajdar Sadria ..."

Raport i datës 05.01.1985:

"... Kam kontaktuar me Idriz Halitin, i cili në bisedë në lidhje me veprimtarinë e 'LPRSHJ' në Zvicër në mes të tjerash më ka thënë 'Kam qenë simpatizant dhe shumë kam punuar për LPRSHJ, por tash po e shoh se me disa gjëra po udhëheq dikush tjetër e jo 'Lëvizja'. Unë dhe anëtarë të tjerë të familjes sime kemi qenë për atë që Kosova ta fitojë statusin e Republikës, por tashti po i shoh gabimet e mia dhe të tyre. Sa i përket udhëheqësit të LPRSHJ, e posaçërisht Xhafer Shatrit, duket qartë se në çfarë gjendje është LPRSHJ, kur dihet se Xhafer Shatri ka ardhur me detyra të UDB-së. Nuk pajtohem as me atë që shkruan 'Zëri i Kosovës', sepse ato janë shkrime të Xhafer Shatrit dhe spiunëve të tjerë të UDB-së të cilët po i devalvojnë demonstratat në Kosovë. Artikujt e tyre thjesht janë produkt i Enver Hoxhës dhe Shqipërisë ... Demonstratat në Kosovë në fillim nuk kanë pasur për qëllim bashkimin e disa pjesëve të Jugosllavisë, Shqipërisë, por këtë më vonë e kanë bërë njerëzit si Xhafer Shatri, Rrustem Mahmutaj dhe bashkëpunuesit e tjerë për t'i

prezantuar si kundërrevolucionare, sepse për këtë ata janë të paguar nga regjimi jugosllav. Ata po përpiqen ta rrisin Enver Hoxhën dhe Shqipërinë... Pajtohem vetëm me qëndrimet e Sabri Novosellës dhe Xhafer Durmishit, të cilët e kanë demaskuar hapur Xhafer Shatrin dhe ikjen e tij të improvizuar nga ana e UDB-së...

Augustin Tinaj interesohet për Mahmut Bakallin

... Augustin Tinaj, emigrant nga Shqipëria, i cili jeton në Bern, nuk merret më me kontrabandë armësh. Në bazë të një bisede që kam pasur me të, kam fituar përshtypjen se ai është bashkëpunëtor i Shërbimit Sekret Shqiptar, për shkak të interesimit të tij për njerëzit që kanë qëndrim lojal ndaj Jugosllavisë, si dhe për njerëzit të cilët në një farë mënyre bashkëpunojnë me ambasadën tonë në Zvicër dhe UDB. Augustini disa herë ka qenë në Francë, Itali, Belgjikë dhe vende tjera. Është interesuar për Mahmut Bakallin se ku është dhe me çfarë merret. Me rastin e vizitës së ansamblit të këngëve dhe valleve nga Shqipëria, Augustini i ka siguruar biletat për familjen e vet, ndërsa në fund ai nuk ka shkuar, me gjasë në bazë të marrëveshjes që ka pasur me dikënd..."

UDB vendos bombë në librarinë e Beatit

Raport i datës 05.01.1985

"... Më 01.12.1984 viti, në Llozanë është mbajtur manifestimi për nder të 28 Nëntorit - ditës së pavarësisë së Shqipërisë, ku kanë marrë pjesë rreth 600-700 njerëz. Këtu kanë qenë të pranishëm vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadria, Rrustem Mahmutaj, Faik Caka nga Doganajt, KK Kaçanik e të tjerë. Edhe në këtë takim si në të tjerët që i organizon LPRSHJ janë brohoritur parulla armiqësore. Pas përfundimit të këtij tubimi Hajdar Sadria ka shitur kasete magnetofoni me këngë armiqësore të ardhura nga Shqipëria. Hajdari merret me shitjen e këtyre kasetave ndërsa paratë e fituara i jep për nevojat e LPRSHJ-së. Me këtë punë merret edhe i vëllai i tij Ademi, por ai ato vetëm i shpërndan... Në një bisedë që kam bërë me Hajdar Sadrinë më ka thënë: "Edhe nëse Kosova e fiton statusin e Republikës nuk do të mund të kthehem atje deri atëherë sa të mos bashkohemi me Shqipërinë..." Gjithashtu tha se i ka dalë afati i pasaportës dhe atë e ka çuar me postë në ambasadën tonë në Zvicër. Vetë nuk ka shkuar sepse është frikësuar se mund ta vrasin ose burgosin e pastaj ta kthejnë në Jugosllavi..."

... Banesa e Rrustem Mahmutajt shërben si Klub i LPRSHJ-së dhe aty takohen shpesh Shaqa N. nga Ferizaj, Hajdar Sadria me vëllain e tij Ademin dhe disa njerëz të tjerë. Rrustem Mahmutaj është i martuar me

një nënshtetase ruse. Në muret e banesës së tij ka varur shumë parulla në të cilat mburret Enver Hoxha dhe Shqipëria... Në adresën e tij vijnë letra dhe literaturë propagandistike me origjinë nga Shqipëria. Për shpërndarjen e tyre Rustemi m'i çon rregullisht nga 20 copë të 'Zërit të Popullit' të cilat unë i zhduk. Në një rast iu kam afruar Rustemit për kinse futjen e materialeve në Jugosllavi, për ç'gjë ai më ka thënë: "Së pari duhet ta siguroj një lidhje të fortë në Universitetin e Kosovës në Prishtinë. Kjo praktikohet edhe me të tjerët të cilët çojnë material atje.

"Për tri orë shpërndahet materiali për të mos rënë në dorë të UDB-së"

Ata në afat prej 3 orësh e shpërndajnë materialin e ardhur dhe pastaj e zhdukin me qëllim që të mos bien në duar të UDB-së...

...Kam mësuar, edhe për këtë ka shkruar edhe shtypi zviceran se në librarinë e BEATIT është montuar një bombë. Në këtë rast Beat ka deklaruar se bomba është vendosur nga ana e UDB-së, si dhe se ajo e ka parë njeriun i cili e ka vendosur bombën por nuk ka arritur që ta identifikojë... Lidhje e ngushtë e Beatit është një kushëri i Nuhi Berishës, ish-student nga Prishtina dhe figurë e rëndësishme në "Lëvizje" i cili së bashku me të shet material propagandistik të ardhur nga Shqipëria...

...Sipas bindjes sime dhe të shumë atyre që punojnë në Zvicër, ndër më aktivët e "Lëvizjes" janë Xhafer Shatri me pseudonimin "shpati", Shaqa N. - "Lulëkuqja", Hasan Mala - "Mixha" etj...

...Avdi Leku tash asgjë nuk përfaqëson, sepse shumica e anëtarëve të "Lëvizjes" e kanë humbur besimin tek ai. Po e konsiderojnë si agjent të UDB-së edhe kjo veçanërisht pas ardhjes së babait të tij Isës, i cili në Zvicër ka qëndruar rreth 6 muaj. Për Avdiun po edhe për Isën po flitet se kanë ardhur me detyrë që t'i zbulojnë njerëzit... Nga ai askush nuk merr material propagandistik, nga frika se mund t'i zbulojë. Kohët e fundit Avdiu nuk ka marrë pjesë në asnjë tubim..."

"Detyrë parësore, orientimi i popullit në luftë ose demonstrata të reja..."

Raport i datës 07.01.1985

"...Para disa ditësh në Gjenevë jam takuar me Kadri Abdullahun nga Gjilani dhe Sadri Mulajn nga Kalijani KK Pejë. Gjatë bisedës që e kemi zhvilluar në një restorant, Kadri Abdullahu më ka thënë, "duke e vlerësuar gjendjen në Kosovë e cila është e rëndë, ne si anëtarë të LPRSHJ-së e që jemi përfaqësues të popullit, duhet t'i mobilizojmë të gjitha forcat dhe të dëshmohejmë se mund ta godasim armikun në kokë. Është detyrë e çdo shqiptari e edhe e jona, që sa më shumë ta shpërndajmë "Zërin e Kosovës" brenda në Kosovë. Ne shokët, duhet të

lidhemi ngushtë që popullin e Kosovës ta pajisim me literaturë sa më të mirë në gjuhën shqipe, në të gjitha mjediset, me qëllim që t'i kundërvihemi regjimit serbomadhi të Beogradit... Duhet t'i forcojmë radhët tona dhe konspiracionin... na mbetet për detyrë që ta orientojmë besimin e popullit në luftë ose demonstrata të reja... që të angazhohemi në shpërndarjen e trakteve në organizatat punuese, që të organizohen grupe në fabrika dhe jashtë tyre, me qëllim që ta zgjidhim çështjen e Kosovës. Duhet të jemi aktiv në organizimin e demonstratave për ta njoftuar botën dhe Organizatën e KB që shqiptarëve iu takon Republika... ...Sadri Mula është pjesëmarrës në disa demonstrata antijugosllave në Zvicër-Bernë, dhe është simpatizanti i madh i Enver Hoxhës ...

LPRSHJ organizon protestë në Shtutgart të Gjermanisë

Raport i datës 22.01.1985

"...më datë 26.02.1985 në Shtutgart/Gjermani do të mbahet një marshim protestues të cilin e organizon LPRSHJ, dhe për këtë qëllim janë shpërndarë ftesat, nga të cilat duket se vendi i grumbullimit është "SCHLASTLPLATZ" duke filluar nga ora 11,30 minuta, dhe që nga këtu do të vazhdohet drejt varreve të vëllezërve Gërvalla...

Në bazë të materialeve të cilat i ka dërguar bashkëpunëtori ynë nëpërmjet postës, janë shkruar 26 raporte, të cilat kanë të bëjnë kryesisht për materialet e shkruara propagandistike të veprimtarisë së Shërbimit të Zbulimit Shqiptar, LPRSHJ si dhe shpërndarjes së literaturës propagandistike antijugosllave me origjinë nga Shqipëria.

Rrugët e Gjenevës gumëzhinin nga brohoritjet dhe altoparlantët e shqiptarëve

Raport i datës 26.03.1985

"...më 25.03.1985 i kam marrë rreth 30 ftesa për t'i shpërndarë në mesin e bashkëmendimtarëve të LPRSHJ-së, në të cilat thuhet se më 30.03.1985 në Gjenevë do të mbahet tubim protestues me rastin e 4 vjetorit të demonstratave kundërrevolucionare në Kosovë. Ky tubim do të mbahet në një nga klubet e LPRSHJ-së në Gjenevë me fillim në orën 19,30 minuta..."

Parullat, transparentet e brohoritjet kishin këtë përmbajtje: "Kosova Republikë", "Freiheit Fur Kosovo", "Regjimi fashist". "Jugosllav". "Rofshin patriotët shqiptarë", "Poshtë trathtorët", "Poshtë armiqtë e vendit", "Poshtë spiunët", "Rroftë Kosova Republikë". Demonstruesit kanë shpërndarë pamflete qytetarëve zviceranë të cilët e kanë përcjellë këtë demonstratë. Në afërsi të Ambasadës sonë, nga një veturë në të cilën ishin montuar altoparlantët, me mikrofon kolonën e udhëhiqnin Xhafer

Shatri dhe vëllai i Rexhep Malës, të cilin anëtarët e "Lëvizjes" e kanë pagëzuar me emrin "Mixha". Pas tyre menjëherë vinte Rustem Mahmutaj nga rrethi i Pejës e pastaj vinin kujdestarët të cilët kujdeseshin për disiplinën, si Salih Basha, Hajdar dhe Adem Sadria nga Ponoheci, KK Gjakovë, dhe disa studentë nga Kosova. Në këto demonstrata ka qene edhe vëllai i Ibrahim Kelmendit, i cili kishte ardhur nga Gjermania. Në demonstrata ka pasur studentë nga Kosova, gra, fëmijë dhe një student nga Nikaragua, i cili studion në Gjenevë, me emër Karlos Mayorga.

Para Ambasadës ka folur Xhafer Shatri, i cili foli për gjendjen në Kosovë, duke përmendur se tani atje janë burgosur e dënuar mbi 70 shqiptarë etj. Xhaferi foli edhe në gjuhën serbokroate duke iu drejtuar Ambasadës. Në këto demonstrata kanë marrë pjesë Selim Hazeri nga rrethi i Prishtinës, Kadri Istogu nga Mitrovica e Titos etj.

Pas mbarimit të demonstratave diku rreth orës 13.00, demonstruesit kanë vazhduar rrugën dhe kanë shkuar në restorant të hotelit "Daren zuguhasës 9 Bernë", në katin e dytë, ku kanë vazhduar me program. Në këtë program nuk kam shkuar pasi që më është dashur të punoj prej orës 14.00. Kam dëgjuar nga të tjerët se në këtë restorant atë ditë janë shpërndarë mbi 200 copë "Zëri i Kosovës".

- Xhafer Shatri, i njohur nga shërbimi
- Hasan Mala "Mixha", vëllai i Rexhep Malës, i njohur nga shërbimi.
- Salih Basha, aktivist i dalluar i LRSJ-së.
- Rustem Mahmutaj, nga fshati Lubenik, KK Pejë, i njohur nga shërbimi.
- Hajdar Sadria, nga fsh. Ponohec, KK Gjakovë, i njohur nga shërbimi LPO
- Adem Sadria, nga fsh. Ponohec, KK Gjakovë, i njohur nga shërbimi LPO
- N. Kelmendi, vëllai i Ibrahim Kelmendit, i punësuar në Gjermani
- Selim Haziri, nga rrethi i Prishtinës.
- Kadri Istogu, nga Mitrovica e Titos, për të cilin edhe më parë është shkruar.

'Kobra' lajmëron për 'Dasmën e madhe në Bernë'

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori 'KOBRA' edhe pse është angazhuar në bazë të materialit komprometues dhe në punë me ne është relativisht një kohë të shkurtë, ka dhënë shënime interesante dhe të sakta. Me të dëgjuar për organizimin e demonstratave, 'KOBRA' me anë të telegramit, sipas marrëveshjes, lajmëron Shërbimin për "dasmën e madhe në Bernë" me ç'gjë jeni njoftuar edhe me depeshen tonë nr. 152 të dt. 13.07.1984. Në

takimin e ardhëm do të sqarohen disa të dhëna të korrespondencës së tij me ne lidhur me punën e klubit të LRSHJ-së në Bernë, takimi iu është caktuar më 10.08.1984. Me anë të korrespondencës bashkë, ka dërguar "Zëri Popullit", një pjesë të gazetës në gjuhën gjermane mbi demonstratat e organizuara në Zvicër si dhe një fletë nga "Zëri i Kosovës" që do të jenë pjesë përbërëse e këtij raporti:

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit,

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x Në lëndë të bashkë. "HILLTON"

1 x punëtorit të vijës II.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu.

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, sektori II

punt.op. Sejfullah Sahatçiu

MË 24.07.1984

Raporti i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me shpërndarjen e materialit propagandistik nga ana e organizatës armiqësore "LRSSHJ" në Zvicër.

Materiali është dërguar me postë dhe mban vulën në pliko të dt. 2.07.1984 nga Berna.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit e sipas marrëveshjes

Shpenzime nuk ka pasur

Më 24.07.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e LRSSHJ-së në Zvicër/Bernë

Dërgimi i materialit propagandistik

III

a/ Njëpërmjet postës bashkëpunëtori ka dërguar në adresën time librin "Asim Vokshi" e botuar në Tiranë në vitin 1982 pastaj disa insert.... Të

disa heronjve kombëtarë dhe inserti mbi "70 vjetorin e Lidhjes së Prizrenit" si dhe adresën ku shiten librat.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ,
Bashkëpunëtori vazhdimisht na dërgon material të ndryshëm propagandistik. Me ardhjen e tij në vendlindje do të bisedohet përsëri e sidomos rreth demonstratave të organizuara në Bernë më 14.07.1984, pasi i njëjti në këtë qytet edhe punon.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit,

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

2 x Këtij Drejtorati

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Telegrami nr. 152

13.07.1984

SHSSH-SKPB-SKSAK

SEKTORI II

PRISHTINË

Sot më 13.07.1984, nga një pozicion operativ i ynë kam marrë telegramin me këtë përmbajtje: "më 14. në ora 9 fillon dasma në Bahnhof deri në..." në vazhdim thuhet: "dasma do të bëhet e madhe"

Kjo do të thotë se më datën dhe orën e caktuar do të organizohen në Bernë demonstrata, për ç'gjë ju keni lajmëruar edhe më parë me shënime dhe telegram .

Mk/mk

Kryeshefi

Fehmi Macula

Detyra e 'Kobrës', fokusimi i veprimtarëve të LRSHJ-së

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati - Gjakovë, Sektori II

Më 14.05.1984

Shënim Zyrtar

Më dt.11.05.1984 nga ana e bashkëpunëtorit 'Kobra' nëpërmes të korrespondencës më kanë arritur broshura me titull 'Fjala para zgjedhjeve për legjislaturën e 10 të Kuvendit Popullor të RPS të Shqipërisë, të mbajtur në zonën elektorale të Tiranës në nëntor të vitit 1982.

Bashkëpunëtori nuk shkruan se ku apo nga kush ka marrë këtë broshurë.

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB
2 x këtij Drejtorati
Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu.

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, sektori II
punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu
Raporti i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me letrën në të cilën shihet data 23.05.1984 ndërsa ne e kemi marrë nga SHSSH SKPB më datë 2.06.1984.

Në iniciativën e bashkëpunëtorit sipas marrëveshjes
Shpenzime nuk ka pasur

II

Bashkëpunëtori para se të shkojë në Zvicër pas pushimit ka për detyrë që të interesohet për veprimtarin e LRSHJ.

III

Bashkëpunëtori "KOBRA" përmes korrespondencës dërgon librin e Jusuf Gërvallës "Bekimi i nënës" e botuar në Tiranë, në vitin 1982. dhe një fletë në të cilën shihet fotografit e Jusuf e Bardh Gërvallës e të Kadri Zekës e në të shihet edhe parulla armiqësore "Kosova Republikë". Përveç këtyre bashkëpunëtori "KOBRA" ndër tjera shkruan: "Hasan Mala i cili tani gjendet në burg ka marrë pjesë në çdo demonstratë që është organizuar në shtetet e Perëndimit. Ka punuar një kohë të gjatë pa dokument përkatës në Zvicër. Tepër është aktiv në veprimtarin armiqësore dhe e mban besa se përndryshe nuk kishte mundur të sillet ashtu. Hasani merret me shpërndarjen e pamfleteve të ndryshme, ka qenë shok i

pandarë i Zija Shemsiut, bile para se të kthehet Zija Shemsiu për në Jugosllavi veturën e vetë ia ka lënë Hasanit. Përveç Hasanit më ka ra të dij edhe për Taib Zekën i cili më par kishte punuar si konduktor në Gjilan apo Tetovë përndryshe vëllai i Kadri Zekës i cili është vrrarë. Gjithashtu flitet se është pjesëmarrës i të gjitha demonstratave. Më parë gabimisht ju kam njoftuar për Kathrin Asal se gjoja është e martuar për Kadri Istogun e në të vërtetë Kathrin Asal kishte qenë gruaja e Kadri Zekës e cila shet edhe sot e kësaj dite libra në bibliotekën Buchandalung 35.BIEL.(shiko raportin e bashkëpunëtorit "Kobra" të dt.19.04.1984. vr.e pun.operativ.

Raportimet e Kobrës rreth veprimtarisë së Zija Shemsiut

Për klubin "Tefik Qanga" në Bernë dihet mirë se Zijah Shemsiu ka qenë organizator për formimin e tij si dhe disa shokë të tij si Hysen Fetahu nga fshati Gajre, KK Tetovë, i cili ka qenë i pandarë nga Zijaja. Gjithashtu Zijau ka qenë shokë tejet i mirë me Hajdarin dhe vëllain e tij (sigurisht bëhet fjalë për Hajdar dhe Adem Sadriun nga Ponosheci, KK Gjakovë, pasi Hajdari edhe jeton në Bernë, vërejtje e punëtorit operativ). Pas burgosjes së Zijah Shemsiut, klubi në fjalë nuk është duke funksionuar dhe se aktiviteti i tij është rënë në tërësi. Para dy muajsh Rustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq, KK Pejë ka ranë në kontakt me një shef të restorantit (me siguri bëhet fjalë për restorantin "Zolli-Kofen" ve.e pun.op) i cili ia ka mundësuar sallën. Kështu më 14.04.1984 jemi mbledhë disa punëtorë tanë që punojnë në Bernë, pasi që më parë ua kishte lajmëruar Rustemi se po këtë ditë vijnë disa shokë të "Lëvizje" për të formuar klubin në Bernë, Në këtë takim erdhi Hajdar Sadrija, Salih Basha si dhe dy studentë nga Berna dhe Rustem Mahmutaj i cili paraqitej si kryetar. Fjalën kryesore e mbajti Salih Basha dhe një student nga Prishtina. Në fjalët e veta, qëllimi kryesor ishte që ne të organizohem sa më mirë të zhvillojmë aktivitetin e klubit duke shikuar dhe çfarë filma të ndryshëm të shpërndajmë "Zërin e Kosovës" etj. Në këtë tubim erdhi si vendim që sallën e këtij restoranti ta marrim me qira për dy muaj, të paguhen 200 copë "Zërin e Kosovës" ndërsa nga ana e "Lëvizjes" ata u zotuan se do të na furnizojnë me materiale tjera. Menjëherë Rustem Mahmutaj i shpërndau thirrjet dhe kështu më dt. 22.04.1984 luajti filmi "Flaka e Maleve" e që në këtë shfaqje për mua recituan dy vjersha nga "Këngët e Lirisë". Gjithashtu më 29.04.1984 ka luajtur filmi "Shota dhe Azem Galica" e të cilin film e kanë përcjellë një numër mjaft i madh i shikuesve e pastaj janë shpërndarë afro 30 copë "Zëri i Kosovës" pastaj disa revista tjera. Gjithashtu janë shpërndarë edhe disa pamflete me qëllim që të organizojnë demonstratat për festën e NJË MAJIT. Salih Basha ka qenë shokë i ngushtë i Zija Shemsiut, është ndër aktivistët e dalluar në qytetin Bazell"

- Hasan Mala, punëtor në Zvicër
- Zija Shemsiu, tani i dënuar politik
- Taib Zeka, punëtor në Zvicër, vëllai i Kadri Zekës
- Kathrin Asal, pranë bibliotekës ku shitet materiali propagandistik dhe ai më prejardhje nga RPSSH, shtetas Zvicerane jeton në Biellë.
- Hysen Fetahu, punëtor në Zvicër, përndryshe nga fshati Gajre, KK Tetovë.
- Hajdar Sadrija, nga Ponosheci, KK Gjakovë, punëtor në Zvicër/Bernë, i martuar me shtetasen Zvicerane. Për veprimtari armiqësore të tij DSHSH Gjakovë e mban nën tretmanin si (PO)
- Rrustem Mahmutaj, nga fshati Lubeniç LL Pejë punëtor në Zvicër për të cilin kemi shkruar edhe më parë.
- Adem Sadrija nga fshati i dalluar në veprimtarinë armiqësore ndaj sistemit të RSFJ-së, tani jeton në Zvicër/Bazel..

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ

Shënimet e prezantuara janë të vërtetuara edhe nga burimet tjera. Me ardhjen e "Kobrës" në vend do të detajohen edhe disa momente tjera. Së bashku me raportin ju dërgojmë edhe poezitë e Jusuf Gërvallës, "Bekimi i nënës dhe fotokopjen e Lajmërimit".

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet

- 2 x SHSSH SKPB
- 1 x në lëndë të bashk. "KOBRA"
- 1 x punëtori të vijës II
- 1 x evidencës
- Punëtori operativ
- Sejfullah Sahatçiu

Kobra ka dhënë gjëra shumë interesante, presim ardhjen e tij...

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
 Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
 Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
 Punë e op. Sejfullah Sahatçiu

RAPORT BASHKËPUNMI

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me LRSHJ në Zvicër

Dërgesa është dërguar më dt.5.06.1984 (shihet vula) ndërsa në Gjakovë përmes SHSSH ka arritur më 14.06.1984

Shpenzime nuk ka pasur

Më 16.06.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSHJ në Zvicër Bernë.

III a) Bashkëpunëtori "Kobra" në letrën e dërguar në të ka futur edhe numrin e katërt, maj 1984 të fletushkës me përmbajtje armiqësore "Zëri i Kosovës" dhe një hartë të RPSSH me një parathënie në gjuhën gjermane

IV Vërejtjet e punëtorit operativ:

"Kobra" në disa raste ka dërguar materiale të tilla dhe se gjer më tani ka dhënë shënime interesante. Së shpejti presim ardhjen e tij në vendlindjen me ç'rast gjerësisht do të bisedohet me të dhe do t'i jepen detyra të reja. Bashkangjitur me shënim ju sjellim dhe fletushkën "Zëri i Kosovës" nr.4. Maj 1984.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

2 x këtij DREJTORATI

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punë op. Sejfullah Sahatçiu

RAPORT I BASHKËPUNTORIT

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me LRSHJ në Zvicër

Shënimet janë prezantuar dhe dërguar më poshtë më dt.1.05.1984, ndërsa kanë arritur më dt.10.05.1984.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Më 10.05.1984

II

Bashkëpunëtori është i orientuar që të përcjellë veprimtarinë armiqësore antijugosllave të LRSNJ-së në Zvicër/Bernë

III

"Në demonstratat e organizuara për 1 Maj në Bernë, kam qenë edhe unë. Në këto demonstrata pak shqiptarë kanë marrë pjesë në to. Me vete kanë pasur flamurin shqiptar dhe dy parulla dhe dy flamuj "proletar të gjitha vendeve bashkohuni: Për këto demonstrata janë shpërndarë "Traktet për Një Majin" në gjuhën shqipe si dhe ato në gjuhën gjermane.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ

Bashkëpunëtori "Kobra" është në fazën e vërtetimit pasi është angazhuar në bazë të materialit komprometues. Me postë ka dërguar dy fletushka "Zëri i Kosovës" nr. 3 të muajit mars 1982 dhe 3 nëntor 1982 pastaj 10 "traktet për Një Maj" 7 trakte në gjuhën gjermane. Një fletë të fotokopjuar nga gazeta "Zëri i Popullit" i cili bënë fjalë për dënimet dhe masa shtypëse kundër shqiptareve në Jugosllavi", një fotokopje të një gazete në gjuhën gjermane që bënë fjalë për demonstratat në Kosovë dhe një "njoftim për koncertin që është organizuar më 24.07.1982, në Bernë, të cilat së bashku me raport po ju dërgojmë.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet:

3 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashkë. " KOBRA"

1 x Evidencës

1 x punëtorit të linjës së II

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Ndjekja e Kadri Istogut

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtoria – Gjakovë, sektori II
Punëtori Operativ, Sejfullah Sahatçiu

Raport bashkëpunëtori

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të pjesëtarëve të "LRSHJ" në Zvicër

Shënimet janë prezantuar nëpërmjet korrespondencës më dt.17.04.1984.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Më 19.04.1984

II

Bashkëpunëtori para se të niset për në Zvicër/Bernë ka marrë për detyrë që të interesohet për veprimtarinë e LRSHJ-së.

III

Bashkëpunëtori në kovertin e dërguar përveç disa broshurave me përmbajtjen armiqësore shkruan edhe këtë: "Jam informuar rastësisht se Kathrin Asal është një grua në moshë afër 40 vjeçare e cila i ndihmon "Lëvizjes për formimin e Republikës shqiptare në Jugosllavi" Më parë Kathrin ka qenë e martuar për një shtetas turk, mirëpo para 6 vitesh ajo kalon me Kadri Istogun dhe së bashku me të kanë qenë disa herë në Kosovë. Kadriu është i lindur në Istog, mirëpo tani nuk e dinë se ku jeton si dhe familja e tij. Adresa e tij në Zvicër është kjo: Kadri Istogu, Osternundigen, Elemeut Grust Ag. Libelleuëeg 8a."

Kathrin Asal 2503 – Biel- Biende-Zvicër,

Kadri Istogu, i lindur në Istog.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Shënimet e prezantuara janë të pavërtetuara. Meqë bashkëpunëtori ka edhe broshurat "pse përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë", "Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë" Rojtar i Shqipërisë së ..." dhe " Fragmentin e çeljes së Kuvetit të Prizrenit do të jenë përbërës e këtij raporti.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB
1 x në lëndë të bashkë. "KOBRA"
1 x evidencës
Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu

Dërgimi i pandërprerë i materialeve në UDB

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori Operativ, Sejfullah Sahatçiu

Raport nga bashkëpunëtori

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarin armiqësor të LRSNJ, në Zvicër. Materiali është dërguar nëpërmes të postës e që në pliko shihet data 5.03.1984, në adresë të punëtorit operativ i cili e mban në lidhje bashkëpunëtorin.

Shpenzimet rreth këtyre dërgesave, më vonë do të dihen.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Më 13.03.1984.

II

Bashkëpunëtori para se të niset për në Zvicër/Bernë ka marrë për detyrë që të interesohet për veprimtarinë armiqësore të LRSNJ-së.

III

Bashkëpunëtori nëpërmes të postës ka dërguar këto materiale propagandistike-armiqësore; "Romanin e Jusuf Gërvallës me titull 'Rrotull' të botuar në Tiranë në vitin 1983, fotografitë e formatit të madh të Adem Demaçit, Rexhep Malës e Nuhi Berishës, pastaj fotografinë e përbashkët të Jusuf dhe Bardh Gërvallës dhe Kadri Zekës". Thirrjen për dyvjetorin e vdekjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, panoramën me shqiponjë me mbishkrimin me parulla armiqësore "Kosova Republikë", falënderimin që bën LRSNJ për ndihmat e dhëna familjeve të të burgosurve, komunikatën rreth rastit të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, thirrjen për demonstratat e 2 Marsit 1984 të organizuara në Gjenevë – Zvicër, kënga kushtuar Rexhep Malës dhe Nuhu Berishës e shtypur në gjashtë faqe, gazeta "La Suisse" e cila bën fjalë për demonstratat e organizuara në Gjenevë si dhe vizitkartën –

FRAHNENFARBRIK BERN – HUMA CHER - SCHALCH AG – ku në pjesën e pasme të saj është edhe vula e Rrustem Mahmutajt nga fsh. Lybeniq, KK Pejë, i cili është i njohur nga Shërbimi si anëtar aktiv dhe person tepër interesant i LRSNJ-së në Zvicër.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Materialet e cekura në këtë raport do të jenë pjesë përbërëse e këtij shënimi.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet:

- 2 x SKPB SHSSH
 - 1 x evidencës
 - 1 x në lëndë të bashkëpunëtorit
 - 1 x punëtorit të linjës II
- Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu

Kobra merr diplomën e falsifikuar për klasën e VIII

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me Hajdar dhe Adem Sadrijën nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë; Avdi Lekun nga Gjakova dhe Zija Shemsiun nga Gjilani, të gjithë të punësuar në Zvicër, mbi veprimtarinë armiqësore nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.

Takimi është mbajtur më 03.02.1984 në lokalet e DSHSSH Gjakovë, prej orës 10.00 -12.00.

Me iniciativën e punëtorit operativ
Shpenzimet operative nuk ka pasur
Me 07.02.1984

II

Bashkëpunëtori ka marrë për detyrë që të kontaktojë me anëtarët e familjes së Avdi Lekut.

Veprimtarët e LFRSHJ-së vizitojnë Shqipërinë

III

“Kam dëgjuar se Hajdar dhe Adem Sadrija nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë, dhe Zija Shemsiu nga Gjilani, kanë qenë si turistë në RPSSH. Jam i sigurt se Avdiu nuk ka qenë pasi që me ardhjen e tij atje i njëjti ka dorëzuar pasaportën në policinë Zvicerane për të kërkuar azil politik dhe gjer më tani ende nuk ka kurrfarë pasaporte. Ende nuk ka arritur që Avdiu të marrë azilin politik dhe për këtë arsye pa kurrfarë pasaporte nuk ka mund të vizitojë Shqipërinë. Flitej në mesin e punëtorëve se personat që kanë qenë në vizitë në RPSSH, atje kanë qenë të pritur tepër mirë, kanë vizituar shumë qytete monumente historike dhe se në Shqipëri kanë shkuar nga Italia me aeroplanë. Flitet se këto viza kanë qenë afatgjate, kuptohet se në Shqipëri kanë qëndruar më tepër se nga një muaj”.

- Hajdar Ramë Sadrija nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë, tani në Zvicër, pjesëtar aktiv i LFRSHJ, për te ky Drejtorat mban lëndën PO.
- Adem Ramë Sadrija, nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë, tani në Zvicër, pjesëtar aktiv i LFRSHJ-së, për te ky Drejtorat mban lëndën PO.
- Avdi Leku nga Gjakova, pjesëtar i LFRSHJ-së në Zvicër, pranë këtij Drjtorati lënda e tij mbahet në PO.
- Zija Shemsiu nga Gjilani, tani në burgun hetues në Beograd për veprimtarinë armiqësore.

IV.

Vërejtjet e punëtori operativ:

Shënimet e pavërtetuara, bashkëpunëtori në fazën e vërtetimit pasi i njëjti është angazhuar në bazë të materialit komprometues. Bashkëpunëtori “KOBRA” iu është dhënë për detyrë që të shkojë në bisedë me ISA LEKUN, babain e Avdiut dhe të interesohet për ndonjë porosi që kishte me qenë interesante nga aspekti i Shërbimit

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet:

- 2 x SKPB SHSSH
- 1 x DSHSSH Gjilan
- 4 x Drejtorati

Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu.

“Thuaj Avdiut që vazhdimisht ta mbajë armën me vete...”

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtoria – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori “KOBRA”

Shënimet kanë të bëjnë me Avdi Lekun (LPO) i cili vepron armiqësisht nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.

Takimi është mbajtur më 23.02.1984, në lokalet e ShSSH prej orës 12-13

Në iniciativën e punëtori operativ

Shpenzime nuk ka pasur

Më 24.02.1984

II

Bashkëpunëtori ka pasur për detyra që të vizitojë familjen Lekaj gjegjësisht të bisedojë me Isa Lekun pasi njihet mirë me Avdiun

III

Sipas marrëveshjes me ju sot më 23.02.1984 isha në shtëpinë e Isa Lekut me qëllim që t'ia përcjell të falat e djalit të tij Avdiut. Në bisedë me të Isa më tregoi se ai së bashku me bashkëshorten e Avdiut do të shkojnë në Zvicër, ku kanë për qëllim që të qëndrojnë disa ditë. Në bisedë përveç tjerash Isa më tha; “Kur të vij në Zvicër do të kërkoj ndihma nga punëtorët tanë e me këto ndihma do të angazhoj një avokat që t'ia rregullojë çështjen e azilit politik Avdiut pasi ende nuk ka mundur që të rregullojë këtë çështje. Pengesë të madhe si duket po i bën Ambasada e Jugosllavisë në Zvicër. “Pastaj Isa më tha që t'ia përcjell një porosi të tij Avdiut me kthimin tim atje e kjo porosi është “Thuaj Avdiut që vazhdimisht të mbajë armën me vete pasi në çdo moment mundet ti kërcënohet rreziku. Në bisedë Isa më tregoi se gjendjen materiale e ka të vështirë dhe kjo ishte e vetmja pengesë që ende nuk ka shkuar në Zvicër.

Avdi Leku nga Gjakova tani i zënë me punë në Zvicër është aktiv në veprimtarinë armiqësore kundër sistemin tonë, ky Drejtorat mban lëndën e tij PO.

- ISA Leku, nga Gjakova pensionist përndryshe babai i Avidiut.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ;

Shënimet pjesërisht janë të vërtetuara. Bashkëpunëtori në fazën e vërtetimit të singëritetit të tij ndaj shërbimit. "KOBRA" ka marrë për detyra që të shoqërohet me Avdi Lekun në Zvicër pasi me të njihet tepër mirë dhe në disa raste Avdiut i ka ndihmuar materialisht dhe në mënyra tjera. Jemi marrë vesh që për gjëra interesante dhe të natyrës së shpejtë të lajmërohet me telefon në mënyrë të kodifikuar apo nëpërmes të korrespondencës.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x në lëndën e Avdi Lekut dhe

1 x në lëndë të bashkëpunëtorit

Punëtori operativ

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Për informim tuajin ju njoftojmë se në emër të Sejfullah Sahatçiu, nga Zvicra kanë mbërritur 10 ekzemplare të gazetës "Zëri i popullit", të cilat i kemi ndalë ne, pasi që në kuvertë përveç tyre nuk ka pasur asgjë tjetër.
Kryeshefi i Sektorit, Muharrem Dana

Drejtorati i SHSSH-së

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë materialet të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: Kuverta me materiale

SM

Kryeshef i Sektorit II

Muharrem Dana

Vërejtje për mënyrën e raporteve me 'Kobrën'

Drejtorati i SHSSH-së

Gjakovë

Pas leximit dhe analizës së raportit të bashkëpunëtorit "Kobra" numër 578/84 të datës 5.09.1984 ju njoftojmë se jemi të mendimit se duhet ndërruar mënyrën e raporteve me të, gjegjësisht duhet tërhequr vërejtjen bashkëpunëtorit që kur të shkruajë të këtë kujdes se mund të vijë deri të dekonspirimi.

Kryeshef i Sektorit II, Muharrem Dana
Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë
Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë materialin dhe letrën që në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: Kuvertë me material dhe letër
Kryeshef i Sektorit II, Muharrem Dana

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë
Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë kuvertën me materiale, të cilat nga Zvicra në emër të Sejfullah Sahatçiu.

Shtojcë: Kuverta me materiale
SM, Kryeshef i Sektorit II, Muharrem Dana

Detyrë e Kobrës: Përcjellja e Rrustem Mahmutajt

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, sektori II
Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të LRSHJ-së në Zvicër

Shënimet janë prezantuar nëpërmjet korrespondencës e cila së pari ka arritur në SKPB e pastaj më dt.5.09.1984 ka arritur në DSHSSH Gjakovë.

Dërgesat postare kanë arritur sipas marrëveshjes

Shpenzime nuk ka pasur

Më 5.09.1984

II

1. Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e LRSHJ në Zvicër

2. Ka marrë për detyrë të kontaktojë me Rrustem Mahmutajn dhe tjerë.

III

Bashkëpunëtori në dërgesë postare në të cilën figuron data në vulë 28.08.1984, përveç thirrjes për mbrëmje përkujtimore kushtuar Rexhep Malës e Nuhi Berishës dhe gazetës "Oktober", gazetë kjo e Partisë komuniste Marksiste -Leniniste në Zvicër, shkruan edhe këtë: "Para disa ditësh kamë kontaktuar me Idriz Halilin nga Kaçaniku të cilën e quajmë edhe me emrin Idriz Seferi, dhe në bisedë me te përveç tjerash më tha: 'Kam kërkuar azil politik në Zvicër pasi që unë kamë qenë pjesëmarrës në demonstratat e organizuara në shtetet e perëndimit. Vëllai i im politikisht është dënuar gjithsej 24 vjet burg ku edhe tani gjendet në vuajtjen e dënimit. Politikisht e kanë dënuar edhe nënën time Shukrie Halilin, për të cilën ka shkruar edhe "Zëri i Kosovës". Unë një kohë kam qenë si anëtar i celulës së bashku me shokët e mi Isë Uruq Bresalcin nga Gjilani, i cili tani do të dënohet, Zijah Shemsiut, i cili është dënuar 13 vjet burg, Hysen Jashar Fetahun nga fshati Gajre, KK Tetovë si dhe disa shokë të tjerë të cilët nuk i njeh ti, Vëllai im i cili gjendet në burg si dhe një shok imi i ngushtë i celulës më kanë lajmëruar se Xhafer Shatri është lëshuar me qëllim nga UDB-ja që të kryejë detyrën e tyre, prandaj nuk duhet besuar atij aspak, ashtu më kanë lajmëruar. Gjithashtu edhe për Hysen Fetahun flitet se është spiun pasi për ata është ditur se është anëtar i celulës, mirëpo ai shkoi në Jugosllavi dhe nuk u dënua. Në kohën e fundit Xhaferi ka blerë një veturë "mercedes" të bardhë, ka marrë azilin politik brenda 3 muajve, ka banesë me 4 dhoma në Gjenevë dhe atë shumë moderne e që të gjitha këto flasin se ai financohet nga ndonjë organizatë të cilët me diplomaci dhe konsultime të ndryshme po mundohet që Sabri Novosellën e Xhafer Durmishin dhe disa shokë tjerë t'i akuzojë gjoja se kanë lidhje me UDB-n Jugosllave.

Ansambli "Migjeni" nga RPSSH i cili do të bëjë vizitë Zvicrës më datën 21.09.1984 do të jetë në st. Gallen, pastaj më 22 në Bernë. E koncerti do të mbahet në sallën SCHATBATER e që biletat do të fillojnë së shituri që nga data 9.09.1984, në Casinokasse në Bernë. Pastaj ky ansambël do të japë koncertet dhe programet e veta edhe në Cyrih, Sangall, Emenbruce, Gjenevë, Llozanë dhe vende tjera"

- Idriz Halili nga Kaçaniku,
- Shukrie Halili nga Kaçaniku
- Isë Uruq Bresalc nga Gjilani,
- Zijah Shemsiu i dënuar politik në vitin 1984,
- Hysen Jashar Fetahu, nga fsh, Gajre KK Tetovë,
- Xhafer Shatri, i njohur SHSSH.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ

Bashkëpunëtori pjesërisht i vërtetuar e gjithashtu edhe singëriteti i tij ndaj shërbimit. Shënimet pjesërisht të vërtetuara edhe nga burimet tjera. Me siguri bashkëpunëtori do të jetë prezent në shfaqjen e programit nga ana e shoqërisë "Migjeni", për çka më detajisht do të na informojë mbi ekseset apo paraqitjet eventuale armiqësore nga ana e ndonjë anëtari të ansamblit apo nga ana e punëtorëve tanë që do të përcjellin këtë program. Së bashku me raportin, ju sjellim edhe "Thirrjen për mbrëmjen përkujtimore" si dhe gazetën "Oktober".

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "KOBRA"

1 x evidencës

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Kobra merr diplomën e falsifikuar për kamerier

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarin propagandues të SHISH-së dhe LRSNJ-së në Zvicër

Materialet kanë arritur nëpërmjet postës në adresë të pun.op. dhe në të shihet data 22.08.1984, Sipas marrëveshjes, shpenzime nuk ka pasur,

II

Më 1.09.1984

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSNJ-së në Zvicër

III Bashkëpunëtori nëpërmjet postës në emër të punëtorit operativ që mban në lidhje, përcjell këto materiale: Dramën e Jusuf Gervallës "Procesi", "Zërin e Kosovës" nr.7 gusht 1984 dhe 18 gazeta "Zëri i Popullit" organ i komitetit qendror të RPSH.

Nga bashkëpunëtori kemi marrë dëftesat e falsifikuara mbi kryerjen e klasës VIII si dhe mbi dhënien e diplomës për profesionin e kamerierit të kualifikuar. Bashkëpunëtori me diplomat e dërguara, shkruan se falsifikim ia ka bërë një person i panjohur për të, në moshën afër 48 vjeçare nga Zagrebi, përkohësisht i punësuar në Zvicër në vitin 1981. Për dëftesë dhe diplomë nga bashkëpunëtori ka marrë 200 franga. Sikurse në dëftesë ashtu edhe në diplomë shihet vula e Universitetit të punëtorëve në Beograd.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori ka dhënë shënime interesante dhe të sakta, prandaj para se të shkojë prapë në punë në Zvicër është interesuar që të jetë në kontakt me Rrustem Mahmutaj i cili në Bernë vepron armiqësisht ndaj RSFJ.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Vazhdimësia e përcjelljes së LRSNJ-së

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Më 22.08.1984

Raporti i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me LRSNJ në Zvicër. Dërgesa postare ka arritur më 21.08.1984 në adresë të punëtorit operativ. Sipas marrëveshjes. Shpenzime nga ana e shërbimit nuk ka pasur. Më 22.08.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarin armiqësore të LRSNJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori nëpërmjet postës dërgon këto materiale propagandistike: "Thirrjen për demonstrata të dt.14.07.1984". "Pamfletin në gjuhën gjermane i cili është shpërndarë në demonstratat e dt. 14.07.1984", "Zëri e popullit" të dt. 11 korrik 1984, një pjesë të "Zërit të popullit" që bën fjalë për shkëmbimin kulturor shqiptaro –jugosllav i dt. 4 korrik 1984, një artikull të gazetës Zvicerane e cila bën fjalë për demonstratat e dt. 14.07.1984 në Bernë, "Zërin e Kosovës" nr. 6, të korrikut 1984, "Zërin e Kosovës" nr. 5 të qershorit 1984, si dhe hartën e qytetit Bernë dhe marshin e demonstratave të dt. 14.07.1984.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Edhe në të ardhmen "Kobra" ka marrë për detyrë që të na sjellë materiale të tilla.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x evidencës

1 x në lëndë të bashk. "KOBRA"

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Më 22.08.1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me LRSNJ në Zvicër.

Biseda është zhvilluar nëpërmjet telefonit më dt.19.08.1984 në orën 17.00

Në iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nga ana e Shërbimit nuk ka pasur. Më 22.08.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSHJ në Zvicër

III

Bashkëpunëtori nëpërmjet telefonit, më dt.19.08.1984 në orën 17.00 lajmëron: "Nga LRSHJ kam marrë thirrjen e të tilla janë shpërndarë bukur shumë, ku lajmërohem se më dt. 25.08.1984 në qytetin Sangall në ora 18.00 do të mbahet një takim përkujtimor me rastin e vdekjes së Rexhep Malës e Nuhi Berishës. Ky takim do të mbahet në një hotel (bashk. e ka përmendur hotelin. Vr. E pun. Op.) në të cilin me siguri do të marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i punëtorëve tanë. Nëse nuk punoj atë ditë, do të marr pjesë edhe unë, për çka detajisht do të ju informoj me anë të korrespondencës".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori "Kobra" para se të kthehet në punë të përkohshme në Bernë, është zotuar se edhe më tepër do të angazhohet në përcjelljen e veprimtarisë armiqësore të anëtarëve të LRSHJ-së. Me përmbajtjen e këtij raporti jemi njoftuar me depeshen tonë nr.174 të dt. 20.08.1984.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x evidencës

1 x në lëndë të bashk. "KOBRA"

1 x punët. op të vijës II.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Biseda telefonike me Rrustem Mahmutajn...

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Më 21.08.1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me Rrustem Mahmutajn nga Lubeniqi, KK Pejë. Anëtar i LRSHJ në Zvicër. Takimi është mbajtur më 17.08.1984 në lokalet

e DSHSSH Gjakovë prej orës 13-14. Në iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur. Më 20.08.1984.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarin armiqësore të LRSNJ-së në Zvicër.

III

Nga telefoni zyrtar bashkëpunëtori "Kobra" thërret Rustem Mahmutajn me këtë numër 994131514524 të cilin e ka pasur në notesin e vet. Në bisedë në prezencën time Rustemi e njofton "Kobrën" se për shumëzimin e fotografive të Rexhep Malës, Nuhi Berishës etj., duhet paguar 690 franga Zvicerane dhe se këto fotografi se shpejti do t'i marrë. Njëherit Rustemi lajmëron se tani në vizitë e ka nënën e vet. Bashkëpunëtori pas bisedës telefonike me Rustemin thotë: "Rustemi është njeri tipik i aksioneve dhe se ai përdoret nga ana e "Lëvizjes" si vegël. Nuk ka aftësi të të folurit dhe të shprehuri por ai e "zbukuron" vetveten me trimërinë që tregon nëpër të gjitha demonstratat. Ka sjellje tejet arrogante e sidomos ndaj personave që kanë qëndrim të mirë ndaj Jugosllavisë. Në banesën e tij në të gjitha muret e dhomës janë të varura fotografitë e Jusuf Gërvallës dhe Bardhoshit për të cilët thotë se janë dajët e tij si dhe fotografitë tjera të personave të vrarë apo dënuar gjatë dhe pas demonstratave në Kosovë".

Rustem Mahmutaj, nga fshati Lubeniç, KK Pejë, përkohësisht i punësuar në Bernë - Zvicër, për të edhe më parë është shkruar dhe është i njohur nga Shërbimi.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Shënimet e vërtetuara dhe nga burimet tjera. Bashkëpunëtori edhe në të ardhmen do të përcjellë veprimtarinë armiqësore të Rustem Mahmutajve dhe të tjerëve pasi në mesin e tyre gëzon autoritet dhe është i çmuar. Mbi veprimtarinë armiqësore të anëtarëve të LRSNJ, kohë pas kohe do të na informojë me telefon dhe me anë të korrespondencës.

IV

Vërejtjet , çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet

- 2 x SHSSH SKPB
- 1 x Evidencës
- 1 x në lëndë të bashkë. "Kobra"
- 1 x punt. të vijës së II

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Përcjellja e veprimtarisë së emigracionit të RPSSH-së

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu
Me 21.08.1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të emigracioneve të RPSSH në Zvicër me aksionin " Tragaqa" si dhe me veprimtarinë armiqësore të disa punëtorëve tanë në Zvicër.

Takimi është mbajtur më 15.08.1984 në lokalet e DSHSSH Gjakovë prej orës 22.14. Me iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur.
Më 17.08.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSJ në Zvicër.

III

"Gjatë kohës sa janë duke punuar në Zvicër/Bernë jam njoftuar edhe me Tomë Zefin dhe Augustin Tinën që të dytë emigrant nga RPSSH e që tani jetojnë në Bernë. Toma në Zvicër jeton para 17 vitesh ndërsa Augustini afër 8 vitesh. Më parë Toma si emigrant kishte jetuar afër Titogradit pasi edhe tani vëllai prej babe i Tomës jeton diku në afërsi të Titogradit. Augustini punon një orë në ditë në një bibliotekë, ndërsa Toma punon si përkthyes pranë organeve gjyqësore dhe ato policore. Mosha e Tomës diku 50 vjeçar ndërsa e Augustinin 38-40 vjeçar. Augustini është i njohur si shitblerës i armëve të zjarrta e sidomos të revoleve. Kryesisht shitjen e revoleve e bën në mesin e punëtorëve tanë pasi që çdonjërit që i nevojitet revolja, pa kurrfarë pengese e blen tek Augustini. Përshtet kam qenë në banesë të Augustinit, ku përveç armëve kamë vërejtur edhe disa ekzemplarë të "Zërit të Popullit" e të " Zërit të Kosovës".

Plagosja e Tomës...

Në pyetjen time drejtuar Augustinit se 'a merresh edhe me politikë', ai është përgjigjur se këto gjëra i lexoj vetëm për kuriozitet, ndërsa politika

nuk më intereson e aq më pak të simpatizoj Shqipërinë". Augustini shpeshherë shihet me pjesëtarët e "Lëvizjes" e nëse nuk është në pyetje vetëm fitimi për shitjen e armëve, atëherë duhet të jetë lidhshmëria në veprimtari armiqësore. Nëse Shërbimi ka interes që të ndërmarrë ndonjë masë pasivizimi apo çfarëdo mase tjetër edhe me të ashpër ndaj Augustinit apo Tomës, tani ekzistojnë mundësitë pasi që këta i kanë plagosur rëndë me revole Reshad N. nga rrethi i Suharekës. Për këtë plagosje Toma ka qëndruar vetëm 14 ditë në burg e pastaj prapë e kanë lëshuar. Toma gjatë kohës sa ka qëndruar në burg duke e shfrytëzuar njoftësinë e tij me organet policore dhe ato gjyqësore ka denoncuar për Reshad N. se gjoja kryesisht merret me vjedhje, për ç'gjë policia e ka burgosur të njëjtin dhe e ka mbajtur në burg 7 muaj. Më parë Toma ka qenë në marrëdhënie të këqija me Nuridin N. nga Shkupi, i cili më parë e ka plagosur Tomën, duke ia marrë revolen nga dora Tomës dhe me të ka shtie në Tomën, e pasi që edhe Reshadi ka qenë prezent në këtë tollovi, më vonë Toma është hakmarrë në Reshadin. Me të kthyer të Nuridinit në Shkup, i njëjti është burgosur, mirëpo jam i bindur se për kohën sa ka qenë në Bernë, Nuridini asnjëherë nuk është marrë me veprimtarinë armiqësore por ekziston mundësi që Toma apo Augustini të kenë plasuar ndonjë të pavërtetë për Nuridinin, që këtij mos t'i mundësohet shkuarja prapë në Bernë. Pasi me siguri Nuridini do t'i hakmerret Tomës apo Augustinit. Për ndonjë masë të shërbimit kundër Tomës apo Augustinit nëpërmjet meje e Nuridinit kishte me u realizua pasi që unë jam në marrëdhënie tepër të mira si me Tomën ashtu edhe me Augustinin".

- Tomë Tinaj, emigrant nga RPSH e që tani jeton në Bernë/Zvicër, në moshë afro 65 vjeçar.
- Augustin Tinaj emigrant nga RPSH, tani jeton në Bernë-Zvicër, merret me shitjen e armëve.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurtë, shënimet e pavërtetuara. "Kobra" ka marrë për detyrë që prapë të kontaktojë me Tomën e Augustinin dhe më për së afërmi të njoftohet mbi përcaktueshmërinë politike të tyre.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet:

- 2 x SHSSH
- 1 x Evidencës
- 1 x Në lëndë të bashk. "Kobra".

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Përcjellja e Avdi Lekut dhe e Hajdar Sadriut

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu
Me 9. 08. 1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të Avdi Lekut, Hajdar Sadriut (LPO) nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmi shqiptar LRSNJ – në Zvicër.

Takimi është mbajtur më 9. 08. 1984 në lokalet e DSHSSH në Gjakovë, prej orës 9. 00 -10. 00

Sipas marrëveshjes, shpenzime nuk ka pasur, më 09. 08. 1984

II

Bashkëpunëtori edhe me parë ka dhënë shënime për veprimtarinë e Avdi Lekut nga Gjakova, për ç'gjë edhe ka qenë orientuar

III

"Para disa muajsh në Zvicër ka ardhur në vizitë babai Avdi Lekut, Isa. Së bashku me të ka ardhur edhe bashkëshortja e Avdiut dhe vajza e mitur. Isa para disa ditësh i ka thënë Avdiut që të shkojë tek Rustem Mahmutaj nga fsh. Lubeniç, i cili gjithashtu punon në Zvicër dhe është aktiv në LRSNJ, dhe atij t'ia përcjellë porosinë e Isas se në momentin e parë kur të takohem me të do ta vras, pasi Rustem ka qitë fjalë se Avdiu dhe Isa kanë spiunuar për dajë të Avdiut, Tahir Gecin të cilin më vonë edhe e kanë dënuar me burg. Pas takimit të Avdiut me Rustemin, Avdiu ia ka përcjellë fjalët e Isës në çka Rustemi aspak nuk është frikësuar por përkundrazi Avdiu ia ka treguar revolen duke i thënë se 'jam gati që të merrem vesh me ty po ashtu edhe babën tënd'. Është bindja ime e besoj se aspak nuk mund të gaboj kur them se Isa është tepër më i keq ideologjikisht sesa djali i tij Avdiu. Jam i bindur se Avdiu punon sipas udhëzimeve dhe me dijen e Isas. Isa është njeri që di t'i montojë gjërat ashtu sipas dëshirës dhe se është çudi e madhe se si Isa ka mundur që prapë të marrë pasaportën dhe shkoi në vizitë tek Avdiu, kur dihet se Avdiu është i njohur për veprimtari armiqësore kundër RSFJ-së. Si për Avdiun ashtu edhe për Rustemin nuk kanë bindje të mirë as të tjerët të "Lëvizjes" pasi ata kanë sjellje tejet arrogante. Kështu që në bisedë me

Hajdar Sadriun më thanë: "Njerëzit sikurse Rrustemi e Avdiu nuk na nevojiten pasi ata me sjelljet e tyre humbin autoritetin e "Lëvizjes". Ata grisin dhe asgjësojnë fotografitë të Titos si dhe kanë sjellje tjera të pamira. Kështu që nesër apo diku të kthehem pasi për këtë edhe po punoj ndërsa Avdiu e Rrustemi kur nuk do të mund të kthehen në Jugosllavi pasi ata do të të ndiqen për vepra të pamira".

Avdi Leku, nga (LPO) i njohur shërbimit për aktivitetet në veprimtarinë armiqësore kundër RSFJ-së.

Rrustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq, KK Pejë, pjesëmarrës aktiv në demonstratat antijugoslave, për të cilën është shkruar dhe më parë. Hajdar Sadrija nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë, (LPO) aktivist i dalluar i LRSHJ në Zvicër. Isa Leku, baba i Avdiut me banim në Gjakovë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori ka dhënë shënime interesante dhe të sakta prandaj çmojmë se edhe këto janë të vërteta. Pasi që Isa Leku gjendet në pushim tek djali i tij Avdiu, me ardhjen e tij në vend do të bisedohet me të. Bisedën do ta zhvillojë M. Slavkoviqi pasi me të është biseduar edhe më parë. Gjatë vërtetimit të këtyre shënimeve duhet të kihet kujdes që të mos dekonspirohet bashkëpunëtori kualitativ "Kobra".

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet

x SHSSH SKPB

x DSHSSH Pejë

x Evidencës

x në lëndë të bashk. "Kobra"

x në lëndë të Avdi Lekut

x pun. Të vijës së II-të.

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Ndjekja e klubit "Tefik Çanga" në Bernë

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtoria – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

me 13. 08. 1984
Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me aktivitetin armiqësor të klubit "Tefik Çanga" në Bernë – Zvicër, klub ky i udhëhequr nga anëtarët e LRSNJ-së.

Talimi është mbajtur më 10. 08. 1984 në terren sipas marrëveshjes

Me iniciativën e punëtorit operativ

Shpenzime nuk ka pasur.

Më 13. 08. 1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSNJ-së në Zvicër.

III

"Puna në klubin "Tefik Çanga" në Bernë është për çdo ditë më pasive e sidomos pas sulmit fizik të Rustem Mahmutajt nga Lybeniqi në Haxhi Berishën nga Deçani të cilin e akuzonin si spiun të Ambasadës. Përkundrazi Haxhiu ka qenë tepër aktiv në "Lëvizje" dhe se është munduar që sa më mirë të punojë ky klub. Nesër më aktivët ishin Rustem Mahmutaj, Salih Basha, Hjadar Sadrija si dhe dy studentë nga Kosova që para disa kohe kanë ardhur në Zvicër. Përderisa ky klub në kuadër të LRSNJ-së ishte më aktiv, Rustemi shpeshherë me videorekorder personal ka shfaqur filma me prejardhje nga RPSSH. Në këto lokale zakonisht shpërndahej edhe "Zëri i Kosovës". Në këtë lokal kohë pas kohe mblidheshin dhe bisedonin për çështje të Kosovës. Lokalet e këtij klubi i ka pasur përsipër Rustemi, i cili edhe është zotuar se do të paguajë qiranë e lokalit në vleftë 150 apo 200 franga në muaj. Klubi "Tefik Çanga" në Bernë tani është pasivizuar në tërësi dhe sa për shfrytëzimin e lokalit Rustemi ende nuk ia ka paguar borxhin qiradhënësit".

Rustem Mahmutaj, nga fshati Lybeniq KK Pejë, i punësuar në Zvicër, pjesëtar aktiv në demonstratat antijugosllave në Perëndim për të edhe më parë është shkuar:

Haxhi Berisha nga Deçani anëtar i klubit "LRSNJ" "Tefik Çanga" në Bernë.

Salih Basha për të edhe më parë është shkruar.

Hjadar Sadrija nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë. (LPO).

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori në fazën e verifikuar ndërsa shënime pjesërisht të vërtetuara edhe nga burimet tjera - Bashkëpunëtori "KOBRA" para se të

kthehet prapë në punë në Bernë do t'i jepen detyra të reja në përcjelljen e veprimtarisë armiqësore të anëtarëve të LRSNJ-së.

V

Vërejtjet, çmimet edhe vendimet e eprorit.

Dërgohet

x SHSSH SKPB

x Në lëndë të bashk. "Kobra"

x Evidencës

x në lëndë të H. Sadriut.

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

'Kobra' duhet përcjellë ansamblin shtetëror të Shqipërisë

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Më 09. 08. 1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të emigracionit shqiptar dhe të LRSNJ, në Zvicër.

Biseda është zhvilluar më 07. 08. 1984 prej orës 9, 00-11. 00 në lokalet e DSHSSH Gjakovë.

Në iniciativën e punëtorit operativ.

Shpenzime nuk ka pasur.

Më 07. 08. 1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSNJ në Zvicër.

III

"Më dt. 14. 07. 1984 nga ana e LRSNJ janë organizuar demonstrata të mëdha në Bernë – Zvicër në të cilat kam marrë pjesë edhe unë pasi po në këtë vend punoj dhe banoj. Përveç punëtorëve të zënë me punë në Zvicër, në demonstratë kanë ardhur edhe nga RF e Gjermanisë dhe Belgjika e që ky numër ishte afër 1500-2000 veta. Nga Zvicra më së tepërmi ka pasur nga klubet e "Lëvizjes" si ata të Cyrihit, Gjenevës. St.

Gallenit, Lozanës, të Bielbit etj. Vendtubimi ishte nga stacioni i trenit prej nga edhe jemi nisur në drejtim të qytetit dhe jemi ndalur para Ambasadës së RSFJ. Demonstruesit me vete kanë bartur afër 50 parulla, pastaj fotografi të ndryshme të personave të vrarë apo të burgosur si ato të Gërvallave, Rexhep Malës, Sami Kurteshit, Nuhi Berishës, Adem Demaçit, Shemsedin Kamberit, Hyzerin Sadikut, Afrim Abazit, Sherif Frangut, Fazli Grajçevcit, Tahir Gecit etj.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ: Bashkëpunëtorit "Kobra" iu është dhënë për detyrë që të përcjellë koncertin në qytetin Bernë, e sipas mundësive dhe në ndonjë qytet tjetër me qëllim që të përcjellë kontaktet e punëtorëve tanë dhe të personave interesantë për nga aspekti i Shërbimit dhe udhëheqësit apo anëtarëve të ansamblit shtetëror të këngëve dhe valleve të RPSSH-së.

V

Vërejtjet, vlerësime dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet

x SHSSH SKPB

x këtij Drejtorati

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

Raportimi i 'Kobrës' për demonstratat e Bernës

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Më 13. 11. 1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me identifikimin e pjesëmarrësve në demonstratat antijugosllave të organizuara nga LRSNJ në Zvicër, në vitin 1983.

Materialet dhe fotografitë janë dërguar nëpërmjet dërgesave postare më dt.. 09. 11. 1984

me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Më 13. 11. 1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e disa anëtarëve të LRSNJ-së në Zvicër.

III

Në demonstratat e organizuara në Zvicër në vitin 1983 përveç shumë punëtorëve në to ka marrë pjesë edhe Rustem Mahmutaj, nga fsh Lubeniq KK Pejë dhe Brahim Elezaj nga fshati Jabllanicë e vogël, KK Pejë. Nga Rustemi kamë arritur që të marr 3 fotografi në të cilat shihet pjesëmarrja aktive e tij në këto demonstrata me veshje kombëtare duke e bartë flamurin kombëtar. Së bashku me Rustemin shihet edhe Brahim Elezi, i cili shihet në fotografi me dy duart lart. Brahim Elezi kohën e fundit punon në Bernë.

Bashkëpunëtori "Kobra" së bashku me raport dërgon edhe këto materiale "ILLYRIA" prospekt mbi porositë e librave dhe gazetave të RPSSH-së, pastaj dy numra të "Zërit të Popullit" organ i KQ PPSH, të dt. 24 e 25 10 1984. Në numrin e datës 24. 10. 1984 përveç artikujve tjerë është edhe artikulli: "Dhuna e vazhdueshme antishqiptare në Kosovë kundër inteligjencës – përjashton profesorë të Universitetit të Prishtinës". Së bashku me këto gazeta "Kobra" dërgon edhe këto gjëra: fotokopje e gazetës "Zëri i Popullit" me titull "Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë dhe gjendja në Jugosllavi", broshurën "Kosova, zhvillimi Krahinor dhe integrimi kombëtar në Jugosllavi" të cilën e boton " Zëri i Kosovës" organ i LRSSHJ në mërgim", pastaj "Komunikatën dhe Kushtrimin", "..... dhe " Parolajmërimin".

Rustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq KK Pejë për të është shkruar edhe më parë. Brahim Elezaj nga fsh. Jabllanicë e vogël, KK Pejë, tani i punësuar në Zvicër- Bernë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ: Bashkëpunëtori i sigurt dhe shënimet e vërtetuara pasi flasin materialet dhe fotografitë e prezantuara. Duhet pasur kujdes të posaçëm gjatë identifikimi të personave nëpërmjet fotografisë personalisht janë të marra nga Rustem Mahmutaj nga ana e "Kobrës"

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet

x SHSSH SKPB

x Evidencës

x në lëndë të "Kobrës"

Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu

Kobra dërgon në UDB vazhdimisht "Zërin e Kosovës"

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandues nga RPSSH që qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

Materiali është dërguar (shihet vula e dt.30.10.1984) ndërsa në DSHSSH – Gjakovë ka arritur më 08.11.1984. Me iniciativën e bashkëpunëtorit Shpenzime nuk ka pasur, më 13.11.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së

III Bashkëpunëtori "Kobra" në dërgesën e vet nëpërmjet dërgesës postare ka sjellë 6 gazeta "Zëri i Kosovës" Organ i KQ PPSH, të datave 17,18,19,20,21 dhe 23,10,1984. Në numrin e datës 17.10.1984, është artikulli: "Ekonomia jugosllave në vështirësi të vazhdueshme ne detyrohemi ta shtyjme në afatin e shlyerjes së borxheve, pohon kryeministrja PLANINC". Në gazetatat tjera nuk shkruhet për Jugosllavinë. Së bashku me këto gazeta "Kobra" ka dërguar edhe "Zërin e Kosovës" nr.9 tetor 1984.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori edhe më parë rregullisht ka dërguar gazetatat "Zëri i Popullit" si dhe materialet tjera interesante. Së shpejti pritet mbi aktivitetin e disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet

1 x SHSSH SKPB
1 x Evidencës
1 x në lëndë të bashk."Kobra"
Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu

Bashkëpunëtori "Sllavia" bisedon me ambasadorin e Shqipërisë

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu
Me 30.10.1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me materialet propagandistike nga RPSSH të cilat qarkullonin në mesin e disa punëtorëve të zënë me punë të përkohshme në Zvicër. Materiali ka arritur më 30.10.1984 nëpërmjet SHSSH të SKPB-E

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur, më 30.10.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet dërgesës postare në emër të punëtorit operativ që e mban në lidhje ka dërguar 6 copë gazeta "Zëri i Popullit" organ i KQ të PPSH të dt.10,11,12,13,14 dhe 16 tetor 1984. Në gazetën e dt. 13 tetor 1984 është artikulli "Politika antishqiptare e udhëheqësve Jugosllav – një politikë e shëmtuar "ku artikullshkruesi bën një rrëzim propagandistike të drejtuar kundër sistemit të RSFJ-së.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Lidhur me artikullin në fjalë bashkëpunëtori "Sllavia" në bisedë dhe kontaktin që e ka pasur me Ambasadorin e RPSSH në Vjenë - Idriz Bardhin i ka prezantuar në raportin e dt. 25.10.1984 (raporti nga kombinimi operativ "SHEN BRUN) e që do të thotë se shënimet e

prezantuara nga bashkëpunëtori "Sllavia" janë të sakta. Me bashkëpunëtorin "Kobra" do të merremi vesh mbi mënyrën e dërgesave dhe materialeve tjera me ardhjen e tij në vendlindje.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk."Kobra"

1 x Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Lavdërohet puna e "Kobrës" nga Muharrem Dana

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkëngjitur aktit përcjellës ju dërgojmë materialet të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: Kuverta me materiale

Kryeshef i sektorit II Muharrem Dana

Lidhur me raportin e bashkëpunëtorit "Kobra" nr. 634 të datës 3.10.1984 ju rekomandojmë që t'i sugjerojmë bashkëpunëtorit mënyrën e dërgimit të raporteve në mënyrë që të mos vijë deri të dekonspirimi i tij sepse është në rrugë të mirë që të krijohet si lidhje e fortë.

Gjithashtu sugjerojmë që emrat e personave nga terrenet tjera që përmenden në raportet e tij t'i dërgohen qendrave përkatëse.

Kryeshef i sektorit II, Muharrem Dana

Kobra përcjell koncertet...

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me materialet propagandistike nga RPSH i cili qarkullon në mesin e disa punëtorëve tanë përkohësisht të punësuar në Zvicër. Materiali "Zëri i Popullit" organ i KQ PPSH (5 copë) ka arritur me iniciativën e bashkëpunëtorit, shpenzime nuk ka pasur.

Më 19.10.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSNJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet dërgesës postare në adresë të punëtorit operativ i cili mban në lidhje, ka dërguar 5 numra të "Zërit të Popullit", organ i KQPPSH-së. Me këtë rast "Kobra" dërgon numrat e datës 3,5,6,7 e 9 tetor 1984. Pas vështrimit të këtyre gazetave në "Zërin e Popullit" të datës 03.10.1984 në artikullin "Sukseset e Ansamblit tonë të këngëve dhe valleve në turneun e tij në Zvicër përveç tjerash shkruhet: "...në shfaqjet e ansamblit kishin ardhur shqiptarë me banim në Zvicër, RF Gjermane, Sued, Belgjikë Francë, Austri, Luksemburg etj... Këngë 'Enver Hoxha tungjatjeta' "Shqipëria, Shqipëria, Enver Hoxha, Enver Hoxha" etj. Në numrin e "Zëri i Popullit" të datës 7.10.1984 është artikulli "Vazhdon Terrori kundër shqiptarëve në Kosovë i cili artikull bën fjalë për gjykimin e anëtarëve të grupit ilegal "Komiteti i Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi. Në numrin tjetër të datës 9.10.1984 janë dy artikuj njëjtë" "Jugosllavia saboton përfundimin e programit për bashkëpunim kulturor me Shqipërinë" dhe tjetrin artikull "Vendi ynë merr pjesë në panairin ndërkombëtar të librit në Frankfurt", ku përveç tjerash shkruhet; "... Vizitorët kanë treguar interes të madh për librin shqiptar, veçanërisht për veprat e shokut Enver Hoxha, si "Titistët" dhe "Shënimet për Lidhjen e Mesme" etj.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Së bashku me raportin ju sjellim edhe 5 numrat e gazetës "Zëri i Popullit" organ i KQ PPSH

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eporit:

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me materialet propagandistike nga RPSSH i cili qarkullon në mesin e disa punëtorëve përkohësisht të zënë me punë në Zvicër.

Materiali "Zëri i Popullit" ka arritur më 18.10.1984.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur.

Më 18.10.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSNJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet dërgesës postare ka dërguar në adresë të punëtorit operativ i cili mban në lidhje, këta numra të "Zërit të Popullit" organ i Komitetit Qendror të datave 28, 29, 30 shtator dhe 2 e 4 tetor 1984. Në numrin e dt. 29 shtator është artikulli "dhëniet e kredive të reja për Jugosllavinë nga banka Evropiane e Investimeve". Në numrin e datës 30 shtator, në artikullin "Ansambli i këngëve dhe valleve popullore vazhdon me suksese turneun në Zvicër përveç tjerash thuhet në këtë artikull se kënga më e mirë ka qenë "Enver Hoxha tungjatjeta" e cila gjatë gjithë kohës u përcoll me duartrokitje dhe spektatorët u ngritën në këmbë..." Në artikullin e datës 2.10. 1984 , është artikulli " Në Kosovë thellohet prapambetja dhe rritet vështirësitë ekonomike".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ: Pasi që bashkëpunëtori gjendet në punë në Zvicër, nuk dihet se nga e merr shtypin "Zëri i Popullit" por me ardhjen e tij në vend do të sqarohet këtë rrethanë. Së bashku me raport ju dërgojmë edhe 5 gazeta "Zëri i Popullit".

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x në lëndë të bashk."Kobra"

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu.

Raport për shitjen e librave të Demaçit e Jusuf Gërvallës

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu
Me 11.10.1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me vizitën e Ansambilit Shtetëror nga RPSSH disa qyteteve në Zvicër, dhe pjesëmarrja e disa qytetarëve tanë në eksponimet armiqësore. Raporti është dërguar nëpërmjet postës dhe mban vulën e dt.3.10.1984. Me iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur.

Më 11.10.1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSHJ-së në Zvicër

III

Bashkëpunëtori në raportin e vet të shkruar me dorë përveç tjerash thotë: Të dielën, më 30.09.1984. Ansambli i RPSSH i cili gjendet në turne në Zvicër, ka organizuar koncertin për punëtor tanë në qytetin. Para se të arrijë Ansambli në Zvicër, nëpërmjet reklamave dhe propagandimeve të ndryshme, organizatorët patën arrij që t'i shesin të gjitha biletat, mirëpo pas shfaqjes së disa koncerteve dhe ekspozimeve të ndryshme nga disa të pranishëm nëpër këto koncerte, shumica e punëtorëve biletat e vlera më parë i kanë kthyer mirëpo prapëseprapë sallat ishin të përmbushura me vizitorë. Në koncerti ka filluar në orën 14.30 dhe mbaroi në 17.30. Në këtë sallë të madhe prezent ishin afër 600 veta, kuptohet të gjithë të kombësisë shqiptare. Në këtë qytet disa pjesëtarë të koncerteve të organizuara në RFGJ, si dhe disa shirita të kasetofonit me këngë të ndryshme. Koncerti filloi me duartrokitje dhe brohoritje "Enver Hoxha, Enver Hoxha" kurse nga disa të tjerë dëgjohej ndonjë brohoritje "Kosova Republikë" nga ana e publikut. Këngëtarit Arif Vladit iu dha një tubë lule dhe një flamur shqiptar pas këndimit të këngës "Prite Azem Bejtën". Pas mbarimit të koncertit disa persona të panjohur për mua kanë shitur libra si "Gjarpërinjtë e gjakut" të Adem Demaçit. Pastaj të Jusuf Gërvallës etj.

Në mesin e shitësve të këtyre librave, kam vërejtur edhe Salih Bashën me disa shokë të vet. Një person i "Lëvizjes" i panjohur për mua, ka bërë incizimin e koncerteve me kamerë televizive.

Bashkorganizator i këtyre koncerteve janë vëllezërit Hajdari dhe Ademi nga fshati Ponoshec, KK Gjakovë, të cilët edhe i kanë përcjellë koncertet e dhëna nëpër Zvicër (fjala është për Hajdar dhe Adem Sadriun nga fsh Ponoshec KK Gjakovë) lëndë në PO vr. Epun.op.)

Rrustem Mahmutaj nuk ka arritur të vijë në koncertin e Winterturit pasi ka qenë i zënë me shpërndarjen e një numri të madh të gazetave "Zëri i Kosovës"

Në koncertin e Bernës kishte qenë edhe Beati i cili punon dhe shet libra e gazeta "Zëri i Kosovës" në bibliotekën Buchandlung Badhausstrase 35 Biell. Beati është pjesëtar i Partisë Marksiste Leniniste të Zvicrës.

- Arif Vladi, këngëtar i Ansambilit të RPSSH-së
- Sali Basha, punëtor në Zvicër i njohur nga Shërbimi
- Hajdar Sadrija nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë, interesant për nga aspekti i Shërbimit (LPO)
- Adem Sadrija nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë, interesant për nga aspekti i Shërbimit.
- Rrustem Mahmutaj nga fsh. Lybeniq, KK Pejë, interesant nga aspekti i Shërbimit.
- Beati N. shtetas i Zvicrës merret me shitjen e librave dhe materialeve tjetër propagandistike antijugosllave.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Shënimet e pavërtetuara por munden me qenë plotësisht të sakta. Me ardhjen e "Kobrës" në vend më detajisht do të bisedohet me të rreth identifikimit të personave që kanë marrë pjesë nëpër këto koncerte e sidomos atyre të cilët kanë bërë titur dhe brohoritur parulla armiqësore. Së bashku me raport, "Kobra" dërgon edhe dy numra të gazetës "Zëri i Popullit" të dt.26. e 27 shtator 1984 të cilat gazeta do të jenë pjesë përbërëse e këtij raporti.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet

- 2 x SHSSH SKPB
 - 1 x Evidencës
 - 1 x në lëndë bashk. "Kobra"
 - 1 x Punëtori përgjegjës së vijës së II
- Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

'Kobra' përcjell Ansamblin e Shqipërisë...

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtoria – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu, më 6. 10. 1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me materialet propagandistike që arrijnë nga RPSH. në Zvicër. Bashkëpunëtori ka dërguar me dërgesë postare më dt. 6. 10. 1984.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit, shpenzime nuk ka pasur. Më 6. 10. 1984.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSJ-së në Zvicër

III

Nga bashkëpunëtori "Kobra" i cili punon përkohësisht në Zvicër/Bernë. Më dt 6. 10. 1984 kanë arritur 6 numra të "Zërit të Popullit" organ i Komitetit Qendror të PPSH-së të datave 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20. 19. 1984. Në numrin e datës 19 shtator 1984 është artikulli "Kredi e re e Bankës Amerikane Eksport -Import" si dhe numrin 20 shtator 1984, është artikulli: "Pasoja të thellimit të krizës në Jugosllavi".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori edhe më parë ka dërguar materiale dhe gazeta të njëjta. Së bashku me raportin ju dërgojmë edhe 6 numrat e "Zërit të Popullit"

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x Në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtoria – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu
Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me eksponimet armiqësore të anëtarëve të LRSNJ-së dhe të disa punëtorëve tjerë me rastin e shfaqjes së koncertit të RPSSH-së në Zvicër. Bashkëpunëtori me letër të dt. 2. 10. 1984 përcjell vërejtjet e veta. Me iniciativën e bashkëpunëtorit, shpenzime nuk ka pasur. Më 3. 10. 1984

Identifikimi i pjesëmarrësve në koncert

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e LRSNJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" në letrën e dërguar shkruan: "Më datë 22. 09. 1984 në Bernë ka arritur Ansambli i këngëve dhe valleve popullore nga RPSSH, Ansambël ky i cili për herë të parë ka ardhur në Zvicër. Nga punëtorët tanë të punësuar në Zvicër Ansambli u prit me mirëseardhje dhe në orën 20 filloi edhe koncerti ku zgjati gjerë në orën 23. 30 minuta. Koncerti u mbajt në sallën "Theater in National" në prezencën e afër 900 - 1000 vetave. Gjatë koncertit janë dëgjuar brohoritje të mëdha "Parti Enver jemi gati kurdoherë". Në sallë ishin të vendosur 2 fotografi të Enver Hoxhës. Në këtë koncert prezent ka qenë edhe ambasadori i RPSSH në Vjenë, Idriz Bardhi dhe disa të tjerë. Ansambli i printe Imer Gjosi i cili ishte në kontakt me anëtarët e LRSNJ-së dhe të celulave të LRSNJ-së si p. sh Hasan Malën "Mixhën" pastaj Rustem Mahmutajn nga Lybeniqi, Ademi së bashku me vëllain Hajdarin (Adem e Hajdar Sadrija vr. punë operativ) nga një fshat afër Gjakovës etj. Ndër persona tjerë që kanë qenë prezentë në këtë koncert kam njohur Remzi dhe Shemsi Cekajn nga fshati Doganaj, KK Kaçanik. Idriz Halili nga Kaçaniku të cilin e thërrasin edhe Idriz Seferi ka kërkuar azil politik. Brahim Elezaj nga fshati Jabllanic e vogël, KK Pejë. Zeqë Ramadani dhe vëllai i vogël i tij nga fshati Firaj, KK Ferizaj. Rrahman Nikë Provelija afër Kaçanikut, Faik Caka nga fshati Doganaj, KK Kaçanik e ky i fundit ka qenë edhe në demonstratën e dytë me radhë, e cila është organizuar në Bernë. Pastaj Faik Mitrovica nga Mitrovica e Titos, i cili në Zvicër punon që 8 vite, Selim Haziri nga rrethi i Prishtinës (baba e ka emrin HAZIR) i cili ka marrë pjesë në tri demonstratat e organizuara në Bernë. Gjemë Kumanova me vendbanim afër Shkupit, i cili gjithashtu ka marrë pjesë në demonstratën e parë dhe

të dytën në Bernë, si dhe enveristi i njohur Hasan Haxhaja afër Kaçanikut, së bashku me Ismajl Kolshin afër Kaçanikut.

Ismajli nuk është i përzier në çështje politike kundër RSFJ-së, por me siguri shokët e kanë marrë në këtë koncert, ku ka qenë edhe Tashk Ndue Uka nga Beci, KK Gjakovë, i cili ka ardhur prej (qyteti apo vendi është i paqartë, - v e pun op.) për të përcjellë këtë koncert. Pashku ka marrë pjesë në disa demonstrata antijugosllave të organizuara në Zvicër dhe jashtë saj, pastaj ka qenë në demonstratat e Berlinit. Pashku është anëtar i klubit në qytetin ku punon. Me mbarimin e koncertit prapë nga të pranishmit në sallë filluan brohoritje "Enver Hoxha tungjatjeta" dhe këngëtarëve iu dorëzua disa tubë lulesh.

Në këtë koncert nuk qenë Riza Alija nga rrethi i Gjakovës (fjala është për Riza Ali nga fshati Dobriq, KK Gjakovë. - vr. e pun op.) por Rizaja ishte pjesëmarrës në shumë manifestime antijugosllave si: demonstratat e Bernës, pastaj ka qenë në Lucern kur është festuar 70 vjetori i Lindjes së Enver Hoxhës. Ka qenë në Cyrih kur është shqyer flamuri jugosllav dhe prish rendi dhe qetësia publike. Rizaja është duke punuar në Zvicër në qytetin Sursee"

e)

- Idriz Bardhi, ambasador i RPSSH-së në Austri/Vjenë
- Imer Gjosi, udhëheqës rrugë i këtij ansambli
- Hasan Mala "Mixha" i njohur nga shërbimi
- Rrustem Mahmutaj nga Lybeniqi, KK Pejë, i njohur i shërbimit
- Hajdar Sadrija (LPO) nga fshati Ponoshec, KK Gjakovë, tani në Zvicër
- Adem Sadrija (LPO) nga fshati Ponoshec, KK Gjakovë, tani në Zvicër.
- Remzi Cekaj nga fshati Doganaj, KK Kaçanik
- Shemsi Cekaj nga fshati Doganaj, KK Kaçanik
- Idriz Halimi nga Kaçaniku
- Brahim Elezaj nga fshati Jabllanic e vogël, KK Pejë
- Zeqë Ramadani nga fshati Friajë, KK Ferizaj
- N. Ramadani vëllai i Zeqës nga fshati Firaaj
- Rrahman Nikë Provelija afër Kaçanikut
- Faik Caka nga fshati Doganaj, KK Kaçanik
- Faik Mitrovica nga Mitrovica e Titos
- Selim Haziri nga apo rrethi i Prishtinës
- Xhemë Kumanova afër Shkupit
- Hasan Haxhanja afër Kaçanikut
- Pashk Ndue Uka nga Beci KK Gjakovë
- Riza Ali Shabanaj nga fshati Dobriq, KK Gjakovë për të cilin kemi edhe shënime operative tjera mbi veprimtarinë e tij gjatë qëndrimit të tij në Zvicër.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ: Shënimet e vërtetuara vetëm kur bëhet fjalë për Riza Shabanaj, ndërsa të tjerat mundën me qentë të sakta pasi "Kobra" në bashkëpunim me ne tregohet i sigurtë. Kohë pas kohe me të mbahen bisedat përmes telefonit dhe për çdo gjë me kohë njoftohemi. Së bashku me raport "Kobra" ka dërguar edhe nr. 8 të "Zëri të Kosovës" programin e Ansambllit të RPSSH si dhe "njoftimin" mbi mbajtjen e koncerteve e që këto do të jenë pjesë përbërëse e këtij raporti:

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit"

Dërgohet

- 2 x SHSSH SKPB
 - 1 x DSHSSH Ferizaj
 - 1 x DSHSSH Pejë
 - 1 x DSHSSH Mitrovicë Titos
 - 1 x DSHSSH Prishtinë
 - 1 x Evidencës
 - 1 x në lëndë të bashkë. "Kobra"
 - 1 x punëtori të linjës II.
- Punëtori operativ
Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me disa shkrime antijugosllave të gazetave "Zëri i Popullit" organ i KQ të PPSH

Materiali ka arritur më dt. 25. 09. 1984

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Më 25. 09. 1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSHJ në Zvicër

III

Bashkëpunëtori "Kobra" përmes postës në adresë të punëtorit operativ që mban në lidhje dërgon 6 numra të "Zëri të Kosovës" të dt. 7, 8, 9, 11, 12,

13 shtator 1984. Në gazetën e datës 8. 091984 Është artikulli "Vetadministrimi Jugosllav administrohet nga kapitali i huaj" dhe në gazetën e datës 13. 09 1984 është artikulli "Luftanije Amerikane në portin jugosllav në Rjekë".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori kohë pas kohe dërgon gazetatat e tilla si dhe material tjetër antijugosllav që shtypet, lexohet dhe përpunohet nga LRSNJ

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x në lëndë të bahk. "Kobra"

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarin armiqësore të LRSNJ në Zvicër

Bashkëpunëtori me letër të datës 5 dhe 7. 09. 1984 njofton shërbimin mbi vërejtjet e tij. Në iniciativën e bashkëpunëtorit, shpenzime nuk ka pasur.

Më 20. 09. 1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSNJ- në Zvicër

Raport për vëllezërit Ramadan dhe Zeqë Ramadani nga Ferizaj

III

Bashkëpunëtori në letrat e dërguara nga Zvicra të dt 5 dhe 9. 09. 1984 dërgon 5 numra të "Zëri të Popullit" organ i Komitetit Qendror të PRSH. Në numrat 4 dhe 5 shtator janë dy artikuj ku flitet për Jugosllavinë. Në letrën tjetër bashkëpunëtori shkruan: "... . Kentunit të Bernit në vendin e

quajtur Egivil punonjës vëllezërit Ramadan dhe Zeqë Ramadani, përndryshe familja e tyre jetojnë në fshatin Firajë, KK Ferizaj. Ramadani në Zvicër nuk ka aspak sjellje të mira dhe se vetin e çmon si Enverist të madh. Mban dhe shpërndan fotografi të Enver Hoxhës dhe është në kontakt të vazhdueshëm me Rrustem Mahmutajn nga rrethi i Pejës i cili është i njohur për veprimtarin armiqësore kundër RSFJ. ”

Vërejtje për ruajtjen e 'Kobrës'

Ramadan Ramadani nga fshati Firaj, KK Ferizaj përkohësisht i zënë me punë në Zvicër – Evigil
- Rrustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq, KK Pejë, pjesëmarrës aktiv në të gjitha demonstratat antijugosllave në Perëndim i njohur nga Shërbimi.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sinqertë ndërsa Shënimet e pavërtetuara. Gjatë vërtetimit të këtyre shënimeve duhet pasur kujdes pasi është pyetje bashkëpunëtori tepër kualitativ. Me një kopje të këtij raporti është njohur edhe DSHSH – Ferizaj.

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

- 2 x SHSSH SKPB
 - 1 x DSHSSH – Ferizaj
 - 1 x në lëndë të bashkë, "Kobra"
 - 1 x Evidencës
- Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu
Me 18. 09. 1984

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"
Shënimet kanë të bëjnë me ardhjen e ansamblit shtetëror të këngëve dhe valleve popullore të RPSSH në Zvicër.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit
Shpenzime nuk ka pasur.
Raporti paraqitet më 18. 09. 1984

II

Bashkëpunëtori është i orientuar që të përcjellë veprimtarinë armiqësore të LRSHJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori në letrën e dërguar ka future dhe programin mbi koncertin e ansamblit të valleve dhe këngëve popullore të Shqipërisë me titull "SHQIPONJAT FLUTUROJNË MBI ALPE" gjatë turneut të ansamblit në fjalë në Zvicër. Nga programi shihet dita, data, ora dhe vendi i mbajtjes së shfaqjeve. Në parathënien e këtij programi, përpos tjerash është shkruar dhe" e gjithë kjo është e kuptueshme sepse ky art socialist bazohet fuqishëm në tabanin kombëtar dhe kultivohet e përpunohet me të madhe nën kujdesin e vazhdueshëm të vijës së drejtë të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe udhëheqësit të saj Enver Hoxhës".
Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë plikon me materiale të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: Plikoja me materiale
Kryeshef i Sektorit të II
Enver Prekadinaj

Kuvertat dërgoheshin në emër të Sejfullah Sahatçiu

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë materialet të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra. Shtojnë kuverta me materiale
Kryeshef i Sektorit II, Muharrem Dana.

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë.

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë kuvertën me materiale e cila në emër të Sejfullah Sahatçiu ka mbërritur nga Zvicra. Ju bëjmë me dije se këto materiale kanë ardhur përmes doganës ku edhe janë hapur kështu që nuk jemi të sigurt se mos ka pasur edhe diç me to, mirëpo nëse nga lidhja do të informohemi se ka pasur edhe diç, atëherë ju lutem që të na informoni me këtë.

Shtojcë kuverta me materiale

Kryeshef i Sektorit II, Enver Prekadinaj.

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë kuvertën me materiale të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Luteni që pasi të shkruani shënimin zyrtar së bashku me të, të na i dërgoni edhe fotografitë që kanë arritur me këto materiale pasi që personat në to nuk janë nga terreni i juaj, në mënyrë që të njëjtat t'ia dërgojmë qendrave nga janë personat në to.

Shtojcë, kuverta me materiale

Kryeshef i Sektorit II, Muharrem Dana.

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë.

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë kovetën me materiale të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë, kuverta me materiale

Kryeshef i SEKTORIT II, Muharrem Dana.

Raport i "Kobrës" për literaturën që shitej në perëndim

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore propaganduese të LRSHJ-së në Zvicër. Përmes postës ka arritur dërgesa postare më 6. 12. 1984

Me iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur. Raporti paraqitet më 7. 12. 1984.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori përmes dërgesës postare në raportin e vet përveç tjerash cek: "më dt. 17. 11. 1984 Beat Schafer (e njohu me bibliotekën – librarinë e saj

në Biell ver. e pun. op) ka hapur bibliotekën – librarinë e saj edhe në Bernë në rrugën "NEUENGASSE" 43 von Werdt-Passage. Beati këtë bibliotekë – librari e ka hapur së bashku me një ish-student nga Prishtina i cili kishte qenë pjesëmarrës i demonstratave në Prishtinë si dhe në ato antijugosllave të organizuara në Bernë. Emri i tij ende nuk më është i njohur. Në këtë bibliotekë/librari kam vërejtë përveç librave tjera edhe këto "Titistët" "Die Ttitoisten" "TITISTI" LES TITIST THE TITOITES DIE EREUNGNISE IN KOSOVO, NGJARJET NË KOSOVË, Romani "Rrotull" nga Jusuf Gërvalla, Mic Sokoli "Bajram Curi, Jakup Ferri, Idriz Seferi, Shota dhe Azem Galica e shumë libra tjerë me prejardhje nga RPSSH"

Bashkëpunëtori së bashku me raportin dërgon edhe "Ftesën " për manifestimin që është mbajë nga ana e LRSJ-së në Cyrih me datë 24. 11. 1984 si dhe një gazetë në gjuhën gjermane "DER Bund" e cila shkruan për Jugosllavinë dhe Kosovën.

Beat Schafer më parë ka pasur librarinë e vet në Biell e cila vazhdimisht ka shitur libra propagandistike të shtypura në RPSSH, tani si e tillë është paraqitur edhe në Bernë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt shënimet e prezantuara janë të sakta. Së bashku me këtë raport ju sjellim edhe "Ftesën" dhe gazetën "Der Bund".

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet

1 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës

1 x punëtorit të vijës II, punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu.

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati – Gjakovë, Sektori II

Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu, më 3. 12. 1984.

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me materiale propagandistike i cili qarkullon dhe lexohet nga anëtarët e LRSJ-së, në Zvicër

Dërgesat kanë arritur në DSHSSH më dt. 3. 12. 1984. Me iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur. Më 03. 12. 1984

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSNJ-së në Zvicër

Raportohen edhe shkrimet e gazetave gjermane që shkruanin për Kosovën

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet dërgesës postare e në emër të punëtorit operativ i cili e mban në lidhje atë, dërgon 5 numra të gazetës "Zëri i Popullit" organ i KQ PPSH të datave 9, 10, 11, 13, 14 nëntor 1984, pastaj një gazetë në gjuhën gjermane "Berner Zeitung" si dhe librin me titull: "Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen e Prizrenit 1878-1881" e botuar në Tiranë më 1979. Në gazetën "Zeri i Popullit" të dt. 13. 11. 1984 është artikulli: "Në Kosovë të rinjtë e të miturit dënohen me 11 vjet burgim se paska qëlluar me gurë xhamat e një dritareje. Në gazetën gjermane "Berner Zeitung" është një artikull i cili bën fjalë për vendin tonë, ndërsa në librin e cekur më lart janë pjesëmarrësit nga të gjitha vendet ashtu edhe nga Kosova të cilët me punimet e veta janë paraqitur në këtë konferencë të mbajtur prej 12-28 nëntor 1978 në Tiranë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt shënimet e vërtetuara pasi vetë materiali flet gjëra të tilla. Së bashku me raport ju dërgojmë edhe gazetat (6 cipë) dhe librin.

V

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës, punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Drejtorati i SHSSH, Gjakovë. Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë kuvertën me materiale të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra. Shtojcë, kuverta me materiale
Ndihmësi i kryeshefit të sek. II, Zija Musliu

Të dhënat e "Kobrës" identike me të dhënat e bashkëpunëtorit "Mengjer"

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu, më 21. 11. 1984.

Raport i bashkëpunëtorit.

I

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA"

Shënimet kanë të bëjnë me organizimin e demonstratave antijugosllave nga ana e LRSHJ-së në Zvicër. Biseda është zhvilluar nëpërmjet telefonit më dt. 20. 11. 1984. Me iniciativën e bashkëpunëtorit. Shpenzime nuk ka pasur. Më 21. 11. 1984.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

III

Më dt. 20. 11. 1984 nëpërmjet telefonit bashkëpunëtori "Kobra" lajmëron sa vijon : "Manifestimi do të bëhet më dt. 24. 11. 1984 duke filluar në orën 18. 00. Ky manifestim do të bëhet në Cyrih – Zvicër. Unë personalisht nuk mund të marr pjesë në të, pasi që atë ditë do të jem i zënë me punë, mirëpo do të interesohem që të di mbi pjesëmarrësit në to"

IV

Vërejtjet e pun op.

Shënime e prezantuara nga bashkëpunëtori "Kobra" janë të sakta pasi që të dhëna e tilla kemi edhe nga bashkëpunëtori "Mengjer" për ç'gjë jeni njoftuar edhe me depeshën tonë nr. 253 të dt. 20. 11. 1984

Sipas marrëveshjes me bashkëpunëtorin "Kobra" fjala 'manifestohet' ka domethënien – organizim i demonstratave. Me siguri pritet që "Kobra" së shpejti të kthehet në atdhe për ç'gjë do të na informojë më për së afërmi lidhur me këto demonstrata.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit

Dërgohet

3 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x një herë në lëndë të bashk. "Kobra"
1 x punt. të vijës së dytë.
Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu
Sekretariati krahinor për punë të brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati Gjakovë
Punt. Op. Sejfullah Sahatçiu
Më 5. 01. 1985
Raport i bashkëpunëtorit.

I

- Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"
- Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik, i cili qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSSHJ, në Zvicër.
- Materiali ka arritur më dt. 05. 03. 1985.
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit
- Shpenzime nuk ka pasur.
- Raporti paraqitet me 05. 03. 1985

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ, në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "KOBRA" përmes postës e pastaj përmes SKPB, ka dërguar 19 copë gazeta "Zëri i Popullit" organ të Komitetit Qendror të PPSH të datave 31 janar 1985, 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20 dhe 21 shkurt 1985. në gazetën e dt. 1 shkurt 1985, është artikulli "Vazhdojnë dënimet kundër shqiptarëve në Maqedoni" dhe në gazetën e dt. 21 shkurt 1985, është artikulli :Rriten çmimet e bukës në Jugosllavi". Bashkëpunëtori së bashku me këto gazeta dërgon edhe pamfletin "Zëri i Kosovës" në nr. 2/1985.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori me vetë dëshirë dërgon materialet në fjalë. Nëse ju e çmoni se materialet e tilla janë të pavlefshme, na njoftoni me qëllim që të ndërpritet kjo praktikë. Të gjitha gazetatat e cekura janë pjesë e raportit të cilat ju sjellim juve.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet :

2 X SHSSH SKPB
1 X në lëndë të bashk. "KOBRA"
1 X Evidencës
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu
Drejtorati i SHSH, Gjakovë.

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë plikon me materiale, të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërri nga Zvicra.
Shtojcë: Plikoja me materiale

Raportim për protestat në Shtutgart

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati – Gjakovë, Sektori II
Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu. Më 31. 01. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

- Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".
- Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore dhe materialin propagandistik të LRSSHJ në Zvicër.
- Materialet kanë arritur më dt. 31. 01. 1985, nëpërmjet dërgesës postare.
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit
- Shpenzime nuk ka pasur.
- Më 31. 01. 1985

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

III

a/

Bashkëpunëtori "KOBRA", përmes dërgesës postare, e në emër të punëtorit operativ i cili mban në lidhje, ka dërguar dy pliko në të cilat ka pasur këto materiale propagandistike: dy numra të "Zërit të Kosovës" nr. 1 të janarit 1985, pastaj dy kalendar me mbishkrime "LAVDI TË RËNËVE PËR LIRI; KOSOVA REPUBLIKË", me fotografi të Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe Bajram Bahtirit, tri thirrje për marshin protestues të dt. 26. 01. 1985, i cili është dashur të mbahet në Shtutgart të RFGJ-së, si dhe stemën e "Republikës së Kosovës" punuar nga LRSSHJ.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori deri më tash ka dërguar sasi të konsiderueshme të materialit propagandistik, material ky i cili qarkullon në mesin e anëtarëve të LRSSHJ dhe të disa punëtorëve përkohësisht të zënë me punë në Zvicër. Bashkangjitur raportit ju dërgojmë materialet të cilat janë cek nën pikën III.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet:

2 X SHSSH SKPB

1 X në lëndë të bashk. "KOBRA"

1 X Evidencës

Punëtori operativ

Sejfullah Sahatçiu

"Thirrje për marshin protestues në Shtutgart"

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati-Gjakovë, Sektori II

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu, LRSHJ

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik i cili qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSHJ në Zvicër.

Materiali është dërguar më 23. 01. 1985, ndërsa ka arritur më dt. 29. 01. 1985

Me iniciativën e bashkëpunëtorit,

Shpenzime nuk ka pasur Raporti paraqitet më 30. 01. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori përmes letrës e në adresë të punëtorit operativ që e mban në lidhje, ka dërguar shtatë numra të "Zërit Popullit" Organ i Komitetit qendror të PPSH, të datave 10. 11. 13. 15. 16 dhe 17 janar 1985, si dhe një gazetë të botuar në Zvicër e cila bën fjalë për Jugosllavinë. Njëherit "Kobra" ka dërguar edhe 3 "Thirrje" për pjesëmarrje në marshin protestues i cili është dashur të mbahet më 26 janar 1985, në Shtutgart, RFGJ.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori lidhur me organizimin e marshit protestues ka lajmëruar menjëherë nëpërmjet telefonit për çka jeni njoftuar me depeshen tonë nr. 16 të dt. 21. 01. 1985.

V Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x ShSSH SKPB Punëtori operativ,

1 x në lëndë të bashk. "Kobra" Sejfullah Sahatçiu

1 x Evidencës

Iljaz Kurteshi ka frikë se mos cenohet krahina autonome

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati-Gjakovë, Sektori II

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu, LRSNJ

Më 25. 02. 1985

I

Raport i bashkëpunëtorit.

Burimi: Bashkëpunëtori "KOBRA".

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik nga RPSSH i cili qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSNJ, në Zvicër.

Materiali është dërguar përmes postës më dt. 06. 02. 1985, ndërsa në DSHSSH Gjakovë ka arritur më 21. 02. 1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më 25. 02. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSNJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" përmes dërgesës postare ka dërguar 10 numra të "Zërit të Popullit" Organ i Komitetit Qendror të PPSH, të datave 18, 19, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 29 dhe 30. 01. 1985. Në numrin e dt. 18. 01. 1985 në këtë gazetë është artikulli më titull: "Pritje për bashkatdhetarët me banim në SHBA" përmendet Thanas Laska, i cili në emër të anëtarit të organizatës "Shqipëria e lirë" foli për përshtypjet e tija gjatë vizitës së PPSSH. Në numrin e datës 23. janar 1985, është artikulli më titull "Debate të ashpra midis udhëheqësve të partisë në Kosovë dhe Serbi-Iljaz Kurteshi ka frikë se mos cenohet krahina autonome".

Në këtë dërgesë "Kobra" dërgon edhe një pjesë të një gazete Zvicëran e cila bën fjalë për Tomë Zef Tinën i cili është dënuar me 28 muaj burg për plagosjen me armë, qytetarin tonë Reshat N. , nga Suhareka (bashkëpunëtori nëpërmjet një letre jep përshkrimin e shkurtër për Tomë Zef Tinën, vr. E pun. op.).

- Thanas LASKA, me banim në SHBA, anëtar i organizatës "Shqipëria e lirë" i cili ka vizituar Shqipërinë në vitin 1984.

- Tomë Zef Tinaj, i lindur më 1914 në RPSSH, pas luftës ka jetuar në Jugosllavi dhe me 1953, Toma shkon në Zvicër për shërim ku kërkon dhe merr azilin politik.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dergohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashkëpunëtorit "Kobra"

1 x Punt. Të vijës II-të SHSH

1 x Evidencës,

Punëtori operativ,

Sejfullah Sahatçiu

'Kobra' i zhdur ftesat për protesta

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati-Gjakovë, Sektori II

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu, LRSHJ

Mëe 22. 01. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

- Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

- Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të LRSNJ-së në Zvicër, gjegjësisht me organizimin e marshit protestues i cili do të organizohet në Shtutgart.
- Biseda është zhvilluar më 10.01.1985, nëpërmjet telefonit,
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit.
- Shpenzime operative nuk ka pasur.
- Raporti paraqitet më 22. 01. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSNJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" me vetiniciativë, më dt. 20. 01. 1985, nëpërmjet telefonit lajmëron sa vijon: "Më dt. 26. 01. 1985, në Shtutgart, RFGJ, do të organizohet një marsh protestues të cilin do të organizojë LRSNJ. Për këtë jam njoftuar dhe kam patur në shërbim 20 ftesa që ato t'i shpërndaj dhe t'i njoftoj të tjerët që ky marsh të jetë sa më masiv, mirëpo, shumicën prej këtyre ftesave i kam asgjësuar, ndërsa 2 apo 3 iu kam dërguar juve përmes postës. Në ftesë shihet se vendtubimi do të jetë në Shtutgart në vendin Schlastlatplatz duke filluar në orën 11, 30 min. Prej këtu, pjesëmarrësit në këtë marsh do të vazhdojnë rrugën për në varrezat e vëllezërve Gërvalla. Supozoj se në këtë marsh do të jetë një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori "Kobra" këtë bisedë e ka zhvilluar nëpërmjet automatit telefonik në qytet dhe për këtë arsye nuk ka arritur që më hollësisht të më tregoj se prej kujt i ka marrë thirrjet për marshin protestues i cili do të organizohet në Shtutgart të RFGJ-së.

Sipas fjalëve të tij, e nëse nuk është i zënë me punë më dt. 26. 01. 1985 edhe ky do të shkojë në Shtutgart më qellim që të bëjnë identifikimin e personave dhe të na njoftojë mbi sjelljet e pjesëmarrësve në këtë tubim. Lidhur më këtë jeni njoftuar edhe më depeshen tonë nr. 16 të dt. 21. 01. 1985.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashkëpunëtorit "Kobra"

1 x në evidencë

1 x punt. të vijës së II
Punëtori operativ,
Sejfullah Sahatçiu

"Bashkëpunëtori i sigurt dhe kualitativ, ndërsa shënimet e vërtetuara"

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtorati-Gjakovë, Sektori II
Punt. op. Sejfullah Sahatçiu, LRSHJ
Më 22. 01. 1985

I

Raport i bashkëpunëtorit

- Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"
- Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik i cili qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.
- Materiali është dërguar më 14. 01. 1985, ndërsa në DSHSSH në Gjakovë ka arritur më 22. 01. 1985
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit e sipas marrëveshjes
- Shpenzime nuk ka pasur
- Raporti paraqitet më 22. 01. 1985

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Bernë/Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet dërgesës postare e në emër të punëtorit operativ i cili mban lidhje ka dërguar tre numra të njëjtë të "Zërit të Kosovës" nr. 11-12 dhjetor pastaj 10 numra të "Zërit të Popullit" Organ i Komitetit qendror të PPSH-s të dt. 28, 29, 30 dhjetor 1984, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8 dhe 9 janar 1985. Gjithashtu bashkëpunëtori ka dërguar edhe tre katalogë të botimeve që janë vënë në qarkullim gjatë periudhës, janar-qershor 1984 nga ndërmarrja e përhapjes së librit në Tiranë në gjuhën shqipe dhe atë anglishte si dhe pjesë të gazetës "Nue Zurcher Zeitung" e cila bën fjalë për inflacionin në Jugosllavi".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt dhe kualitativ ndërsa shënimet e vërtetuara pasi që shihet nga materiali i dërguar. Edhe në të ardhmen ashtu sipas marrëveshjes, bashkëpunëtori do të dërgojë gazeta dhe materiale tjera të cilat qarkullohen në mesin e disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër/Bernë.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x në evidencë.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

'Kobra' dërgon ekzemplarë të "Zërit të Popullit"

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati-Gjakovë, Sektori II

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu, LRSHJ

Më 22. 01. 1985

I

Raport i bashkëpunëtorit

- Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"
- Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik i cili qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.
- Materiali është dërguar më dt. 2. 01. 1985 ndërsa në DSHSSH Gjakovë ka arritur më 15. 01. 1985.
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit, e sipas marrëveshjes
- Shpenzime nuk ka pasur
- Raporti paraqitet më dt. 2. 01. 1985

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet korrespondencës dhe dërgesës postare, në emër të punëtorit operativ i cili mban në lidhje, ka dërguar 12 numra të "Zërit të Popullit", Organ i Komitetit qendror të PPSH-së. Me këtë dërgesë postare kanë arritur këta numra të "Zërit të Popullit" 14, 15, 16, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26, dhe 27 dhjetor 1984.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori "Kobra" zakonisht ashtu edhe sipas marrëveshjes dërgon gazetatat e tilla dhe materialet tjera propagandistike të cilat ia jep Rustem Mahmutaj bashkëpunëtorit "Kobra", me qëllim që ky të bëjë shpërndarjen e disa numrave në mesin e punëtorëve tanë të zënë në punë në qytetin Bernë/Zvicër.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x evidencës.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Çdo luftëtar i lirisë të informohet mirë dhe të ruhet nga armiku

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati-Gjakovë

punt. op. Sejfullah Sahatçiu

Më 07. 01. 1985

Raport i Bashkëpunëtorit

I

- Bashkëpunëtori "KOBRA".
- Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër
- Letra e dërguar nga bashkëpunëtori në DSHSSH - Gjakovë, ka arritur më 5. 01. 1985
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit, e sipas marrëveshjes.
- Shpenzime nuk ka pasur.
- Më 7. 01. 1985

II

Bashkëpunëtori "KOBRA" përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "KOBRA" nëpërmjet korrespondencës dërgon raportin e vet, ku ndër të tjera shkruan; "para disa ditësh isha në Gjenevë dhe rastësisht janë me Kadri Avdullahun nga Gjilani dhe Sadri Mulajn nga

fshati Kuliqan KK Pejë. Pas pak që të tretë kemi hyrë në një restorant, dhe në ndërkohë Kadriu filloi këtë bisedë; "Duke e vlerësuar situatën në Kosovë e cila është e ndërlikuar, në si pjesëtarë të LRJSH-s të cilët jemi përfaqësues të popullit, duhet të mobilizohemi me të gjitha forcat dhe të tregohem në nivel të duhur, me qëllim që armikun ta godasim në kokë. Është detyrë e jona, e çdo shqiptari e çdo ithtari, kurbetqari, çdo patrioti, çdo intelektual e çdo punëtori që sa më tepër të shpërndajnë "Zërin e Kosovës" aty në Kosovë. Është detyrë që me çdo mjet të rrisim rezistencën popullore ashtu që çdo luftëtar i lirisë të informohet mirë dhe të ruhet nga armiku. Duhet të lidhemi ngushtë në shokët, që populli në Kosovë të furnizohet sa më mirë me literaturë në gjuhën shqipe duke filluar prej qytetit në qytet e gjithashtu të përfshihen të gjitha fshatrat të banuara me shqiptarë. Për një aktivitet të tillë që punëtori, fshatari, studenti, intelektual, nëpunësi, patriotët e rinj, pleqtë, fëmijët dhe gratë t'i kundërvihen regjimit serbomadh të Beogradit, kështu që populli ynë heroik t'i kundërvihet në mënyrë të ndonjë çetniku të Beogradit. Duhet t'i forcojmë radhët tona e sidomos konspiracionin, e në këtë mënyrë t'i luftojmë gabimet tona e kështu çdo punëtor i celulës të jetë i përgatitur. E dini mirë thënien e shokut Enver në gazetën e gushtit në. 5 1983 të cilën e botoi "Zëri i Kosovës" ku thotë se parullat "Shqipëri e vogël apo Shqipëri e madhe, në çdo kohë nga kushdo që janë përdorur kanë qenë parulla antishqiptare dhe në kundërshtim me të vërtetën objektive - historike. As, s'e ka pasur as s'mund të flitet për Shqipëri të madhe apo të vogël por ka pasur e ka vetëm një Shqipëri, e cila pavarësisht manipulimi e reaksionit të të gjitha kohëve, por pavarësisht nëse është prerë, copëtuar, goditur, prapëseprapë mbetet si një komb, si një vend i banuar nga njerëzit e të njëjtit gjak, të së njëjtës gjuhë, të së njëjtës kulturë, të së njëjtës histori të të njëjtit formim psikik e kombëtar, në tërësi shqiptarët. "Pra si detyrë e jona mbetet që popullin e Kosovës ta drejtojmë dhe ta nxisim në luftë revolucionare apo në demonstrata të serishme. Mbetet detyrë e jona që në të ardhmen të angazhohemi që nëpër shumë uzina dhe kombinat shpërndahen traktate me përmbajtje propagandistike, të organizohen grupe brenda dhe jashtë fabrikave, me qëllim që të zgjidhet çështja e Kosovës. Duhet të jemi aktivë dhe në organizimin e demonstratave në planin e jashtëm duke e organizuar demonstrata e këtë me qëllim që të njoftohet opinioni botëror dhe OKB se shqiptarëve iu takon "Republika". Sadri Mulaj është pjesëmarrës i disa demonstratave antijugosllave të organizuara në Zvicër/Bernë. Është adhures i flaktë i Enver Hoxhës dhe se prej vitit 1981 e gjer më tani nga frika që merret me veprimtari armiqësore, nuk ka qenë në vizitë familjare se në fshatin Kuliqan".

Kadri Avdullahu, nga Gjilani, tani banon në Gjenevë në adresën; Frontex 51 Maçon – Gjenevë. Për të njëjtin kemi shkruar edhe më parë. Sadri Mulaj, nga fsh. Kuliqan, KK Pejë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet deri diku të vërtetuara dhe nga burimet tjera. Me nga një kopje të këtij raporti është njoftuar DSHSS Pejë e Gjilan dhe se gjatë vërtetimit dhe bisedave të ndryshme në këtë drejtim duhet pasur kujdes të posaçëm e mos të vihet deri të dekonspirimi i bashkëpunëtorit tepër kualitativ.

V

Vërejtjet, Çmimet dhe vendimet e eprorit;

Dërgohet :

2 x SHSSH SKPB

1 x DSHSSH - Gjilan

1 x DSHSSH -Pejë

1 x Në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës.

Punëtori operativ,

Sejfullah Sahatçiu

Identifikimi i Brahim Elezajt

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtorati-Gjakovë, Sektori II

punt. op. Sejfullah Sahatçiu, LRSHJ

Më 07. 01. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër. Biseda është zhvilluar më 27. 12. 1984, në një lokal hotelier jashtë territorit të KK Gjakovës prej orës 10-14.

Më iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime 910 dinarë

Raporti paraqitet më 5. 01. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori së pari ka bërë identifikimin edhe të një personi pjesëmarrës në demonstratat antijugosllave të organizuara në Zvicër/Cyrih. Bëhet fjalë për fotografinë të cilën "Kobra" e ka dërguar e të cilën fotografi pas riprodhimit iu kemi dërguar së bashku me raportin tonë nr. 724, të datës 13. 11. 1984. në anën e majtë të Rustem Mahmutajve, me dy grushte lart në fotografi shihet Brahm Elezaj, nga fshati Jabllanicë e Vogël, KK Pejë, pjesëmarrës aktiv në disa demonstrata të organizuara në Zvicër dhe lidhje e ngushtë e Rustem Mahmutajve nga fshati Lybeniq, KK Pejë, tani me vendbanim në Bernë. "Kobra" në vazhdim përveç tjerash tha: "Edhe më datën 1. 12. 1984, në Luzan është mbajtur një manifestim për nder të 28 Nëntorit, ditës së pavarësisë së Shqipërisë, në këtë manifestim kanë marrë pjesë afër 600-700 veta. Përveç të tjerave, kanë parë Rustem Mahmutajn, vëllezërit Hajdar e Adem Sadriun nga Fshati Ponošec KK Gjakovë, Faik Cakën nga fshati Doganaj KK Kaçanik, Shaqa N. nga Ferizaj etj. Sikurse në çdo tubim të cilin e organizojnë anëtarët e LRSJ-së, ashtu edhe në këtë, janë brohoritë parulla të ndryshme si "Kosova Republikë" etj. Janë kënduar këngë të ndryshme kushtuar RPSSH dhe PPSH, këtu, pas mbarimit të kësaj ceremonie, Hajdar Sadria ka shitur shumë shirita të kasetofonit me çmim 8 franka me këngë dhe valle popullore të ansambleve të RPSSH-së. Tani, Hajdari kryesisht merret gati me shitjen e këtyre kasetave pasi ka edhe një lloj të profitit, por si duket fitimin e tillë e shpenzon për nevoja të LRSJ-së. Përveç Hajdarit me punë të tilla merret edhe vëllai u tij Ademi, por ky duke mos shitë, por duke i shpërndarë. Në një bisedë që kisha me Hajdar Sadriun përveç tjerash më tha: "Edhe sikur Kosova të fitojë statusin e Republikës, unë nuk do të kem vend dhe s'guxoj të shkoj atje, por deri atëherë kur Kosova përfundimisht t'i bashkëngjitet Shqipërisë atëherë kisha me u kthye në Jugosllavi". Në këtë përgjigje të Ademit iu kam drejtuar duke i thënë se ti tani nuk qenke për "Kosovën Republikë", në çka ai prapë m'u përgjigj "Po edhe nëse behet ajo, prapë do të ngelë nën Jugosllavinë e për mua prapë s'do të kenë vend". Në një bisedë me Hajdar Sadrijun, ai më njoftoi se afati i pasaportës tani i ka kaluar dhe se pasaportën e njëjtë nëpërmjet postës e ka dërguar në Ambasadën tonë, duke pasur frikë se po të shkojë në Ambasadë, atë do ta vrasin apo do ta burgosin e ta sjellin në Jugosllavi.

Pasaporta e fotokopjuar e Rustem Mahmutajt

Meqë Rustem Mahmutaj ka besim të madh në mua dhe asgjë nuk fsheh nga unë, para disa ditësh ma dha pasaportën e vet që t'ia ruaja për disa ditë, e unë pas pak të njëjtën e kam fotokopjuar e që më vonë do t'ju vije nëpërmjet postës. Në disa raste kam shkuar në banesën e tij. Kjo banesë shërben edhe si klub i LRSJ-së. Këtu shpeshherë takohen Shaqa N. nga Ferizaj, Hajdar Sadrija së bashku me vëllain Ademin e disa të tjerë dhe

bisedojnë për shumë çështje. Rustemi është i martuar me një shtetase ruse të cilës aspak nuk i pengojnë "punët" e Rustemit. Në banesën e këtij, në mur janë parullat "Rroftë Shqipëria dhe Enver Hoxha", "Rrnoftë RPSSH" si dhe në një qilim të varur në mur është e punuar me dorë "Kosova Republikë". Në adresën dhe emër të Rustemit i vijnë paketa me libra, gazeta dhe materiale tjera propagandistike. Kështu ai vazhdimisht më furnizon me "Zërin e Popullit", "Zëri i Kosovës", "Ylli", "Shqipëria e Re" etj. Vazhdimisht me qëllim që edhe unë të shpërndaj, m'i sjellë nga 20 copë "Zëra të Popullit", mirëpo unë ato i asgjësoj ndërsa sikurse deri më tani nga një numër ju përcjell juve. Në një rast Rustemit iu kamë vënë në shërbim duke i thënë se jam i gatshëm që të fus në Jugosllavi material propagandistik, por më parë duhet të dijë se kujt kisha me ia dorëzuar. Në këtë, Rustemi m'u përgjigj: "Së pari është mirë që të sigurosh një lidhje të fortë me Universitetin e Kosovës në Prishtinë e pastaj kishte me qenë lehtë dhe e parrezikshme qarkullimi. Kështu është praktik edhe me të tjerët të cilët fusim materialin propagandistik. Ata Brenda afatit p.sh dy apo tri orësh, materiali lexohet dhe po aq ekzemplarë të shpërndarë duhet grumbulluar prapë te shpërndarësi me qëllim që mos të bie ndonjë në dorë të UDB-së, dhe i njëjti pastaj asgjësohet".

UDB vendos bombë në librari

Më ka ra të dëgjoj e për këtë ka shkruar edhe gazeta zvicerane "Blick", se në Biell para disa ditësh, në librarinë e Beatit i cili kryekëput shet libra me prejardhje nga Shqipëria, ka qenë e montuar një bombë me mekanizëm, me qëllim që të çohet në ajër kjo librari. Sipas bisedave të anëtarëve të "Lëvizjes" dhe sipas deklaratës së Beatit, gjoja se kjo bombë ka qenë e vënë nga ana e UDB-së, dhe se gjëja ai e njeh personin i cili e ka montuar, por ende nuk ka mund ta shohë, identifikoi dhe paraqesë policisë zvicerane. Lidhje e ngushtë e Beatit është kushëri i Nuhi Berishës, ish-student në Prishtinë, person me rëndësi në "Lëvizje" i cili së bashku me Beatin kanë hapur një librari në Bernë, e cila kryekëput shet materiale me origjinë nga RPS e Shqipërisë.

Xhafer Shatri e Hasan Mala më aktivët

Sipas mendimit tim e një mendim i tillë është edhe tek punëtorët tjerë të punësuar në Zvicër se më aktivistët në "Lëvizje" janë Xhafer Shatri me pseudonimin "Shpati" pastaj Shaqa N. me pseudonim "Lulëkuqja", Hasan Mala i njohur si "Mixha" etj. Është bindje e ime që është e vërtetë se në "Zërin e Kosovës" paraqiten shumë pseudonime, mirëpo ato janë vetëm mashtrime të disave se gjëja kjo "Revistë" ka shumë bashkëpunëtor dhe se është e aftë të dijë gjithçka për vendin tonë.

Me Avdi Lekun, nga Gjakova i cili tani gjendet në Zvicër edhe pse më parë kemi qenë në marrëdhënie tepër të mira, ka kohë me atë nuk jam takuar. Avdiu në Zvicër tani asgjë nuk paraqet pasi shumica e pjesëtarëve të "Lëvizjes" në tërësi kanë humbur besimin ndaj tij, duke e çmuar të njëjtin si agjent të Jugosllavisë e sidomos pas ardhjes së babait të tij Isaut në Zvicër dhe qëndrimin të tij afër 6 muaj. Sikurse për Isaun ashtu edhe për Avdiun thuhet se janë ardhur me detyrë sublime. Askush nga Avdiu nuk merr material propagandistik poqë se edhe ai i ofron, duke u frikuar nga ai se së shpejti do t'i paraqet njerëzit në Jugosllavi. Në kohën e fundit ai nuk ka marrë pjesë në asnjë tubim, përveç se kur ishte ansambli i RPSSH në Zvicër, më parë i kishte blerë e që më vonë këto i kishte shitë.

e) Brahim Elezaj, nga fshati Jablanicë e Vogël, KK Pejë, i identifikuar si pjesëmarrës në demonstratat e Cyrihut sipas fotografisë së dërguar nga ana e "Kobrës"

- Rrustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq, KK Pejë i njohur për veprimtarinë e tij armiqësore kundër RSFJ,
- Hajdar Sadrija (LPO) nga fshati Ponošec KK Gjakovë,
- Adem Sadrija (LPO) nga fshati Ponošec KK Gjakovë,
- Faik Cakaj, nga fshati Doganaj KK Kaçanik,
- Shaqa N. nga Ferizaji,
- Xhafer Shatrii njohur nga shërbimi
- Shaqa N. nga Avdi Leku (LPO) nga Gjakova, i njohur nga shërbimi për veprimtarinë armiqësore ndaj RSFJ-së.

IV Vërejtjet e punëtorit operativ:

Shumica e shënimeve të prezantuara, përputhen edhe nga burimet tjera bashkëpunëtori në raportin nr. 803 të dt. 20. 12. 1984, nuk ka përmendë vendin se ku është mbajtur manifestimi i ditës së flamurit kombëtar, në çka tani thotë se ky manifestim është mbajtur në Albright afër Cyrihut. Me bashkëpunëtorin prapë do të vazhdoen bisedat.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit :

Dërgohet:

- 2 X SHSSH SKPB Punëtori operativ
- 1 X evidencës
- 1 X në lëndë të bashkëpunëtorit "Kobra"
- 2 X nga një insert për lëndët në PO
- 1 X DSSH, Pejë

'Kobra' raporton për deklarimet rreth Xhafer Shatrit

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtori-Gjakovë
Punt. op. Sejfullah Sahatçiu
Më 6. 04. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

- Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".
- Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë e LRSHJ-së, në Zvicër dhe Suedi.
- Raporti është dërguar më 26. 03. 1985, ndërsa në adresë të punëtorit operativ ka arritur më 04. 04. 1985.
- Me iniciativën e bashkëpunëtorit e sipas marrëveshjes.
- Shpenzime nuk ka pasur .
- Më 06. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell dhe është i orientuar që të përcjellë veprimtarinë e LRSSHJ-së.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" në raportin e vet përveç tjerash shkruan: "Më datën 22. 03. 1985, nga Idriz Halili i cili është nga një fshat afër Tetovës RS Maqedonisë, kam marrë "Zërin e Kosovës", i cili redaksinë e vet e ka në Suedi. Me marrjen e kësaj gazete, Idrizi më tha: 'Unë nuk shpërndaj "Zërin e Kosovës" i cili botohet në Gjenevë, sepse në këtë gazetë rolin kryesor e ka Xhafer Shatri e që çmohet ndër tradhtarët më të mëdhenj të popullit shqiptar. Xhaferi para se të vijë në Zvicër, ka qenë në burg me disa shokë dhe me vëllain tim. Më kanë njoftuar se duhet pasur kujdes dhe të ruhemi, pasi që Xhaferi është përgatitur dhe me detyrë të UDB-së punon në Zvicër. Përveç që me kanë lajmëruar për këtë rast, duhet marrë me mend se si athua Xhaferi iku nga burgu. Si tradhtar është dëshmuar kur më veprën e tij i humbi dy djelmoshat më të njohur të LRSHSJ-së Rexhep Malën e Nuhi Berishën. Sikurse Rexhepi ashtu edhe Nuhiu kanë pasur mundësi të ikin nga Jugosllavia dhe kështu së bashku kane arritur deri në Lubjanë dhe afër kufirit, mirëpo me urdhrin e Xhaferit ata janë kthyer prapë në Kosovë. Një urdhër i tillë i Xhaferit për t'u kthyer në Kosovë nuk ka qenë që ata të japin kontributin më të madh në vend, por qëllimi kryesor ka qenë që Rexhepi dhe Nuhiu t'ia paraqesë UDB-s, pasi

mirë e ka ditë se në çfarë vendi gjenden ata të strehuar. Gazeta "Zëri i Kosovës" e cila botohet në Gjenevë asgjë nuk ka të vërtetë. Shkrimet në këtë janë të pasakta dhe të marra dhe të kopjuara nga materialet e Shqipërisë. Unë lexoj dhe shpërndaj "Zërin e Kosovës" i cili botohet në Suedi pasi ky në shkrimet e veta i paraqet gjërat reale dhe nuk ka kurrfarë qëllimi tjetër përveç që Kosovës t'i jepet statusi i Republikës në Federatën Jugosllave. Parulla "Kosova Republikë" nuk është parullë antijugosllave, sepse një gjë të tillë e ka cekë edhe kryesia e Kosovës. "Zëri i Kosovës" që unë e shpërndaj në Bernë, kam arritur që shumë persona t'i parapaguaj apo si të tillë të bëhen abonentë. Gazetat e tilla më vijnë nga Suedia e të cilat mi dërgon Hysen Gërvalla.

Hyseni për kohën sa kishte qenë në Jugosllavi kishte kontribuar shumë sidomos në shpërndarjen e "Zërit të Kosovës", mirëpo vonë pasi është diktuar nga UDB-ja i njëjti është arratisë për Itali, pastaj ka ardhur në Zvicër e prej këtu nëpërmjet klubit të St. Galenit ka shkuar në Suedi. Tani Hyseni është duke dhënë kontribut të madh në redaksinë e "Zërit të Kosovës" në Suedi".

Sipas fjalëve të Idrizit, gjoja se vetë ka qenë pjesëmarrës në demonstratat e Tetovës, pastaj se gjoja se vëllai i tij tani gjendet në burg, dhe se vetë Idrizi gjoja se ka kërkuar azil politik.

Nga biseda me Rustem Mahmutajt jam njoftuar se këto ditë ka qenë në polici gjoja me motivacionin se e ka humbur pasaportën Jugosllave. Nga policia kishte marrë përgjigje se për humbjen e pasaportës, duhet të paraqitet në ambasadën e RSFJ-së, mirëpo me të vërtetë Rustemit tani i ka kaluar afati e jo që e ka humbur pasaportën.

- Idriz Halili, nga një fshat afër Tetovës, tani jeton në Bernë.
- Xhafer Shatri, ish i dënuar politik, tani në Zvicër, i njohur i shërbimit.
- Hysen Gërvalla; vëllai i Isuf dhe Bardhosh Gërvallës, tani jeton në Suedi,
- Rustem Mahmutaj, nga fshati Lybeniç, KK Deçan, për të kemi shkruar edhe më parë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet e pavërtetuara e sidomos kur është fjala për redaksinë e "Zërit të Kosovës". Është interesant se për herë të parë përmenden redaksitë e mundshme të këtyre gazetave gjë që mbetet si detyrë parësore thellimi i këtyre njohurive në çka do t'i jepen detyra të reja bashkëpunëtorit në këtë drejtim. Gjatë përdorimit të këtyre shënimeve, duhet pas parasysh që eventualisht mos të vijë në dyshim bashkëpunëtori kualitativ "Kobra".

Me një insert të këtij raporti është njoftuar DSHSSH-Pejë

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x DSHSSH-Pejë

1 x në lëndë të burimit-bash. "Kobra"

1 x Evidencës.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

MST: Raport për artikullin e prof. Bujar Hoxhës

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu

Më 2. 04. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

-Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

-Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë propagandistike armiqësore të LRSHJ në Zvicër.

-Materialet janë dërguar më dt. 10. 03. 1985. , ndërsa në DSHSSH-Gjakovë

Kanë arritur më 27. 03. 1985.

-Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

-Shpenzime nuk ka pasur .

-Raporti paraqitet më 02. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra", nëpërmjet dërgesës postare e në emër të punëtorit

operativ që e mban në lidhje, ka dërguar 5 numra të gazetës "Zëri i Popullit"

organ i komitetit qendror të PPSH, të datave 8. 9. 10. 12 dhe 13mars 1985.

Në numrin e dt. 9 mars 1985, është artikulli "Demaskimi i akuzave të rreme të Revizionistëve Jugosllavë kundër partisë sonë për sektarizëm", anëtar i së cilës artikull është Bujar Hoxha. Përveç gazetave në fjalë, bashkëpunëtori

ka dërguar një fletë nga "Zëri i Kosovës" me fotografi nga marshi protestues i datës 26 janar 1985 i mbajtur në Shtutgart/RFGJ, pastaj dy artikuj të shkëputur nga gazeta "Shqipëri e Re" në të cilën bën fjalë për RSFJ".

Bujar Hoxha, profesor në RPSSH.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Së bashku me raportin ju sjellim edhe materialet e caktuara më lart.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit.

Dërgohet: Punëtori operativ,

Sejfullah Sahatçiu

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra".

1 x në Evidencë.

Fjalimi i studentit nga Prishtina. . .

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu

Më 1. 04. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

-Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

-Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë e LRSSHJ-së në Zvicër.

-Bashkëpunëtori raportin e vet me shkrim e ka dërguar më datë 29. 03. 1985.

-Në iniciativën e bashkëpunëtorit.

-Shpenzime nuk ka pasur.

-Më 1. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarin e LRSSHJ në Zvicër

III

Bashkëpunëtori "Kobra" shkruan: "Më dt. 03. 03. 1985 isha në klubin "Ganimete Tërbeshi" në Martigny në Lozanë. Këtu u organizuam që me punëtorët të punësuar nëpër disa qendra të ndryshme të Zvicrës, të takohemi në këtë klub që të kalojmë disa momente. Me këtë rast një student nga Prishtina, pjesëtar i LRSHJ, në fjalimin e tij përveç tjerash tha: "Bota po e përkrah kërkesën tonë "Kosova Republikë" që nga marsi i vitit 1981. Prej atëherë e deri më tani, shtypi dhe radiotelevizionet e mbarë botës vazhdojnë të shkruajnë dhe të flasin pa ndërprerë për ngjarjet në Kosovë, rreth gjendjes së mjerueshme të dy milionë shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Kosovë. Papunësia ka arritur në mbi 100. 000 veta. Grabitja e pasurisë së begatshme nga Kosova, presionet, torturat, burgosjet e deri tek masakrat që u bëhen nga UDB-ja famëkeqe jugosllave, duke filluar nga nxënësit e shkollave të mesme, studentëve, fshatarëve, punëtorëve e deri tek profesorët e Universitetit, janë tema që mund t'i shohim për çdo ditë në faqet e ndryshme të shtypit botëror apo t'i dëgjosh nga agjencitë e huaja telegrafike. Këto të dhëna janë të njohura në opinionin vendës e atë botëror apo t'i dëgjosh nga agjencitë e huaja telegrafike. Këto të dhëna janë të njohura në opinionin vendës e atë botëror. Qëllimi ynë është që t'i cekim ca fakte që vërtetojnë një realitet të pamohueshëm të kërkesës për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në kuadër të federatës e përkrahur në disa mënyra: në mënyrë direkte, indirekte dhe në mënyrë të heshtur. Numri i atyre që e përkrahën kërkesën e shqiptarëve në Jugosllavi në mënyrë direkte, nuk qe i vogël. Ata e thanë këtë botërisht nëpërmjet radiotelevizioneve e agjencive të veta telegrafike e deri edhe para forumeve botërore siç janë OKB dhe Organizatës për të drejtat e njeriut. Përfaqësuesi i Vlladimir Dejijeri iu deshtë në mënyrë të turpshme të flasë për të drejtat e njeriut, përderisa në atdheun e tij për një parullë siç është "Kosova Republikë" shqiptohen dënimet më shumë se 15 vjet burgim. Përfaqësuesit shtetëror që e përkrahën kërkesën tonë në mënyrë indirekte, për shkaqe të ndryshme nuk folën, mirëpo shtypi dhe mjetet tjera të informimit të atyre vendeve, kurrë nuk pushuan së foluri e së shkruari objektivisht rreth këtyre ngjarjeve.

Nga një numër shtetesh, kërkesa jonë u përkrah në heshtje, nga këto nuk u dëgjua fjalë në të cilat përkrahet kërkesa jonë, mirëpo nuk u dëgjuan fjalë as për të kundërtën, sepse është jashtë logjikës të deklarohesh ndaj një kërkesë të tillë.

Kjo e vërtetë u vërtetua edhe nga vetë jugosllavët në mënyrë direkte apo indirekte.

Në mënyrë direkte u vërtetua se deri më sot, pa marrë parasysh zhurmën shurdhuese që e bëri e që vazhdoi akoma të bëjë shtypi i shfrenuar dha radiotelevizioni, nuk arriti të citojë çfarëdo lajmi që e do në favor të tyre, por iu deshtë të kritikojë shtypin botëror gjoja për të pavërtetat e ngjarjeve në Kosovë".

Nga fjalimi i Agim Gashit nga Lipjani

Pas pak kohe foli edhe Agim Gashi, nga Lipjani. Agimi është aktivist i "Lëvizjes" dhe njihet si këngëtar i mirë. Ndër tjera Agimi tha: Në histori e kemi lexuar se Partia Komuniste e Shqipërisë mbante një qëndrim konsekuent internacionalist.

Nuk i lejonte vetës asnjë shfaqje sado të vogël shovinistë. Ndihmonte me të gjitha forcat zhvillimin e luftës antifashiste në Kosovë dhe në rrafshin e Dukagjinit.

Luftonte për vëllazërimin mbi baza marksiste-leniniste të popullit Shqiptar me popujt e Jugosllavisë.

Lidhur me problemin e Kosovës dhe të krahinave tjera të banuara me shqiptarë në Jugosllavi, PKSH nuk e kishte pranuar asnjëherë parullën fashiste "Shqipëria e madhe", PKSH e shikonte zgjidhjen e drejtë të këtij problemi me fitoren e revolucionit si në Shqipëri ashtu edhe në Jugosllavi. PPSH kishte shpallur botërisht se populli Kosovar me fitoren e revolucionit, në të dy vendet, do të fitojnë të drejtën e vendosjes së fatit të vet".

Agim Gashi, nga Lipjani.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet e pavërtetuara. "Kobrës" do t'i jepet për detyrë që të identifikoi studentin nga Prishtina.

Me një kopje të këtij raporti është njoftuar DSHSSH-Prishtinë.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 X SHSSH SKPB

1 X DSHSSH Prishtinë

1 X në lëndë në bank. "Kobra"

1 X Evidencës

Punëtori operativ,

Sejfullah Sahatçiu

T: 'Durmishat' shpërndanë trakte dhe organizuan vizitë në varrezat e heronjve

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt. op. Sejfullah Sahatçiu
Më 29.03.1985

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori 'Kobra'.

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të LRSHJ-së në Zvicër. Bashkëpunëtori ka dërguar raportin me shkrim më 18.03.1985, ndërsa në adresë të punëtorit operativ ka arritur më 28.03.1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më 29.03.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e disa anëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori në raportin e vet të dërguar me shkrim thotë: "Në klubin 'Shotë Galica' në Lozanë, në një bisedë me Shaqë N. nga Ferizaj apo Gjilani përmendi se është aktivist i njohur i 'Lëvizjes' dhe se brenda katër viteve të fundit ka dhënë kontribut të madh LRSSHJ-së. Shaqa është në moshë afër 48 vjeçar. Ky së bashku me Rustem Mahmutajn i cili mbante flamurin në dorë dhe Salih Basha i cili iu ka paraprirë, kanë marrë pjesë në marshin protestues i cili është organizuar më 26 janar 1986 në Shtutgart-RFGJ. Në këtë marsh kanë marrë pjesë afër 800 veta nga vendet e ndryshme si nga Belgjika, Zvicra, Franca, Austria dhe SHBA. Në mesin e të tjerëve në këtë marsh protestues ishin edhe Salih Basha, Mehmet Rashiti nga Gjilani, përndryshe anëtar i klubit 'Shotë Galica' në Lozanë dhe korrespondent i 'Zërit të Kosovës'.

Mehmeti është shok i mire dhe ilaka me Selver Salihun nga Gjilani, i cili kishte qenë më parë studentë në Kosovë, e tani është sekretar i klubit 'Shote Galica' në Lozanë, ku edhe jeton. Selver në Jugosllavi ishte i dënuar për çështje politike, dhe se me ardhjen e tij në Zvicër luan një rol të madh e sidomos në klubin 'Shotë Galica' në Lozanë i cili ishte abonenti gazetës 'Zër i Popullit' dhe të njëjtat gazeta i sjell në lokalet e këtij klubi. Në këtë marsh protestues ishte edhe Zahir Zahiri, kushëriri i Zija Shemsiut, nga fshati Përlepnicë, KK Gjilan, i cili njihet dhe shoqërohet me Hasan Malën - "Mixhën". Zahiri ka qenë në koncertin e Ansambilit të Shqipërisë në Bernë së bashku me bashkëshorten e vet e cila ishte e veshur me të kuqe dhe si pjesëtarë të këtij ansambli, bashkëshortja e Zahirit në disa raste, pas mbarimit të këngëve iu ka dhuruar lule. Gjithashtu kjo ka qenë pjesëmarrëse në demonstratat antijugosllave të

organizuara në Bernë, e veshur me rrobat sikurse në kuvertë, por me këtë rast në qafë mbante një shami të kuqe.

Më dt. 24. 11. 1984, në një sallë të madhe ku ishim tubuar për të kremtuar ditën e flamurit kombëtar, bashkëshortja e Zahirit ka hapë programin duke lexuar një material të përgatitur për këtë ceremoni, e që ky kishte përmbajtje armiqësore, e gjatë leximit ka mbajt grushtin lartë e që në atë moment publiku prezent ka filluar brohoritjet "Parti Enver, jemi gati kurdoherë", "Kosova Republikë" etj.

Fjala hyrëse e kësaj femre, e cila ka qenë bukur e gjatë, është botuar në "Zërin e Kosovës" nr. 10 Nëntor 1984 në faqen 1, 3 dhe 10. ky tubim është mbajtur në një vend afër Cyrihut i quajtur Albiesguetli dhe së bashku me Zahirin dhe bashkëshorten, prezent ishte edhe vajza e tyre 7-8 vjeçare, pastaj Shaqa N. Hajdar Sadrija nga rrethi i Gjakovës, Hasan Mala dhe Rrustem Mahmutaj. Të gjithë këta kishin siguruar një tavolinë dhe së bashku ishin ulur.

Kush janë "durmishat"?

Në bisedë me Kadri Avdullahun më tha se "më dt. 19.01.1983, në Shtutgart "Durmishat" kuptohet tradhtarët e vendit, së bashku me disa pisa tjerë organizuan dhe shpërndanë disa trakte dhe vizituan varrezat e heronjve tanë të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, pastaj shpërndanë "Zërin e Kosovës" të falsifikuar. Këtë grup po e udhëheq Sadik Blakaj nga Ferizaj, Sabri Novosella, Xhafer Skënderaj-Durmishi, Milaim Zekaj nga Gjilani, dhe Haxhi Berisha nga Deçani. Milaim Zeka nga Gjilani, ky tradhtar është paraqit se është patriot revolucionar shqiptar, përkundrazi, duhet ta dini të gjithë se ai është tradhtar së bashku me të tjerët pasi ata po i paguan UDB-ja Jugosllave, vetëm e vetëm që ta pengojnë punën dhe veprimtarinë e lëvizjes.

Për Milaimin është kuptuar edhe më herët, kur ishte Ansambli i Shqipërisë ne Shtutgart, gjoja ky si atdhetar ansamblit në fjalë iu ka dhuruar lule në shenjë respekti duke menduar se të tjerët nuk i dinë punët dhe marifetllëqet e tij.

Gjithashtu, tradhtar është edhe Haxhi Berisha nga Deçani, i cili di diçka rreth vrasjes së heronjve tanë në Untergruppenbach afër Shtutgartit".

- SHAQA N. NGA Ferizaj apo Gjilani,
- RRUSTEM MAHMUTAJ, NGA FSH. Lybeniq, KK Pejë,
- Salih Basha
- Mehmet Reshiti nga Gjilani,
- Selver Salihu, nga Gjilani,
- Zahir Zahiri, nga fsh. Pelepnice, KK Gjilan,
- Hasan Mala, nga Gjilani,
- Bashkëshortja e Zahirit, nga Përlepnica, KK Gjilan,
- Kadri Avdullahu,

- Sadik Blakaj, nga Ferizaj,
- Sabri Novosella, nga Prishtina,
- Xhafer Durmishi,
- Milaim Zekaj, nga Gjilani,
- Haxhi Berisha, nga Deçani,

Detyra e 'Kobrës' të takohet me Kadri Avdullahun

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet pjesërisht të vërtetuara edhe nga burimet tjera. Ekziston mundësia që 'Kobra' gjatë përpilimit të raportit me shkrim nuk i ka përshkruar gjerësisht gjerat, gjë që mbetet që në kontaktin që do të behët në vend apo nëpërmjet formave tjera, rastet dhe personat do të jenë më të konkretizuar. 'Kobrës' i është dhënë për detyrë që të kontaktojë me Kadri Avdullahun dhe të njoftohet me për së afërmi me veprimtarinë e tij armiqësore.

Me nga një ekzemplar të këtij raporti është njoftuar DSHSSH-Gjilan, Ferizaj dhe Pejë.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x DSHSSH-Gjilan

1 x DSHSSH-Ferizaj

1 x DSHSSH-Pejë

1 x Në lëndë të "Kobrës"

1 x Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Kobra vazhdon të dërgojë materiale të shumta në UDB

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt. op. Sejfullah Sahatçiu

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi; Bashkëpunëtori 'KOBRA'

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik nga RPSSH

i cili qarkullon në mesin e disa anëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më 22. 03. 1985

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori 'KOBRA' përmes dërguatës postare e në emër të punëtorit operativ i cili e mban në lidhje ka dërguar 12 copë gazeta "Zëri i Popullit" Organ i komunitetit qendror të PPSH të datave 22, 23, 24, 26, 27, 28 shkurt dhe 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 mars 1985. Në numrin e datës 23 shkurt 1985 është titulli "Dënime të tjera kundër shqiptarëve në Kosovë-në Pejë 9 veta dënohen gjer në 11 vjet", ndërsa në numrin e datës 27 shkurt 1985, është artikulli "udhëheqësit jugosllavë ndjekin një politikë konstante antishqiptare". Në këtë numër të gazetës përveç se bëhet fjalë edhe për Mehmet Shehun kundër tjera shkruhet: "... Në udhëheqjen shqiptare mund të futej dikur edhe Mehmet Shehu, agjent i fshehur i amerikanëve sovjetikë e jugosllavë. Por ai nuk mundi as të deformohet as të ndryshonte vijën marksiste-leniniste të partisë. Ai u likuidua pse ndeshi në unitetin e pathyeshëm të partisë në popullin ..."

Së bashku më këto gazeta 'Kobra' ka dërguar dhe librin "Lidhja Shqiptare e Pejës – Lëvizja kombëtare 1896-1900", nga autori.

Kristaq Prifti, e botuar në Tiranë më 1984.

IV

Vërejtjet operativ:

Bashkëpunëtori me iniciativë e vet dërgon material të ngjashëm, bashkangjitur këtij raporti ju dërgojmë edhe gazetar dhe librin në fjalë.

V

Vërejtjet, çmimoret dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKBP

1 x evidencës

1 x në lëndën të bashkëpunëtorit 'Kobra'

Identifikimi i veprimtarisë së Njazi Mehmetit

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt. op. Sejfullah Sahatçiu

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë lidhur me LRSSHJ, në Zvicër

Materiali është dërguar me dt. 26. 02. 1985, ndërsa në DSHSSH ka arritur më 7. 03. 1985,

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më 8.03.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ-së, në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori 'Kobra' nëpërmjet korrespondencës ka dërguar tri pjesë të gazetave të cilat bëjnë fjalë për demonstratat antijugosllave të organizuara në Perëndim. Në njërin prej këtyre artikujve me titull "Albanische Minderheit Jugoslaëien demonstriert in Bon" shihet Rustem Mahmutaj i cili me veshje kombëtare në ballë të kolonës së demonstratave mban flamurin shqiptar. Në këtë, shihen demonstratat e organizuara nr. 6. 04. 1982, në Bon të RFGJ.

Rustem Mahmutaj, nga fshati Lybeniq, KK Pejë, tani i punësuar në Zvicër në qytetin Bernë, për të edhe më parë është shkruar.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori edhe më parë ka dhënë shënime për Rustem Mahmutajn, shënime këto të cilat janë treguar të vërteta. Meqë artikujt janë në gjuhën gjermane, për përmbajtjen e tyre nuk jemi të njohur përveç se shihen Rustemi si pjesëmarrës në këto demonstrata. Nëse e doni fotografinë dhe një kopje të këtij raporti, ia dërgoni DSHSSH Pejë. Njihet për veprimtari armiqësore kundër sistemit të RSFJ-së. Kjo mbledhje përkujtimore është mbajtur në Kursall më dt. 27. 04. 1985, prej orës 14-18. "

Nijazi Mehmeti, nga fshati Bilinicë, KK Gjilan, tani i punësuar në Bernë-Zvicër.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet pjesërisht të vërtetuara. Në bisedën telefonike me 'Kobrën' ka pasur për detyrë që të identifikojë personin nga Gjilani, i cilin tani bën identifikimin e tij dhe jep emrin e Nijazi Mehmetit. (Shiko raportin e 'Kobrës' nr. 960333/85 të dt. 17. 05. 1985). bashkëpunëtori do të udhëzohet sipas depeshes suaj nr. 5-664/a-të dt.

18. 05. 1985, e cila bën fjalë për takimin e LRSSHJ-së për vdekjen e Zija Shemsiut si dhe për organizimin e demonstratave në Zvicër.

IV

Vërejtjet çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x ShSSH SKPB

2 x këtij Drejtorati

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Asgjësimi i thirrjeve për katërvjetorin e demonstratave

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt. op. Sejfullah Sahatçiu

RAPORT I BASHKËPUNËTORIT

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me aktivitetin e LRSHJ, në Zvicër, rreth shënimit të katërvjetorit të demonstratave kundërrevolucionare në Kosovë.

Biseda është zhvilluar përmes telefonit më dt. 25. 03. 1985, në orën 22.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më 26.03.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e LRSSHJ në Zvicër.

III

Më datën 25.03.1985, në orën 22, bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet telefonit nga Zvicra lajmëron: "Sot kam marrë afër 30 copë thirrje që ato t'i shpërndaj bashkëmendimtarëve të LRSSHJ-së, se më dt. 30.03.1985, do të mbahet një tubim në Gjenevë në shenjë të manifestimit të katërvjetorit të demonstratave kundërrevolucionare në Kosovë. Ky tubim mbahet në njërin prej klubeve të LRSSHJ në Gjenevë duke filluar në orën 19. 30minuta. Thirrjet do t'i asgjësojë, ndërsa një ekzemplarë nëpërmjet korrespondencës do t'ju dërgoi juve. Do të marr pjesë në këtë tubim pasi sipas të gjitha gjasave ditën në fjalë nuk do të punoi. "

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt për çka edhe mendojmë se shënimet duhet të jenë të sakta. Meqë bashkëpunëtori do të marrë pjesë në këtë tubim, për çka ka shpreh edhe gatishmëri, me raportin e vet do të na lajmërohet rreth vërejtjeve të këtij tubimi. Lidhur me këtë jeni njoftuar edhe me depeshen tonë nr. 88 të datës 26.03.1985.

V

Vërejtjet, çmimet deh vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x ShSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. 'Kobra'

1 x Evidencës

1 x punë. Të vijës së II

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Detyrë e 'Kobrës': Ta përhapë lajmin se Ibrahim Kelmendi ka marrë pjesë në vrasjen e vëllezërve Gërvalla e Kadri Zekës

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt.op. Sejfullah Sahatçiu

Më 24.05.1985.

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori 'Kobra'.

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik i cili qarkullon në mesin e disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

Materiali është dërguar nëpërmjet postës i cili nëpërmjet SHSSH SKPB në DSHSSH-Gjakovë ka arritur më dt. 23.05.1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më 24.05.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori 'Kobra' nëpërmjet dërgesës postare e në emër të punëtorit i cili e mban në lidhje, ka dërguar këto materiale propagandistike 12 copë gazeta "Zëri i Popullit" organ i Komitetit Qendror

të PPSH, 6 copë "komunikata" për rastin e Zija Shemsiut, 4 copë "komunikata" rreth bashkimit të disa organizatave të LRSSHJ-së, 3 thirrje e pamfletit "Liria", 6 fotokopje të "Zërit të Popullit" me artikuj të ndryshëm rreth ngjarjeve në Kosovë, 1 copë të fjalimit të Enver Hoxhës në Kongresin e 8 të PPSH, 1 komunikatë rreth vdekjes së Rexhep Malës e Nuhi Berishës dhe 3 fotografi të pjesëmarrësve në demonstratat e organizuara në Zvicër. Përveç këtyre materialeve bashkëpunëtori 'Kobra' në raportin e vet me shkrim shkruan: "LRSSHJ për ftesën e 1 majit 1995, ka përgatitë disa trakte në gjuhën gjermane, frënge dhe ato angleze. Kështu që në Cyrih, Bazel, Gjenevë dhe në qytete tjera rreth Zvicrës për këtë festë nga ana e qytetarëve të tyre janë organizuar marshe protestuese rreth rritjes së të ardhurave, rreth armëve bërthamore, por këto janë marshe tradicionale e duke e shfrytëzuar këtë, Rustem Mahmutaj, Enver Avdullahu dhe Beat Schafer bënë shpërndarjen e këtyre trakteve me titull "Brot, Arbeit, Freiheit, Republik". Rustem Mahmutaj, nga fsh. Lybeniç KK Pejë, Enver Avdullahu, i njohur nga shërbimi. Beat Schafer, librashitës në Biel.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Fotografitë (tri copë) e dërguara nga 'Kobra' shihet Rustem Mahmutaj dhe disa persona tjerë në njërin prej demonstratave antijugosllave të organizuara në Zvicër, e që këto fotografi do të ngelin në lëndën e bashkëpunëtorit me qëllim që me ardhjen e 'Kobrës' në vendlindje të bëjë identifikimin e personave tjerë. Nëse paraqitet nevoja e shërbimit, këto fotografi mund t'i riprodhojmë dhe të ju dërgojmë. Të gjitha materialet e përmendura, përveç fotografive, janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. 'Kobra'

1 x Evidencës.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

DREJTORATI i SHSSH, Gjakovë.

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë materialin i cili në emër të Sejfullah Sahatçiu ka mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: Plikoja me materiale

SM Kryeshefi i Sektorit II, Enver Prekadinaj

Aksioni 'Dogma'

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtori-Gjakovë
punt.op. Sejfullah Sahatçiu
Më 17.04.1985.

I

Raport i bashkëpunëtorit
Burimi: bashkëpunëtori 'Kobra'.
Shënimet kanë të bëjnë lidhur me veprimtarinë armiqësore të LRSSHJ-së
në Zvicër lidhur me aksionin 'Dogma'.
Biseda është zhvilluar nëpërmjet telefonit zyrtarë më 16.04.1985 në
orën 19,30.
Me iniciativën e bashkëpunëtorit
Shpenzime nuk ka pasur.
Raporti paraqitet më dt. 17.04.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të
LRSSHJ-së.

III

Në bisedë telefonike me bashkëpunëtorin 'Kobra' përveç tjerash
përmendi:

"Në Cyrih, të dielën më dt. 14.04.1985 jam njoftuar se është mbajtur një
mbledhje përkujtimore me rastin e vdekjes së Enver Hoxhës. Unë nuk
kam qenë prezent por një lajm i tillë dëgjohej në mesin e punëtorëve
tanë të punësuar në Zvicër. Gjithashtu deri më tani nuk më është e
njohur që dikush nga LRSSHJ ka shkuar në RPSSH për pjesëmarrje në
varrim të E. Hoxhës.

Në kohën e fundit LRSSHJ i ka dërguar Komitetit Ndërkombëtar për të
drejtat e njeriut një petition me afro 400 nënshkrime e në të cilën
përmenden padrejtësitë dhe terrori ndaj popullit shqiptar në Kosovë dhe
Jugosllavi.

Ndaj Ibrahim Kelmendit, shumica e anëtarëve të LRSSHJ-së kanë filluar
të largohen duke e çmuar atë si të dyshimtë se ka marrë pjesë apo ka
gisht në vrasjen e Isuf Gërvallës dhe të tjerëve.

Ibrahim Kelmendi, i njohur nga shërbimi.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Shënimet e pavërtetuara por munden me qenë të sakta. 'Kobra' ka marrë
detyra të reja rreth sigurimit të petitionit, nëse ka mundësi.

V

Vërejtje, çmimet edhe vendimet e eprorit :

Dërgohet

2 X SHSSH SKPB

1 X Evidencës

1 X në lëndë të bashk. 'Kobra'.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Paraqitja e Naim Malës në skenë

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt.op. Sejfullah Sahatçiu

Më 16.04.1985.

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori 'Kobra'.

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të LRSSHJ në Zvicër.

Bashkëpunëtori nëpërmjet dërgesës postare të dërguar më 10.04.1985. paraqet edhe raportin

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më dt. 16.04.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë e disa anëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori nëpërmjet korrespondencës, ka dërguar librin doracak pamfletist "TITISTËT" e klubit të punëtorëve shqiptarë "Igballe Prishtina" të Gjenezës për pjesëmarrje në katërvjetorin e shpërthimit të demonstratave në Kosovë si dhe një "Memorandum" në gjuhën frëngjishte të cilën e ka botuar LRSSHJ, në Biel-Bienne. Pastaj bashkëpunëtori shkurtimisht lajmëron se: "Në mbrëmjen e 30.03.1985 e cila u organizua në Gjenezë, në një sallë të madhe , djali i Hasan Malës ka lexuar dhe mbajtur fjalën e mbrëmjes përkujtimore".

N. MALA, djali i Hasan Malës, i cili tani gjendet në Zvicër.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet e vërtetuara pasi flasin materialet e dërguara. Sipas bashkëpunëtorit, për këtë rast ka dërguar raportin i cili ende nuk ka arritur. Lidhur me takimin që është mbajtur më 30.03.1985, jeni njoftuar me depeshen tonë nr. 88 të dt. 26.03.1985.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x në lëndë të bashk. 'Kobra'.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

MST: Informimi i opinionit për vrasjen e Zija Shemsiut në burgun e Beogradit

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

Punt.op. Sejfullah Sahatçiu

Më 11.05.1985

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori 'Kobra'.

Shënimet kanë të bëjnë me LRSSHJ në Zvicër.

Biseda është zhvilluar me 09.05.1985, përmes telefonit zyrtar, prej orës 13,40 minuta.

Më iniciativën e punëtorit operativ.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet me 11.05.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjellë veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ-së, në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori 'Kobra' përmes telefonit lajmëron: "Nëpër shumë qytete të Zvicrës e ashtu edhe në Bernë janë shpërndarë kumtesa në të cilat shkruhet për vrasjen e Zija Shemsiut. Në kumtesa përveç tjerash shkruhet: "Lajmërojmë se më dt. 04.05.1985 është vrarë vëllai ynë Zija Shemsiu në burgun e Beogradit nga ana e UDB-së Jugosllave". Këso kumtesa kam vërejtur nëpër shumë vende dhe sasi të mëdha.

Janë duke u bërë përgatitjet për mbledhjet përkujtimore kushtuar vdekjes së Enver Hoxhës. Këto mbledhje gjerë në momentin e fundit nuk do të publikohen nga frika se a mos ndodhë sikurse me atë në Bernë kur pronari i restorantit nga frika se do t'i hedhin bombë, nuk iu ka lejuar lokalitë-restorantit dhe gati dështoi kjo mbledhje përkujtimore (shiko raportin e bashk. 'Kobra' të dt. 06.05.1985, nr. 960276/85, vr. e punt.op.). Sipas disa të dhënave, këto mbledhje do të mbahen në pjesën e dytë të muajit maj 1985, duke filluar së pari në Lozanë e pastaj me radhë edhe në qytetet tjera të Zvicrës".

Detyra e Kobrës...

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt shënimet pjesërisht të vërtetuara. Lidhur me këtë jeni njoftuar me depeshen tonë nr. 188/09.05.1985. në bisedë me bashkëpunëtorin i janë dhënë detyrë që në mesin e punëtorëve tanë të punësuar në Zvicër-Bernë dhe qytete tjera të përhap lajmin dezinformues gjoja se Ibrahim Kelmendi është ai njeri që ka marrë pjesë në vrasjen e vëllezërve Gërvalla, se si gjatë kohës sa ka qenë në Kosovë është shoqëruar me organet e sigurimit dhe se Ibrahim Kelmendin do ta vrasin vëllezërit tjerë Gërvalla apo dikush tjetër nga LRSSHJ. Këto detyra i janë dhënë 'Kobrës' me sugjerimin e kryeshefit të sektorit të II të SKPB - SHSSH, Enver Prekadinaj.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x Evidencës

1 x në lëndë të bashk. 'Kobra'.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Mendimi i Sekretariatit Federativ për 'Kobrën' dhe 'Hiltonin'

12.03.1985, Prishtinë

Dega e SHSSH-sektori V, Gjakovë

Në mbështetje të aktit po ua japim letërkëmbimin e fotokopjuar të SHSPB faqe deri nr. 270/60 datë 19.02.1985 e cila ka të bëjë me analizën e bashkëpunëtorëve "Kobra" dhe "Hilton".

Kryeshefi i Sektorit të II

Enver Prekadinaj

Sekretariati Federativ për Punë të Brendshme

Sekretariati Republikan për Punë të Brendshme

.....?
.....?

Beograd

SRPB RS e Serbisë-SHSSH sektori I - Kryeshefit Beograd

SKPB KSA Kosovë - SHSSH sektori II - Kryeshefit Prishtinë

LËNDA: Pozicioni operativ i 'Kobrës' dhe 'Hiltonit', të dhënat që kthehen. Duke u nisur nga detyrat me prioritet të programit të këtij viti e ky është puna me rrjetin e bashkëpunëtorëve dhe zbatimin e komunikimit operativ për ndërtimin e pozicionit për ta luftuar emigracionin armiqësor shqiptar posaçërisht LPRSHJ-së, në këtë rast po japim analizën tonë lidhur me bashkëpunëtorit 'Kobra' dhe 'Hilton'.

'Kobra' duhet të bie në kontakt me Xhafer Shatrin

Vlerësojmë se 'Kobra' ka kushte që edhe më tutje të orientohet konkretisht në drejtim të udhëheqjes së LPRSHJ-së në Zvicër, dmth. që të drejtohet në drejtim të Kadri Abdullahut më perspektivë që të afrohet te Xhafer Shatri. Propozojmë që të shqyrtohet puna e përgjithshme, rezultatet, kushtet për shfrytëzim të mëtutjeshëm të tij, shkallën e përkushtimit, me qëllim që puna e ardhshme me ta të organizohet dhe drejtohet në drejtim të Xhafer Shatrit nëpërmjet Kadri Abdullahut. Në këtë drejtim duhet të ketë parasysh analiza e vazhdueshme sepse 'Kobra' iu është ekspozuar presioneve edhe nga prezenca e shërbimit shqiptar dhe shërbimeve tjera informative. -Në punë me të duhet kujdes i madh dhe sjellje e tillë, e cila nuk përjashton mundësinë e tërheqjes së tij për bashkëpunim nga policia Zvicerane ose shërbimi shqiptar. Dëshira jonë është që përjetë të lidhemi – pas punëve të kontraktuara – në vlerësimin e efikasitetit të tij, punës së mëtutjeshme të organizimit dhe instruktimit konkret rreth mbajtjes së lidhjeve ...dhe tjetrit, me qëllim që nga 'Kobra' të krijojë një pozicion kualitativ operativ. Në punë me 'Kobrën' duhet të kemi parasysh edhe faktin se ka lidhje me 'Hiltonin'....

II

Kemi analizuar dhe vlerësuar shumë të dhëna nga 'Hiltoni'. Të dhënat nga ju gjashtë muajt e fundit të çojnë në përfundim se rasti i tij kërkon rishqyrtim përmbajtjesor. Një pjesë e të dhënave të cilat i ka ofruar janë shumë drastike dhe të orienton se "ONDSH" e E. Vazlia po përgatiten për të kryer aksione diversante terroriste , çka askush nga burimet ekzistuese të shërbimeve të SHSSH-së, dhe shërbimi i punëve të jashtme nuk i ka bazuar. Në anën tjetër të dhënat e përgjithshme na çojnë se ONDSH - deri sot nuk ka

përdorë terrorizmin. Më tutje nuk janë vërtetuar qëllimet e Shemsedin Kryeziut nga të dhënat e 'Hiltonit'. Nuk e mban fjalën si në rastin më të ri lidhur me ONDSH "?" për futjen e 25 automatikeve. Ofron të dhëna, por asgjë më shumë. Vihet te përfundimi se me 'Hiltonin' si "zogistë të vjetur", ONDSH dhe Vazliu nuk kanë ndonjë lidhje të besueshme, e gjithashtu edhe LPRSH dhe nëpërmjet tij ndoshta po na dërgojnë dezinformata, me qëllim që të lodhemi për verifikimin e tyre. Ndoshta dyshojnë për shkak të ardhjes së shpeshtë në vend dhe me qëllim e dezinformojnë. Të dhënat e mëparshme obligojnë që të rishikohet dhe vlerësohet në mënyrë operative si në pikëpamjen e besueshmërisë, ashtu edhe në orientimin e ardhshëm të tij, e po ashtu lidhjet e theksuara me 'Kobrën'. Si edhe në rastin e 'Kobrës' duam që patjetër të kyçemi për vlerësime të përbashkëta dhe orientimin e mëtutjeshëm me instruksione konkrete për këtë bashkëpunëtor.

.....?
.....?

Duke u nisur nga të dhënat propozojmë punë operative në bashkëpunim me SHSSH të SKBP të Kosovës – sektori II lidhur me shfrytëzimin e mëtutjeshëm të 'Kobrës' dhe 'Hiltonit'.

Konkretisht lidhur me këtë marrëveshje dhe do të merremi vesh në telefon.

22-AM/SI, Kryeshefi Ivan Llasiq

Më 25.03.1985, Prishtinë

Dega e SHSSH, Gjakovë

Në mbështetje të akteve po ju ofrojmë materialet të cilat janë në emër të Sejfullah Sahatçiu të ardhura nga Zvicra

Kryeshefi i sektorit II, Enver Prakadinaj

SKPB KSAK-SHSSH

Dega Gjakovë

Punëtori

operativ:

Mehmet

Haskaj

Shënim zyrtar

Datë 24.04.1985

"Nëpërmes Rrustem Mahmutaj jam njoftuar me një punëtor që punon përkohësisht në Bernë me emrin Mark Prekaj ose Perkaj, i lindur në Gjakovë ose rrethinë, punon në një restorant në Bernë i cili quhet "Bir Hubelei", i cili ka vizën "B", ka jetuar vetë në Bernë, ndërsa tash ka marrë edhe vajzën e një emigranti nga Shqipëria i cili jeton në Kosovë. Në banesën e Mark Prekaj ose Perkaj, kam parë fotografinë e Enver Hoxhës, gazetën "Zëri i Popullit" dhe "Zëri i Kosovës". Kam qenë personalisht në një bankë me Markun, ku Marku pagoi 32 franga belge në llogari të "Zërit të Kosovës" për parapagim. Ai mua më tha se e parapaguan për shkak se dikush i ka sjellë një dhuratë nga Shqipëria, por e kam dëgjuar kur punëtori i bankës, germë për germë, tregoi kujt po Ia

dërgon. Nga Mark Prekaj-Perkaj furnizohet me këtë literaturë një punëtor i rrethit të Gjakovës, që jeton në Pejë me emrin Gjin Alakaj”.

Punëtori operativ

Nënshkrimi

Më 29.04.1985

Prishtinë

Degës së shërbimit të sigurimit shtetëror

Gjakovë në mbështetje të akteve iu ofrojmë shënimet zyrtare të cilat kanë të bëjnë me njerëzit e rrethit tuaj.

Kopje e vetme.

Kryeshefi i degës SHSSH

Asllan Sllamniku

Letra kërcënuese në emër të shefit të restorantit “Bierxhubeli”

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

Punt.op. Sejfullah Sahatçiu

Më 14.05.1985

Raport i bashkëpunëtorit

(Plotësim i raportit nr. 96027685 të dt.06.05.1985)

I

Burimi: Bashkëpunëtori ‘Kobra’.

Shënimet kanë të bëjnë me tubimin e disa anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër në mbledhjen përkujtimore kushtuar vdekjes së Enver Hoxhës.

Raporti ka arritur më 11.05.1985 në adresë të punëtorit operativ.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më 14.05.1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori “Kobra” përveç bisedës telefonike të zhvilluar më dt. 29.04.1985, tani lidhur me rastin në fjalë bënë zgjerimin dhe plotësimin e raportit të vet, ku ndër të tjera shkruan: “Letra kërcënuese e dërguar në emër të shefit të restorantit “Bierxhubeli” që të mos iu lejojë tubimin anëtarëve të LRSSHJ-së, kishte përafërsisht këtë përmbajtje: “Shqiptarët në sallën e juaj do të organizojnë një tubim përkujtimor kushtuar Enver Hoxhës, mirëpo lutemi që tubimi i tillë mos të ju lejohet pasi tubimi ka

karakter politik dhe se ata që tubohen aty janë bandë komuniste të cilët zhvillojnë ideologji të vdekur marksiste-leniniste e staliniste. Ne jemi kundër ideologjisë së tyre dhe se për punën e tyre është lajmëruar edhe parlamenti. Prandaj kishte me qenë mirë që në restorantin tuaj të mos mbahet ky takim se në të kundërtën do të vëmë bombë dhe do ta asgjësojmë pasurinë tënde e së bashku me të do të kesh dëme edhe në njerëz". Letra është shkruar në gjuhën gjermane ndërsa autori anonim. Nga frika, shefi i këtij restoranti dhe pas konsultimit me mua, ka hequr dorë nga rezervacioni duke vënë në hyrje të restorantin lajmërimin se sallën nuk mund ta jap nga frika e ndonjë eksplozimi. Kështu Brenda pak kohë Hasan Mala, Rrustem Mahmutaj dhe Adem Sadrija kanë rezervuar një sallë tjetër në vendin e quajtur "KURSALL" afër Bernës, për ç'gjë kanë paguar 700 franga zvicerane. Në këtë sallë ku ishin tubuar afër 180 veta, përveç të tjerëve foli edhe Kadri Avdullahu nga Gjeneva, i cili kërkoi nga të pranishmit që më grusht lart të ngrihemi në këmbë dhe të mbajmë zi. Pas këtij akti, Kadriu në fjalimin e vet ndër të tjera ceku: "Në ditën e këtij prilli pushoi së rrahuri zemra e birit të shtrenjtë të popullit shqiptar, shokut Enver Hoxha, sekretarit të parë të KQ të PPSH, kryetarit të këshillit të përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, komandantit të përgjithshëm të forcave të armatosura të RPSSH..." përveç Kadriut në këtë tubim foli edhe bashkëshortja e Kadriut, Sanija e lindur në fsh. Poliqkë KK Gjilan e cila përveç tjerash tha: "Të përkujtojmë jetën dhe veprën e pavdekshme të Enver Hoxhës, të ndajmë pikëllimin dhe dhembjen e madhe që i ka kapluar të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë, për humbjen e birit më të shtrenjtë, themeluesit të partisë, udhëheqësit të LNÇ-së, ideologut dhe strategut të Shqipërisë. Të gjitha fitoret, të gjitha sukseset që ka arritur. Shqipëria socialiste, janë meritë e linjës së drejtë të partisë së udhëhequr nga shoku Enver. Veprat e shokut Enver janë dhe do të mbesin busull, fanar ndriçues për të gjithë revolucionarët. Sa të drejta dhe të arsyeshëm ishin konkluzionet dhe mendimet e shokut Enver për Kosovën, të studiuara dhe të ndriçuara nën prizmin e marksizëm-leninizmit. Andaj shoku Enver jeton dhe do të jetojë për jetë në zemrat tona. Lavdi e përjetshme veprës së shokut Enver, Rroftë PPSH, Rroftë populli shqiptar" në çka të pranishmit me zë të lartë kanë brohoritë "Rroftë".

Edhe pse jam zviceran, veprat e Enver Hoxhës më kanë pëlqyer

Në vazhdim të kësaj mbledhjeje përkujtimore fjalën e ka marrë Beat Schafer nga Biella, i cili ndër të tjera tha: "me rastin e së pushuarit të zemrës së Enver Hoxhës, të gjithë popullin shqiptar e kaploi mërzia sepse Enver Hoxhën ishte dhe mbetet një ideolog komunist, internacionalist, marksist-leninist. Unë kam lexuar në gjuhën gjermane shumë vepra të Enver Hoxhës e ndër to edhe "Titistët". Edhe pse jam zviceran, veprat e

Enver Hoxhës i kam pëlqyer pamasë dhe i kam futur në jetë". Pastaj fjalën e mori djali i Hasan Malës, i cili lexoi artikullin nga "Zëri i Popullit" me titull "Elegji për Enver Hoxhën" e botuar më 20 prill 1985, ndërsa Kadri Avdullahu u paraqit me dy poezi kushtuar Enver Hoxhës të marra nga "Zëri i Popullit" të dt. 21 prill 1985. Në këtë tubim ishte edhe Hajdar Sadrija dhe Adem Sadrija, e ky i dyti së bashku me Kadri Avdullahun dhe djalin e Hasan Malës përbënin njëfarë komisioni që kishte të bënte me përgatitjen e vjershave dhe poezive kushtuar këtij tubimi. Përveç të tjerëve, në këtë tubim është paraqitur edhe një shtetas turk i cili ndër të tjera tha: "Enver Hoxha nuk është vdekur sepse nuk vdes historia e tij. Ai vulosi epokën e vet, të gjithë proletareve dhe revolucionareve iu tregoi rrugën e revolucionit..." i njëjti i takon partisë marksiste-leniniste "TDKP". Në këtë tubim ishin edhe Remzi e Shemsi Cakaj nga Kaçaniku, Rrustem Mahmutaj i cili solli edhe flamurin kombëtar dhe pas mbarimit të këtij tubimi ai bëri shpërndarjen e "Zërit të Popullit" dhe "Zërin e Kosovës". Hasan Mala ishte në shoqëri të Shaqës nga Kaçaniku ndërsa me Shaqën ishte edhe nëna e tij së bashku me bashkëshorten dhe dy fëmijët. Përveç tyre ishte edhe Sheremet N., i cili bënte shpërndarjen e materialit propagandistik, pastaj Ibrahim Kelmendi, Sadri Mulaj nga Kaliçani KK Pejë. Këtë tubim me kamerë e ka përcjellë një pjesëtar i LRSSHJ-së. Në fund të këtij "manifestimi" bashkëshortja e Kadri Avdullahut lexoi telegramin dërguar PPSH dhe organeve tjera. Ky telegram është botuar në "Zërin e Kosovës" nr.4-1985".

RRUSTEM MAHMUTAJ, nga fshati Lybeniq, KK Pejë,
HASAN MALA, nga Gjilani,
KADRI AVDULLAHU,
SANIE ZEÇA-ZEKA, bashkëshortja e Kadri Zekës.
BEAT SCHEFER, librashitës nga Biella,
N. MALA; djali i Hasan Malës nga Gjilani,
HAJDAR SADRIJA, nga Ponosheci KK Gjakovë,
ADEM SADRIJA, nga Ponosheci KK Gjakovë,
REMZI CAKAJ, nga Kaçaniku.
SHEMSI CAKAJ, nga Kaçaniku,
SHEREMET N.,
IBRAHIM KELMENDI, i njohur shërbimit.
N. AVDULLAHU, bashkëshortja e Kadri Avdullahut.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Burimi i sigurt, shënimet pjesërisht të vërtetuara. Lidhur me këtë raport nuk janë njoftuar drejtoratet tjera nga frika që mos të vihet gjerë tek dekonspirimi i bashkëpunëtorit.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x në (LPO) të Adem dhe Hajdar Sadriut.

Punëtori operativ,

Sejfullah Sahatçiu

Detyra e Kobrës: Lansimi i dezinformatave

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë materialet, të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërri nga Zvicra.

Shtojcë: Plikoja me materiale

SM

Kryeshefi i sektorit II, Enver Prekadinaj

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Lidhur me raportin e bashkëpunëtorit "Kobra" nr. 276/85 te datës 06. 05. 1985. ju njoftojmë se jemi të mendimit që në të ardhmen bashkëpunëtori sa më tepër të udhëtohet në lansimin e dezinformimeve të tilla, siç është ky lidhur me moslejimin e mbajtjes së tubimit në restorantin e përmendur, por gjithnjë duke pasur kujdes që mos të vijë deri te dekonspirimi

SM. Shefi i sektorit II, Enver Prekadinaj

Mbledhja e parave për rregullimin e varrit të Zija Shemsiut

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë, punt. op. Sejfullah Sahatçiu

Më 16. 05. 1985

I

Burimi: Bashkëpunëtori 'KOBRA'

Shënimet kanë të bëjnë me ndihmat e LRSSHJ-së familjes së ish të dënuarit politik, tani të vdekurit Yija Shemsiu nga Gjilani.

Biseda është zhvilluar më 16. 05. 1985

Përmes telefonit në ora 14, 00

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet me 16. 05. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Më dt. 16. 05. 1985. bashkëpunëtori 'Kobra' nëpërmjet telefonit në mënyrë të shkurtër dhe të shpejtë lajmëron: jamë njoftuar se "LRSSHJ" në Zvicër ka mbledhur 7000 franka zvicerane të cilat do t'i dërgohen nënës së Zija Shemsiut si ndihmë për varrosjen dhe rregullimin e varrit të Zijaut. Personi i cili do ti sjellë këto para për mua është i panjohur pasi që një gjë e tillë paraqet fshehtësi për LRSSHJ-në. Këto të holla nuk di as nga kanë mundur t'i mbledhin pasi që deri më tani nuk kam dëgjuar e as nuk kam dhënë kurrfarë ndihme në të holla për këto qëllime apo qëllime tjera.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet të pavërtetuara. Është mirë që DSHSSH-Gjilan të marrë masat e duhura rreth vërtetimit të këtij shënimi. Bashkëpunëtorit iu është dhënë për detyrë që nëse dëgjon për personin i cili do ti sjellë këto para në Jugosllavi, të dedikuara për ndihmë familjes së Zija Shemsiut, menjëherë të na lajmërojë. Lidhur me këtë jemi njoftuar edhe me depeshen tonë 199 të dt. 16. 05. 1985.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet :

2 X SHSSH SKPB

1 X në lënd të bashk. "Kobra"

1 X Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatqiu

Paralajmërim për demonstrata të reja në Cyrih

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtori-Gjakovë, punt. op. Sejfullah Sahatqiu
Më 16. 05. 1985

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me organizimin e demonstratave antijugoslave në Zvicër – Cyrih, nga ana e "LRSSHJ-s".

Biseda është zhvilluar nëpërmjet telefonit më dt. 14. 05. 1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.
shpenzime nuk ka pasur.
Raporti paraqitet më 16. 05. 1985.

II

Bashkëpunëtori "KOBRA" përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të "LRSSHJ"-s në Zvicër.

III

Nëpërmjet telefonit më dt. 14. 05. 1985 bashkëpunëtori "Kobra" lajmëron: "Para një jave pjesëtarët e "LRSSHJ"-s në Zvicër kanë bërë kërkesë organeve policore që t'u lejohen demonstrata të cilat do të organizoheshin në qytetin Czrih. Demonstratat i kanë paraqitur që të organizohen brenda muajit maj 1985.

Në Lozanë është mbajtur mbledhja përkujtimore për vdekjen e Enver Hoxhës. Në këtë mbledhje kanë qenë afër 130 persona, e në mesin e tyre edhe Hajdar e Adem Sadrija nga Ponosheci, KK Gjakovë, dhe Rustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq, KK Pejë, në këtë tubim përkujtimor unë nuk kam marrë pjesë".

Hajdar Sadrija, nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë (LPO)

Adem Sadrija, nga fsh. Ponoshec, KK Gjakovë (LPO)

Rrustem Mahmutaj, nga fsh. Lybeniq, KK Pejë tani jeton në Bërnë/Zvicër.

Udhëzime për "Kobrën"

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt ndërsa shënimet për demonstrata ende të pavërtetuara. "Kobrës" iu është dhënë për detyrë që nëse njoftohet më për së afërmi për organizimin e demonstratave, të na njoftojë menjëherë sa më urgjentisht. Njëherësh bashkëpunëtorit iu është dhënë për detyrë që brenda mundësive t'i identifikojë personat që janë angazhuar më tepër në organizimin e kësaj demonstrate.

Lidhur me këtë shënim jeni njoftuar edhe me depeshen tonë nr. 192 të dt. 14. 05. 1985. Me një insert të këtij raporti është njoftuar DSHSSH Pejë.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet: 2 X SHSSH SKPB

1 X Në lëndën e Sadrijajve

1 X në lëndë të bashk. "Kobra".

1 X insert DSHSSH Pejë.

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

“Kobra” duhet ta identifikojë një veprimtar nga Gjilani

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtori-Gjakovë, punt. op. Sejfullah Sahatçiu
Më 17. 05. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: bashkëpunëtori “Kobra”.

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik që lexohet dhe qarkullon në mesin e pjesëtarëve të LRSSHJ, në Zvicër.

Materiali nëpërmjet SHSSH-SKPB, ka arritur më 16. 05. 1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më dt. 07. 05. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori “Kobra” nëpërmjet postës, në adresë të punëtorit operativ që e mban në lidhje, ka dërguar “Zërin e Kosovës” nr. 4IV. 1985. pastaj “Thirrjen” për tubimin përkujtimor që është mbajtur në Bernë si dhe 6 numra të “Zërit të Popullit” Organ i Komitetit Qendror të PPSH, të dt. 20, 21, 23, 24, 25, dhe 26 Prill 1985.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori tepër produktiv dhe deri me tani ka dhënë shënime interesante dhe të sakta. Ka marrë përsipër që të identifikojë një person nga apo rrethi i Gjilanit i cili ka filluar të merret me veprimtari armiqësore. Sipas bisedës telefonike, personin e njeh por ende nuk e ka identifikuar. Me “Kobrën” mbahen kontaktet e vazhdueshme nëpërmjet telefonit dhe letërkëmbimit.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. “Kobra”

1 x Evidencës, Punëtori operativ Sejfullah Sahatçiu

'Kobra' duhet të vazhdojë me dezinformim

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Lidhur me raportin e bashkëpunëtorit "Kobra" nr. 299/85 të dt. 11. 05. 1985. ju sugjerojmë që të njëjtit t'i jepet për detyrë, që nëse di për vendin se ku do të mbahet tubimi që përmendet në raport, atëherë le të përdorë prapë të njëjtin gjest dezinformimi sikurse në rastin e parë.

SM

Kryeshefi i sektorit II, Enver Prekadinaj

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë,

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë propagandistike të LRSSHJ-së në Zvicër. Raporti është dërguar nëpërmjet dërgesën postare dhe ka arritur më dt. 18. 05. 1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më datën 20. 02. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

Njoftim për veprimtarinë e Njazi Mehmetit nga Gjilani

III

Në raportin e vet me shkrim "Kobra" ndër të tjera shkruan: "Në mbledhjen përkujtimore për vdekjen e Enver Hoxhës e cila është mbajtur në Kursall afër Bernës, përveç të tjerëve ishte edhe Nijazi Mehmeti nga fshati Bilinicë KK Gjilan. Njaziu së bashku edhe me katër persona të moshës së re gjithashtu nga Gjilani, sikurse të tjerët janë ngritë në këmbë për t'i dhënë nderimet e fundit Enver Hoxhës. Njaziu deri para një viti ka pasur qëndrim pozitiv ndaj RSFJ-së, nuk ka marrë pjesë në demonstrata, mirëpo tani ka filluar vazhdimisht të marrë dhe lexon "Zërin e Kosovës". Shkon në disa klube pasi që daja i tij është sekretar i klubit

të Lozanës. Njaziu punon në Bernë në një restorant me emrin "Kristofel" Unterfyfrig Bonhof. Në Bernë punon edhe babai i Njaziut i cili ka qëndrim të mirë dhe aspak nuk i intereson politika. Njaziu është lidhur me Rrustem Mahmutajn nga fshati Lybeniq, KK Pejë, të cilët edhe janë duke i përgatitur thirrjet".

Zahir Zahiri, nga fshati Prelepticë, KK Gjilan.

Rrustem Mahmutaj nga fshati Lybeniq, KK Pejë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt ndërsa shënimet e prezantuara në kohë do të vërtetohen kuptohet pas mbajtjes së këtij tubimi. Menjëherë pas këtij takimi, do të jemi në kontakt me "Kobrën", i cili do të na njoftojë mbi qëndrimet dhe rrjedhat e këtij tubimi. Lidhur me këtë, jeni njoftuar edhe me depeshen tonë nr. 155 të dt. 19. 04. 1985. me nga një ekzemplarë të këtij raporti është njoftuar DSHSSH Pejë dhe Gjilan.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x DSHSSH Pejë

1 x SSHSSH Gjilan

1 x Në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Dërgimi i materialeve me iniciativën e bashkëpunëtorit

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë,

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu

Më 23. 04. 1985.

I

Raport i bashkëpunëtorit

Bashkëpunëtori "KOBRA".

Shënimet kanë të bëjnë me materialin propagandistik i cili qarkullon në mesin e disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

Materialet janë dërguar nëpërmjet dërgesave postare, ndërsa në DSHSSH Gjakovë kanë arritur më dt. 22. 04. 1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më 23. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ-s në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet dërgesave postare, e në emër të punëtorit operativ i cili e mban në lidhje këtë bashkëpunëtor, ka dërguar "Zërin e Kosovës nr. 1. 01. 1985. të fotokopjuar, "Zërin e Kosovës" nr. 2-1985. si dhe 18 numra të "Zërit të Popullit", organ i komitetit qendror të PPSH-s të dt. 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 30 mars 1985 pastaj në dt. 2, 3 dhe 4 prill 1985 në gazetën e dt. 15. Mars 1985 është artikulli "Krizë në ligjshmërinë Jugosllave", dhe në numrin e dt. 2. prill 1985 është artikulli me titull "Ethe sallvoshoviniste në Beograd-Republikë për një artikull të "Veqernje Novostit".

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori rregullisht dërgon materiale të tilla propagandistike të cilat qarkullojnë në mesin e disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

Dërgimin e këtyre materialeve bashkëpunëtori e bën me iniciativën e vet dhe pa u diktuar nga askush. Së bashku me raportin e bashkëpunëtorit ju sjellim edhe materialet e cekura në këtë raport.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 X SHSSH SKPB

2 X Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkëpunëtori i aktit përcjellës ju dërgojmë plikon me material, i cili në emër të Sejfullah Sahatçiu, ka mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: Plikoja me materiale

SM

Kryeshefi i sektorit të II, Enver Prekadinaj

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë plikon me materiale, të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra

Shtojcë: plikoja me materiale

SM

Kryeshefi i sektorit të II, Enver Prekadinaj

Bashkëpunëtori duhet të veprojë në klub ose ndaj dy-tre njerëzve

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Lidhur me raportin e bashkëpunëtorit "Kobra" nr. 187/85 të datës 29. 03. 1985. po theksojmë se është mirë që bashkëpunëtori të orientohet në klub ose ndaj dy-tre njerëzve, kuptohet, me instruktazhë dhe qëllim të caktuar e jo ende të veprojë në këtë mënyrë pasi që është bashkëpunëtor.

Duhet t'i sugjerohet që të bëjë identifikimin e sa më shumë pjesëmarrësve të tubimeve, të cilat janë duke u organizuar si ky i 24. 11. 1984. Në mënyrë që të ndërmerren masat konkrete kundër çdo pjesëmarrësi. Është shumë interesant se nëpërmjet këtyre tubimeve shihet karakteri i tyre thjeshtë irredentistik.

SM

Kryeshefi i sektorit të II, Enver Prekadinaj

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkëpunëtori aktit përcjellës ju dërgojmë plikon me materiale, të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërritur nga Zvicra.

Shtojcë: plikojë me materiale

Djali i Dervish Shaqës këndon këngë për dëshmorët në Zvicër

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë,

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu

I

Raport i bashkëpunëtorit

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë armiqësore të LRSSHJ-së në Zvicër.

Materialet kanë arritur më 25. 04. 1985, në DSHSSH Gjakovë nëpërmjet SHSSH SKPB

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më 26. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" ka dërguar 9 copë gazeta "Zëri i Popullit" organ i Komitetit Qendror të PPSH të datave 31 mars 5, 6, 7, 9, 10, 11 dhe 12 prill 1985, si dhe disa titull të disa tituj të gazetave zvicerane të cilat shkruajnë për vdekjen e Enver Hoxhës. Në gazetën zvicerane "Blick" është titulli "Vdiq diktatori Hoxha" ndërsa në gazetën "Der Bund" është titulli "Vdiq Stalinisti i fundit" etj.

Përveç materialeve tjera "Kobra" ka dërguar edhe një shirit kasetofoni për të cilin shkruan: "Si këngëtar me çifteli i cili ka kënduar sa e sa herë nëpër klubet e ndryshme, edhe më 24 nëntor 1984 është paraqitur djali i Dervish Shaqës, në qytetin Albisguetl, afër Cyrihut, ku ishin takuar për të festuar ditën e flamurit kombëtar, dhe me këtë rast ai këndoi këngë për flamurin, për demonstratat e Kosovës, këngë për Rexhep Malën e Nuhi Berishën për Fazli Grajçevcin dhe këngë tjera. Gjithashtu djali i Dervish Shaqës ka qenë edhe në Xhenevë më 30 mars 1985, ku ishin takuar për të shënuar katër-vjetorin e demonstratave dhe me këtë rast ai këndoi për Bajram Currin, pastaj për Hydajet Hysenin, për Adem Demaçin për qëndrimin e "heronjve" Rexhepit e Nuhiut. Ky këndoi së bashku me disa shokë tjerë e në prezencën e afër 250 vetave në sallën e Universitetit të Gjenevës".

N. Shaqa, punëtor në Zvicër, djali i Dervish Shaqës, nga fshati Llukë, KK Deçan, emigrant në RPSSH, i njohur si rapsod popullor i këngëve kundër sistemit tonë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori edhe më parë ka dhënë shënime për djalin e Dervish Shaqës i cili është paraqitur me këngë me përmbajtje armiqësore. Materialet e dërguara do të jenë pjesë përbërëse e këtij raporti, ndërsa DSHSSH Pejë, i dërgohet shiriti i kasetofonit dhe fragment nga ky raport.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x fragment DSHSSH-Pejë

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Drejtorati i SHSSH-së, Gjakovë

Bashkangjitur aktit përcjellës ju dërgojmë plikon me materiale, të cilat në emër të Sejfullah Sahatçiu kanë mbërri nga Zvicra.

Shtojcë: Plikoja me materiale

SM

Kryeshefi i sektorit të II, Enver Prekadinaj

Sqarim: "Kobra" ka pasur shoqëri me "Hiltonin" e jo lidhje familjare siç është përkthyer gabimisht.

Identifikimi i Shaqë N. dhe Sheremet N.

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme.

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror.

Drejtorati-Gjakovë.

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu.

Më 6. 5. 1985.

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me tubimin e anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër, në mbledhjen komemorative kushtuar vdekjes së Enver Hoxhës.

Biseda është zhvilluar më 29. 04. 1985 nëpërmjet telefonit.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më 6. 5. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ, në Zvicër.

MST: Raportim për mbledhjen komemorative kushtuar Enver Hoxhës

III

Bashkëpunëtori në bisedë telefonike përveç tjerash lajmëron:

"Më dt. 27. 04. 1985, është mbajtur tubimi i disa anëtarëve të LRSSHJ, në Bernë kushtuar vdekjes së Enver Hoxhës. Mbledhja kryekëput ka qenë komemorative. Kjo mbledhje komemorative ka qenë dashur të mbahet në një restorant në Bernë në rr. Nonjenbruk Strasse 43 (shiko depeshen tonë nr. 155 të dt. 25. 04. 1985, nr. e punëtorit operativ), mirëpo më dt. 25. 04. 1985, pronari i këtij lokali ka marrë një letër anonime e kërcënuese në të cilën thuhej që të mos i lëshohet lokali këtij grupi njerëzish të kombësisë shqiptare pasi të njëjtit janë banditë dhe terroristë, dhe poqë se iu lejon një tubim të tillë, në lokalim-restorantin tuaj do të hedhim bombë e cila do të shkaktonte dëme materiale dhe së bashku me dëmet materiale do t'i asgjësojmë edhe personat që do të

tubohen në lokal. Pas marrjes së kësaj letre, pronari i këtij restoranti ka kontaktuar me mua dhe më ka njoftuar me përmbajtjen e letrës, në çka ka kërkuar edhe mendimin tim pasi me të jam në marrëdhënie tepër të mira. Pas një bisede të shkurtër me të, kam dhënë mendimin tim duke i thënë atij se ka mundësi lehtë që dikush të hedhë ndonjë bombë, prandaj është mirë që të mos lejohet tubimi këtë lokal pasi të rrezikohet jeta dhe pasuria jote. Në këtë sugjerim timin, pronari i lokalit ka refuzuar dhënien e lokalit. Në momentin e fundit, Zahir Zahiri dhe Hasan Malaj duke vërejtur se do të dështojë ky takim, kanë arritur që të sigurojnë sallën 'Kursall' dhe për këtë të japin vlerën prej 700 frangash zvicerane.

Tubimi është mbajtur më 27. 04. 1985 duke filluar nga ora 14:00 dhe ka zgjatur për afërsisht deri në orën 17:00. Prezentë ishin afër 180 persona. Në këtë sallë ishin të vëna vetëm dy fotografi të Enver Hoxhës pasi që edhe tubimi ishte caktuar për vdekjen e tij.

Mbledhjen komemorative e hapi bashkëshortja e Kadri Zekës, e cila foli për jetën dhe veprat e Enver Hoxhës. Pas kësaj, në gjuhën gjermane ka shprehur ngushëllime edhe Beat Chefer, i cili në fjalimin e vet e ngriste lart personalitetin e Enver Hoxhës. Përveç Beatit, ngushëllime ka shprehur edhe një shtetas turk, i cili përfaqësonte 'Partinë Marksiste-Leniniste' të Turqisë. Fjalimin e tij nga turqishtja e përkthente Kadri Avdullahu. Në disa raste është brohoritur 'Parti Enver, jemi gati kurdoherë'. Kam vërejtur edhe Adem dhe Hajdar Sadrijen nga Ponošeci, KK Gjakovë, të cilët ishin përgjegjës për zhvillimin normal të tubimit. Para dhe pas këtij tubimi është shpërndarë "Zëri i Kosovës", botim i posaçëm kushtuar punës, jetës dhe veprave të Enver Hoxhës. Kam vërejtur dhe regjistruar këto automjete të personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë tubim: GE 3101; LU99572; VL-165585; BE 420772; GE 6990; BE 405404; LU 99935 dhe GE 3727".

Zahir Zahiri, nga fsh. Prelepnice KK Gjilan;
Hasan Mala, nga Gjilani;
N. Zeka, bashkëshortja e Kadriut;
Beat Chefer, librashitës Bielle;
N. Avdullahu, bashkëshortja e Kadriut;
Hajdar Sadrija, nga fsh. Ponošec, KK Gjakovë;
Adem Sadrija nga fsh. Ponošec, KK Gjakovë.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet ende të pavërtetuara. "Kobrës" i është dhënë për detyrë që në raportin e vet të cilin do ta dërgojë me shkrim, të identifikojë sa më tepër pjesëmarrës të këtij tubimi.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 X SHSSH SKPB Punëtori operativ.

1 X Në lëndë të bash. "Kobra" Sejfullah Sahatçiu.

1 X Në evidencë.

1 X Në lëndë të Hajdar dhe Adem Sadrijajt.

Klubi i punëtorëve shqiptarë i RSFJ "Igballe Prishtina", në Gjenevë

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme.

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror.

Drejtorati-Gjakovë.

Punt. op. Sejfullah Sahatçiu.

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me veprimtarinë e LRSSHJ.

Raporti ka arritur më 17. 04. 1985.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit.

Shpenzime nuk ka pasur.

Raporti paraqitet më 22. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" në raportin e vet të dërguar me shkrim, përveç tjerash shkruan: "Klubi i punëtorëve shqiptarë i RSFJ 'Igballe Prishtina', në Gjenevë, me rastin e katërvjetorit të shpërthimit të demonstratave në Kosovë, organizoi një mbrëmje përkujtimore në një sallë të madhe të Universitetit të Gjenevës më datë 30. 03. 1985. Në këtë tubim ishim afër 250 veta e më së tepërmi kishte anëtarë të klubit të Lozanës. Para se të fillojë kjo ceremoni, para hyrjes, disa punëtorë tanët shitnin gazeta të ndryshme si 'Zëri i Popullit', 'Bashkimin', 'Shqipëria e Re' dhe disa libra 'Titistët' të formatit të vogël. Me këtë rast është shitur 'Zëri i Kosovës' në dy fletë vetëm me fotografi të 'heronjve' dhe të të burgosurve politikë shqiptarë. Në mbrëmjen përkujtimore fjalën e mbajti djali i Hasan Malës, në moshë afër 25 vjeçar. Ky në emër të 'lëvizjes' lexoi gjatë një artikull

rreth ngjarjeve në Kosovë dhe rreth politikës antishqiptare të disa udhëheqësve të Kosovës dhe të Jugosllavisë. Në vazhdim ky tha: 'Jugosllavia ia ka arritur disa qëllimeve të veta kundër nesh, kundër punëtorëve në migrim. Jugosllavia dhe UDB-a kanë intervenuar tek policia zvicerane që neve të mos na jepet kurrfarë e drejtë e as azili politik, se gjoja ne jemi irredentistë dhe se merremi me terrorizëm. Disa antishqiptarë e shpërndajnë 'Zërin e Kosovës' të falsifikuar e që këto shërbime po ua mundëson UDB-a'. Djali i Hasan Malës me këtë rast lexoi edhe një peticion të cilën në emër të 'lëvizjes' do t'ia dërgojë Parlamentit Evropian në Strasburg-Francë, dhe një peticion tjetër për t'ia dërguar shefit të policisë zvicerane. Në këtë peticion ishin nënshkrimet e afër 450 vetave.

Peticioni për policinë zvicerane

Edhe më 23. 03. 1985, është mbajtur një mbrëmje përkujtimore e klubit të Lozanës, e në të cilën ishin afër 500 veta. Edhe në këtë tubim djali i Hasan Malës kishte folur në emër të 'lëvizjes' dhe kishte vazhduar me nënshkrime në peticion. Përmbajtja e peticionit të dërguar në emër të shefit të policisë zvicerane kishte përafërsisht këtë përmbajtje: 'I nderuari kont. Ju na keni quajtur dhe mendoni se ne dhe LRSSHJ-ja jemi terroristë. Jo shoku kont, ne as që marrim erë në terrorizëm e as që jemi terroristë. Terroristë janë UDB-a jugosllave të cilët po i vrasin djemtë më të shtrenjtë të Kosovës si ata në Shtutgart, (Jusufin, Kadriun dhe Bardhoshin), burgosën me mijëra shqiptarë nëpër burgje pas ngjarjeve të pranverës 1981. Sigurisht, zoti kont, keni lexuar shkrimet nga gazetatat e ndryshme të botës, me siguri ju kujtohet mirë kur UDB-a jugosllave kurdisi bombën në Buchhandlulug Bathaustasse 35 në Biel tek Beat Schafer. LRSSHJ nuk është një organizatë terroriste por është organizatë demokratike e cila nuk ka lidhje me politikën zvicerane. Kjo pari kërkon statusin e republikës së Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave. Rrofshin vëllezërit tanë zviceranë''.

Përmbajtja e programit kulturor...

"Në këtë tubim u kënduan këngë, u lexuan dhe u dëgjuan recitime kushtuar shumë personaliteteve si dhe Bajram Currit. Në mesin e të tjerëve recitoi një poezi edhe Rrustem Mahmutaj nga fshati Lubeniç, KK Pejë. Ja poezia të cilën e shkroi dhe recitoi Rrustemi: 'Ti shkëmb i patundur ndër beteja, ti tokë e skuqur me gjak, ti emër i qëndresave, ty të këndoj unë biri yt mërgimtar, ty Kosovë oj nëna ime, të këndoj nga perëndia, për qëndresën tënde, për heroizmin tënd, ballë armikut serbomadh, përpara Kosovë në marshim, përpara drejt lirisë, si një grusht i fortë, ja vdesim ja fitojmë përpara Kosovë, ndije kushtrimin tim,

dhe grushtin tim kam ngritur për liri, në tjetrën dorë flamurin kuq e zi që valon, dhe them nga zemra Kosova Republikë, ç'ka Kosova që lëshon zë, në Kosovë shkau vend nuk ka, se Kosova vetë po flet, kemi qenë të shtypur krejt, ky armik kishte kujtuar, se shqiptarët kanë harru, por shqiptarët i kanë tregu se vendin tonë s'mundem me e lëshu, toka e Kosovës me gjak është gatuar, se gjyshët amanet na kanë lënë, të qëndrojmë për Kosovën nënë, këmbë armikut të mos i lëmë, dhe botës i kemi tregu, se Kosovën nuk mundesh me e sundue, jemi shqiptarë nuk dimë ç'është frika, po marshojmë nga republika, se një herë kemi thënë, republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë...'. Në këtë tubim, gjegjësisht në sallë ishte parulla "Kosova Republikë", pastaj fotografitë e Jusufit, Kadriut, Bardhoshit, Nuhiut dhe Rexhë Malës. Ndër më aktivistët e LRSSHJ ishin djali i Hasan Malës, Shaqa N. nga Kaçaniku, Hasan Malaj nga fshati Kaliqan, KK Pejë, bashkëshortja e Zahir N. nga fshati Perlepnice KK Gjilan dhe Sheremet N. për të cilin nuk di se nga është, me moshë afër 43-45 vjeçar, pjesëmarrës aktiv në demonstratat e Bernit".

- N. Malaj, djali i Hasan Malës, në moshë afër 25 vjeçar;
- Rrustem Mahmutaj, nga fshati Lubeniç, KK Pejë, i njohur i shërbimit;
- Hasan Malaj - "Mixha" - i njohur shërbimit;
- Shaqa N. nga Kaçaniku;
- Kadri Avdullahu i njohur i shërbimit;
- Sadri Malaj, nga fshati Kaliqan, KK Pejë;
- Sheremet N. në moshë afër 43-45 vjeçar.

Detyrë e Kobrës

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet pjesërisht të vërtetuara edhe nga burimet tjera. Bashkëpunëtorit do t'i jepet për detyrë që të identifikojë Shaqë N. dhe Sheremet N. se prej nga janë si dhe për mbiemrat e tyre.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x ShSSH SKPB.

1 x Evidencës.

1 x në lëndë të bashk. "Kobra".

1 x DSHSSH- Pejë.

1 x DSHSSH-Gjilan.

1 x DSHSSH-Ferizaj.

Punëtori operativ

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme.
Shërbimi i Sigurimit Shtetëror.
Drejtorati-Gjakovë.
Punt. op. Sejfullah Sahatçiu.
Më 23. 04. 1985.

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".
Shënimet kanë të bëjnë me organizimin e tubimit të anëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.
Biseda është zhvilluar nëpërmjet telefonit më dt. 18. 04. 1985, në orën 16:00.
Me iniciativën e bashkëpunëtorit.
Shpenzime nuk ka pasur.
Raporti paraqitet më 23. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ në Zvicër.

III

Nëpërmjet telefonit është thirrur "Kobra" më datën 18. 04. 1985, i cili përveç tjerash, lajmëron: "Më dt. 27. 04. 1985, të shtunën, është siguruar salla e restorantit në rrugën 'Noujenbruk Strasse 43' në Bernë, nga ana e LRSSHJ. Ky restorant është rezervuar me këtë dt. prej orës 12-18:00, dhe sipas planifikimit të tyre në të marrin pjesë afër 400 veta. Sipas një burimi, në këtë tubim do të flitet për organizimin e serishëm të demonstratave të Kosovës. Para restorantit do të vihet në gjysmështizë flamuri kombëtar shqiptar. Për rezervimin e restorantit janë angazhuar Zahir Zahiri nga fshati Prelepnice KK Gjilan dhe Rustem Mahmutaj... (mungon pjesa vijuese e raportit, red.)

Mbt; Superekskluzive: Dosja "KOBRA" – "Infopress" vazhdon të sjellë për herë të parë materiale për veprimtarinë agjenturore serbe (21)

Pjesëmarrje e madhe e shqiptarëve në manifestimet antijugosllave

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror
Drejtori-Gjakovë
punt. op. Sejfullah Sahatçiu
Më 23. 04. 1985

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra".

Shënimet kanë të bëjnë me Rustem Mahmutajn nga fshati Lybeniq, KK Pejë, aktivist i LRSHSJ-së në Zvicër. Raporti është dërguar më 12. 04. 1985, ndërsa në adresë të punëtorit operativ ka arritur më 22. 04. 1985. Në iniciativën e punëtorit operativ. Shpenzime nuk ka pasur. Raporti paraqitet më 22. 04. 1985.

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa anëtarëve të LRSZHJ në Zvicër.

Raport mbi deklaratimet e Rustem Mahmutajt

III

Bashkëpunëtori "Kobra" në raportin e vet të dërguar nëpërmjet tjerash shkruan: "Më dt. 07. 04. 1985 jam takuar me Rustem Mahmutajn i cili në bisedë lidhur me Ibrahim Kelmendin më tha: Ibrahim Kelmendi ishte shok i ngushtë i dajëve të mi Isuf dhe Bardhosh Gërvallës, dhe së fundit Ibrahim tradhtoi dhe me dorë të vet ata i vrau. Ne kemi mjaft fakte dhe argumente që flasin për këtë tradhti. Ibrahim pasi vrau këta, deshi që ta marrë edhe gruan e Kadriut për bashkëshorte, mirëpo e njëjta nuk pranoi që të martohet me një tradhtar. Për këtë gjë më ka treguar Hasan Malaj, që i njëjti Kadriu e ka pasur nipash. Pasi që i dështoi martesë Ibrahimit me bashkëshorten e Kadriut, ai vendosi që në vitin 1984 të vijë në Kosovë dhe të martohet duke mos u frikësuar aspak nga UDB-ja. Kështu i shoqëruar nga UDB-ja e Beogradit pasi që më parë i kishte kryer punët e tyre, së bashku me bashkëshorten e vet u kthye prapë në perëndim pa një therë në këmbë. Ibrahim, në fillim kishte mësuar nga UDB-ja, kishte sjellje të mirë se gjoja kishte ideologji marksiste-leniniste dhe si i tillë i fut në LRSZHJ, i cili punoi gjerë në mbledhjen e cila u mbajt në fund të dhjetorit 1984 kur edhe u përjashtua. Për Ibrahimin gjetëm edhe fakte të reja mbi tradhtinë e tij. Së bashku me Ibrahimin u përjashtua edhe Xhafer Shatri, pasi që Xhaferi nuk ka ikur nga burgu por është lëshuar dhe përcjellë që t'iu kryejë punët e UDB-ës Jugosllave. Për vrasjet e Jusufit dhe të tjerëve ende do të mbetet arsyetimi i tillë në mesin e punëtorëve tanë se ata i kanë vrarë serbët e Beogradit pasi që edhe

qëllimi ynë është që të fajësohen ata, mirëpo e vërteta është se Ibrahimimi ata i ka vrarë. Për këtë Ibrahimimi do të japë përgjegjësi para popullit atëherë kur të bëhet "Kosova Republikë". Për kohën se Ibrahimimi ishte në Kosovë, në e kemi përcjellë atë titist i cili është vërejtur nëpër kafene të ndryshme në shoqëri me UDB-ashët. Në kohën e fundit në LRSSHJ janë aktivizuar edhe dy vëllezërit e Jusuf Gërvallës, Hyseni dhe tjetri të cilit mjaft u mundua nga UDB-ja që t'i shtijë në dorë por nuk arriti. Në vazhdim Rustemi shpeshherë përdor fjalët "Durmishat". që do të thotë tradhtar i LRSSHJ-së.

IBRAHIM KELMENDI; i njohur nga Shërbimi.

RRUSTEM MAHMUTAJ, nga fsh. Lybeniq, KK Pejë, i njohur nga Shërbimi.

XHAFER SHATRI, i njohur nga Shërbimi.

HASAN MALA, vëllai i Rexhep Malës që të dytë të njohur nga Shërbimi.

IV

Vërejtjet e punëtorit operativ;

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet e pavërtetuara. "Kobra" është në marrëdhënie të mira me Rustemin, për ç'gjë ka mundësi që të dijë më për së afërmi mbi veprimtarinë armiqësore.

Bashkëpunëtorit iu është dhënë detyrë që prapë të kontaktojë me Rustemin. Me një kopje të këtij raporti është njoftuar DSHSSH në Pejë.

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x DSHSSH Pejë

1 x Evidencës

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Thirrje për demonstrata në Bon

Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme

Shërbimi i Sigurimit Shtetëror

Drejtori-Gjakovë

punt. op. Sejfullah Sahatçiu

Më 21. 06. 1985

Sektori II, LRSSHJ

Raport i bashkëpunëtorit

I

Burimi: Bashkëpunëtori "Kobra"

Shënimet kanë të bëjnë me organizimin e demonstratave në Bon të RFGJ-së nga ana e LRSSHJ-së.

Biseda është zhvilluar më dt. 21. 06. 1985, nëpërmjet telefonit, në orën 08. 00.

Me iniciativën e bashkëpunëtorit

Shpenzime nuk ka pasur

Raporti paraqitet më 21. 06. 1985

II

Bashkëpunëtori përcjell veprimtarinë armiqësore të disa pjesëtarëve të LRSSHJ-së në Zvicër.

III

Bashkëpunëtori "Kobra" nëpërmjet telefonit, më dt. 21. 06. 1985, në orën 8. 00 përveç tjerash lajmëron: "Kanë filluar të shpërndahen thirrjet për pjesëmarrje në demonstrata të cilat do t'i organizojë LRSSHJ. Demonstratat do të organizohen në qytetin Bon të RFGJ-së më dt. 29. 06. 1985, duke filluar në ora 10. 00. vendtubimi për fillimin e demonstratave do të jetë në Mynsterplac. Unë personalisht nuk kam mundësi që të marr pjesë në këtë demonstratë, pasi që atë ditë jam duke punuar.

IV

Vërejtje e punëtorit operativ:

Bashkëpunëtori i sigurt, shënimet ende të pavërtetuara. Meqë bashkëpunëtori nuk ka mundësi që të marrë pjesë në këto demonstrata, i është dhënë për detyrë që nëpërmjet lidhjeve të veta të interesohet mbi pjesëmarrësit dhe rrjedhat në këto demonstrata. Lidhur me këtë jeni njoftuar edhe me depeshen tonë nr. 237 të dt. 21. 06. 1985

V

Vërejtjet, çmimet dhe vendimet e eprorit:

Dërgohet:

2 x SHSSH SKPB

1 x në lëndë të bashk. "Kobra"

1 x Evidencës

1 x Camoviqit

Punëtori operativ, Sejfullah Sahatçiu

Analizë rreth aktivitetit të emigracionit shqiptar

Aktiviteti i Emigracionit Nacionalist Shqiptar në radhë të parë organizatës irredentiste LRSSH J eskalon edhe më tutje. Mund të konstatohet se ndikimi i irredentës të qytetarët tanë me punë të përkohshme në vendet e Evropës Perëndimore është rritur në raport me gjendjen e para 2-3

viteve. Kjo flet për atë që këmbëngulja e irredentës në forcimin e pjesëmarrjes dhe ndikimit të saj ka dhënë më shumë rezultate se përpjekja jonë për pengimin e aktivitetit irredentist antijugosllav. Në mesin e punëtorëve tanë me punë dhe qëndrim të përkohshëm në vendet e Evropës Perëndimore një nga arsytet e cila ka shkuar në favor të irredentës ka qenë politika e formimit të klubeve nacionale të qytetarëve tanë. Këto irredenta i shfrytëzoi dhe nën çadrën nacionale formoi klubet nacionaliste, të cilat ishin forma për tubime të gjëra të qytetarëve tanë dhe ndikimin e irredentës në mesin e tyre. Në irredentën duhet parë si grupim armiqësor numër një për nga masoviteti, agresiviteti, organizimi me ndihmë të hapur dhe mbështetje ALOS (sigurimi shqiptar) i RPSSH me pretendime të hapura territoriale ndaj RSFJ-së.

Treguesi kryesor i irredentës: masiviteti

Një nga treguesit kryesorë për prezencën e dukshme dhe ndikimin e irredentës është masiviteti i pjesëmarrjes së qytetarëve të kombësisë shqiptare në manifestimet antijugosllave të cilat LRSSHJ i organizoi në vitin 1984 dhe 1985. Për shembull me 11 koncerte të ansambllit folklorik shtetëror të RPSSH gjatë shtatorit 1984 që ishte një demonstrim antijugosllav i llojit të vetë morën pjesë mbi 6000 persona ose çdo i treti qytetar i kombësisë shqiptare i cili në atë kohë ishte me banim në Zvicër. Pastaj në 11 demonstratat antijugosllave gjatë vitit 1984 në Gjenevë, Bernë, Bil, festimi i ditës së flamurit shqiptar në Cyrih dhe Lozan, komemoracione të ndryshme të ngjashme morën pjesë rreth 5000 vetë. Pa marrë parasysh se në të gjitha këto aktivitete morën pjesë edhe persona nga vendet e tjera të Evropës Perëndimore RFGJ-së, Franca, Belgjika etj., prapëseprapë shifrat e lartpërmendura tregojnë përqindje mjaft të madhe të pjesëmarrjes së shqiptarëve në manifestime antijugosllave, me tendencë të theksuar të rritjes si të numrit të manifestimeve, po ashtu edhe të numrit të pjesëmarrësve që vërtetohet me numrin e tubimeve përkujtimore të këtij viti.

Për shembull janë mbajtur shumë tubime pas vdekjes së E. H në të cilin kanë marrë pjesë numër i madh i shqiptarëve, duke shprehur ngushëllime mes vete, duke u regjistruar në librin e ngushëllimeve, kanë dërguar telegrame ngushëllimi P. P. SH., disponojmë të dhëna se një numër i qytetarëve tanë kanë marrë pjesë edhe në varrim të E. H. në R. P. S. SH. Gjithashtu janë organizuar shumë tubime përkujtimore pas vdekjes së Zija Shemsiut, në të cilat gjithashtu kanë marrë pjesë një numër i madh i personave. Është organizuar edhe mbledhja e ndihmave për familjen Shemsiu në vendlindje. Këto takime përkujtimore LRSSHJ i organizoi nëpërmjet klubeve të cilat në të shumtën e rasteve binin nën ndikim e LRSSHJ-së.

Ndikimi i irredentës ka depërtuar gjerësisht mes qytetarëve të kombësisë shqiptare

Duhet të kihet parasysh se ndikimi i irredentës, veçanërisht në Zvicër nuk është i kufizuar në emigracionin armiqësor Shqiptar, i cili nuk është i madh në numër dhe politikisht i papërfillur, por ky ndikim ka depërtuar gjerësisht mes qytetarëve tanë të kombësisë shqiptare ndaj të cilëve zhvillohet një indoktrinim intensiv: shpërndahen buletine të ndryshme dhe literaturë nga RPSSH, shfaqen filma propagandistikë, shpërndahen videokaseta dhe kaseta magnetofoni. Kohëve të fundit ky material dërgohet edhe në vendlindje. Pastaj irredentistët nëpërmjet klubeve organizojnë shfaqje të ndryshme, recitale, skeçe, e të ngjashme, nëpërmjet të cilave poshtërohet gjithçka që është jugosllave dhe ushtrohet një ndikim i fortë propagandistik në punëtorët tanë. Kryes të veprimeve të lartpërmendura janë fëmijët dhe pjesëtarët e LRSSHJ-së. Ndërsa vendi ku kryhen aktivitetet janë klubet, banesat private, sallat e marra me qira e të ngjashme. E gjithë kjo flet se qytetarët tanë me pasaporta tona, të cilët vijnë në vendlindje dhe kthehen në punë jashtë vendit faktikisht përfaqësojnë bazën themelore të irredentës. Duhet theksuar se dalëngadalë po vijmë te të dhënat për organizimin e të gjitha tubimeve dhe manifestimeve si dhe përgatitjen e aksioneve jashtë vendit për të cilat menjëherë njoftojmë telegrafikisht. Gjithashtu punojmë për prishjen e organizimeve, mbajtjen e tubimeve dhe manifestimeve të ndryshme antijugosllave, angazhohemi edhe në plasimin e dezinformatave në rrethe irredentiste me të cilat u kundërvihemi aktiviteteve të tyre.

Ua kemi marrë dokumentet e udhëtimit

Anëtarëve të familjeve të irredentistëve të njohur nga rrethina e Gjakovës ua kemi marrë DU (dokumenti i udhëtimit), dhe është ndaluar dhënia e tyre, me qëllim që ata t'i ndejnë pasojat e pjesëmarrjes së anëtarëve të familjes së tyre me veprimtari armiqësore dhe veprimtari intensive kundër vendit tonë, si dhe me qëllimin e ngushtimit të hapësirës për krijimin e lidhjeve dhe vatrave të reja mes qytetarëve tanë në vend dhe jashtë vendit. Në këtë drejtim duhet të përfshihen edhe masa të tjera shoqërore-politike, në mënyrë që të ndjehen pasojat për atë çka bëjnë anëtarët e familjeve të tyre. Është karakteristikë të theksohet se kohët e fundit ka tendenca që ONDSH dhe LRSSHJ të krijojnë kontakte dhe marrëveshje për veprimtari në pozicionet e njëjta dhe platforma e njëjtë. Po ashtu edhe lidhjet e ONDSH-së dhe emigracionit ustash në manifestimet antijugosllave. Duhet theksuar fakti se gati të gjithë qytetarët tanë të kombësisë shqiptare në

perëndim e veçanërisht anëtarët e LRSSHJ-së posedojnë armë dhe kohëve të fundit këto i dërgojnë edhe në vendlindje.

Cilat ishin vatrat e aktivitetit të irredentës?

Në bazë të të dhënave të deritanishme vatra të verifikuara të aktivitetit armiqësor të irredentës, kur është fjala për personat e rrethit të Gjakovës janë:

Në	Zvicër-Cyrihu,	Berna,	St.	Galen,	Surse...
Në		RFGJ-Frankfurti,			Sindelfingen...
Në					Belgjikë-Brukseli
Në		SHBA-Detroiti,		New	York

Këto janë njëkohësisht zonat ku është e koncentruar fuqia më e madhe punëtore e rrethinës së Gjakovës. Nga rrethinat e zonës së Gjakovës duhet dalluar zonën e BL Ponoshec, BL Skivjan, BL Rogovë dhe fshatin Batushe si vatra të irredentës. Për shkak të lidhjeve të iniciuara të shumë personave të cilët janë në lidhje familjare dhe lidhje të tjera me personat e eksponuar gjegjësisht kryejnë veprimtari armiqësore në vatrat e lartshënuara jashtë vendit.

Cilët persona nga rrethi i Gjakovës meritojnë vëmendje?

Nga personat e rrethinës së Gjakovës rëndësi të veçantë meritojnë: Vëllezërit Adem dhe Hajdar Sadrija (00) nga Ponosheci, aktivist i dalluar i LRSSHJ-së dhe me lidhje të verifikuar me Ambasadën Shqiptare në Vjenë dhe Paris, të cilët veprojnë në zonën e Bernës. Ali Hajdari nga Beci gjendet në Belgjikë-Bruksel. Vëllezërit Rexhë e Rizah Shabanaj nga Dobriqi, gjenden në Surse, shumë aktivë në planin propagandistik dhe anëtarë të LRSSHJ-së. DSHSSH (drejtoria e Shërbimit të Sigurimit të Shtetit) Gjakovë ndjek: katër lëndë 00, katër P00, gjashtë SOK, shtatë raste të ndara (raste në hetim). Persona të indikuar për spastrim gjithsejtë 165 nga këta të indikuar më 1985 - 48 persona. Janë ngritur 6 kallëzime penale për 7 persona, në mungesë të tyre prokurori publik ka pranuar kallëzimin, sepse në kemi dokumentuar aktivitetin e tyre armiqësor. Katër personave i është marrë DU, ndërsa është lëshuar ndalesë për lëshim të DU për 14 persona. Në përcjellje të aktivitetit armiqësor të ENSH (emigracionit nationalist shqiptar), irredentës dhe KOZ të punëtorëve tanë me punë të përkohshme jashtë vendit është angazhuar e gjithë DSHSSH Gjakovë. Kjo drejtori këtë problematikë e përcjell nëpërmjet 20 bashkëpunëtorëve dhe 42 lidhjeve operative. Kontaktet realizohen ekskluzivisht brenda vendit, ndërsa lidhjet mbahen me telefon dhe korrespondenca. Në të gjitha pozicionet janë shtetas jugosllav-përveç dy bashkëpunëtorëve të cilët janë emigrantë shqiptarë.

(Fund)

**DEMONSTRATAT DHE VEPRIMTARËT E LRSSHJ-së – QË U SURVEJUAN
NGA AGJENTI I UDB-së "KOBRA"**



Demonstrata në Shtutgart – Janar 1983



Demonstrata në Strasburg (para selisë së Parlamentit evropian)
28.10.1983



Demonstrata në Gjenevë – 10.XII.1983



Demonstrata në Bernë – 14.07.1984



Demonstrata në Shtutgart – 26.01.1985



Demonstrata në Bon – 29.06.1985



Nr. 1
Janar
1985

ZËRI I KOSOVËS



Organ i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi
Në ballë të këtij populli dhe të këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme.
Jusuf GERVALLA



Zija Shemsiu



Katrin Asal&Beat Shafer – Libraria, adresa e ZiK-ut...



Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi – Gjenevë 1983

(Fotografitë u siguruan nga www.pashtriku.org)